

SIGURIA NË JETËN E PROFETËVE



Shkup, 2022

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",
Скопје

28-23-277

IBËN Ibrahim El-Umeri, Abdul-Aziz

Siguria në jetën e profetëve / Abdul-Aziz ibën Ibrahim El-Umeri ;
[përktheu nga arabishtja Nasuf Hoxha]. - Shkup : Furkan ISM, 2022. -
147 стр. ; 21 см

Наслов на оригинал на арап. јазик. - Фусоти кон текстот

ISBN 978-608-216-225-6

а) Куран -- Толкувања

COBISS.MK-ID 56387589

dr. Abdulaziz b. Ibrahim el-Umeri

Siguria në jetën e profetëve



Furkan ISM
2022

Autor:

dr. Abdulaziz b. Ibrahim el-Umeri

Titulli në origjinal:

الأمن في حياة الأنبياء عليهم السلام

Për botuesin:

Muhamed MURTEZI

Përktheu nga arabishtja:

Nasuf HOXHA

Redaktor:

Hasan BAFTIJARI

Redaktor gjuhësor:

Namir LAPARDHAJA

Radhitja kompjuterike:

Furkan ISM

Kopertina:

Jusuf SALIU

Botues:

SHB "Furkan ISM"

Brigada II Maqedonase lok 22, 1000 Shkup

Tel: (02) 26 22 360

<http://www.furkan.com.mk>

E-mail: furkan@furkan.com.mk

Shtypi:

Furkan Print - Shkup

Tel: (02) 26 22 360

Copyright©Furkan ISM, 2022

Tirazhi:

1000

Parathënia

Historia e njerëzimit është e mbushur plot me dëshmi dhe mësim që lidhen me jetën e njeriut në tokë. Por ndoshta çështja e sigurisë mund të konsiderohet një nga shqetësimet bazë në jetën e njerëzve të të gjithë racave, niveleve dhe orientimeve, sepse siguria është domosdoshmëri jetike për njeriun.

Për garantimin e sigurisë së shoqërive njerëzore janë vendosur ligje të posaçme dhe sisteme të ndryshme që garantojnë drejtësinë dhe barazinë, si dhe i qartësojnë të drejtat dhe detyrat e tyre, edhe pse ato kanë burime të ndryshme dhe ndonjëherë dalin jashtë objektivit të caktuar. Po kështu, ka edhe institucione shtetërore që garantojnë sigurinë e përgjithshme të shoqërive njerëzore. Ekziston tek njerëzit edhe një ndjeshmëri e theksuar ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë në përgjithësi.

Njerëzit i kanë kushtuar vëmendje studimit të historisë së shoqërive njerëzore dhe, në veçanti, çështjeve që kanë lidhje me sigurinë e jetës, duke krijuar gjatë shekujve dhe qytetërimeve të ndryshme edhe referencat e tyre për çështjet e sigurisë.

Edhe muslimanët e njohin këtë dimension në kulturën e tyre të përgjithshme rreth historisë së shoqërive njerëzore që në fillesat e saj, madje

që nga koha e krijimit të Ademit [alejhi selam], babait të gjithë njerëzimit. Në këtë mënyrë, ata kanë burimet e tyre për studimin e historisë së njerëzimit dhe, në veçanti, ato që kanë të bëjnë me sigurinë e tyre.

Çështja e sigurisë del në pah sidomos kur trajtojmë historitë e profetëve të Zotit. Në këtë rast, muslimanët kanë burimet e tyre të informacionit, e në krye të tyre është Kur'ani Famëlar-të, i cili është fjalë e Zotit dhe është i pagabueshëm. Dihet tashmë se Kur'ani është libër që përmban ligje dhe udhëzime nga Zoti, por, në të njëjtën kohë, ai është edhe një burim historik i qëndrueshëm dhe i vërtetë. Lajmet dhe historitë që na tregojnë ai rreth popujve të mëparshëm janë lajmet dhe historitë më të sakta tek të cilat mund të mbështetemi për njohjen e së shkuarës, për vijimin e së tashmes dhe përfytyrimin e së ardhmes. Historitë e Kur'anit janë plot mësim dhe këshilla për njerëzit, në përgjithësi, dhe për të zotët e mendjes, në veçanti. Allahu i Madhërishtëm thotë:

“Në tregimet e atyre (të dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend. Ky (Kur'an) nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i atyre (librave) që janë shpallur para tij, është shpjegues i çdo gjëje dhe udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit besimtarë.” (Jusuf: 111)

“Këto janë disa prej historive të qyteteve që po t’i tregojmë ty (o Muhamed). Disa prej atyre ende qëndrojnë, kurse disa janë rrënuar.” (Hud: 100)

“Ne të kemi treguar ty disa nga ngjarjet e atyre popujve. Të dërguarit e tyre u erdhën me prova të qarta ...” (El-A’raf: 101)

Edhe në hadithet profetike gjejmë shumë lajme rreth profetëve të Zotit, të cilët Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua tregonte shokëve të tij për të përfituar nga dituria dhe edukata e tyre.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kështu pra, Ne po të të tregojmë ty (o Muhamed) disa histori të së kaluarës. Ky (Kur’an) që të kemi dhënë, është një Këshillë nga ana Jonë. Kush shmanget nga ai, në Ditën e Kijametit do të mbartë ngarkesë të rëndë.”* (Ta Ha: 99-100)

Jetët e profetëve kanë shërbyer si stacione të rëndësishme në historinë e njerëzimit për mijëra shekuj dhe për qytetërime të larmishme në kohë të ndryshme. Për këtë arsye, historianët muslimanë flasin shumë për ta në enciklopeditë e tyre historike, duke përmendur edhe detaje të hollësishme rreth jetës së tyre dhe ngjarjeve që i kanë shoqëruar ata, duke i marrë argumentet nga historitë e Kur’anit Famëlartë. Edhe referencat e marra nga ithtarët e librave të shenjtë të hebrenjve dhe të

krishterëve, sidomos Dhiata e Vjetër dhe komentimet e saj, konsiderohen si burime ndihmëse në këtë fushë për sa kohë nuk bien në kundërshtim me pohimet e Kur'anit Famëlartë dhe të haditheve profetike. Studiuesit e historive të profetëve hasin vështirësi në përcaktimin e saktë të datave, me gjithë përpjekjet e historianëve muslimanë të vjetër dhe dijetarëve të fushës së hadithit. Përpjekjet e disa historianëve dhe shkrimtarëve bashkëkohorë që këmbëngulin në përcaktimin e disa datave të caktuara është njëra nga gjërat më të vështira me të cilat përballen studiuesit, sidomos kur argumentet në të cilat mbështeten nuk e konfirmojnë në mënyrë të sigurt një gjë të tillë.

Muslimanët kanë caktuar një disiplinë dhe studime të veçanta për historinë e jetës së profetëve që janë dërguar para Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ku jepen informacione dhe detaje rreth jetës së këtyre profetëve. Po kështu, kemi edhe një ndarje të veçantë për historinë e jetës së Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], të cilën nuk do ta trajtojmë në këtë studim, pasi ka nevojë që të trajtohet më vete më hollësisht.

Ky studim është vetëm një përpjekje për trajtimin e çështjeve të sigurisë në jetën e profetëve të dërguar para Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duke filluar me Ademin

[alejhi selam] e duke vazhduar më pas me Hudin, Salihun, Ibrahimin, Musain, Sulejmanin dhe duke e mbyllur me Isain [alejhi selam]. Në këtë studim trajtohet koncepti i sigurisë në jetën e tyre si një mirësi e dhuruar nga Allahu i Madhërishëm, shkaqet që shkaktojnë largimin ose ruajtjen e kësaj mirësie, krimet dhe ndëshkimet e përmendura në historitë e tyre si dhe shumë gjëra të tjera që kanë lidhje më këtë çështje.

Dëshiroj të kujtoj se ky studim është botuar më parë në revistën e universitetit islam “Imam Muhamed Bin Suud”, në numrin 32, të botuar në muajin Sheval, të vitit 1421, sipas kalendarit Hixhri. Megjithatë, e pashë të arsyeshme që të botohet si libër më vete për të përfituruar më shumë, sidomos në një kohë kur bota islame përjeton probleme dhe sprova të shumta në fushën e sigurisë. I lutemi Allahut që të na ruajë ne dhe vendet tona nga e keqja e tyre!

Shpresoj që ky kontribut për studimin e kësaj ane të jetës së profetëve të na ndihmojë në orientimin e saktë të vështrimit të Umetit musliman dhe ngulitjen e këtij koncepti në jetën e tyre, që brezat e rinj të kuptojnë shenjtërinë e jetës dhe mirësinë e madhe të sigurisë. Nëse e kam qëlluar të vërtetën, kjo është prej Allahut të Madhërishëm, e nëse kam gabuar, kjo është prej vetes time dhe prej shejtanit. Allahu na ndihmoftë!

Hyrja

Siguria - “El-emn”, në gjuhën arabe ka kuptimin e së kundërtës së frikës. Origjina e kuptimit të kësaj fjale vjen nga qetësia e shpirtit. Këtë domethënie ka edhe në ajetin kur’anor, ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“I Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike...”* (El-Kurejsh: 4)

Këtë kuptim ka edhe në ajetin kur’anor në fjalët e Jakubit [alejhi selam]: *“Ai u tha: “A mos vallë t’jua besoj juve, ashtu siç jua pata besuar më parë vëllain e tij? Allahu është Ruajtësi më i mirë dhe Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!”* (Jusuf: 64)

Fjala arabe “El-emn” ka kuptimin e sigurisë, mirëqenies, qetësisë, rehatisë dhe largimit nga frika.

Një vend quhet i sigurt kur banorët e tij ndihen të sigurt dhe nuk ndiejnë frikë. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vendgrumbullimi dhe sigurie për njerëzit...”* (El-Bekare: 125)

Folja “eminte” i thuhet atij personi që i është larguar frika dhe ajo nga e cila druhej.

Largimi i sigurisë nga një person ose vend i caktuar do të thotë se pritet ndonjë gjë e keqe, së cilës i druhen dhe i frikësohen.

Me të ka lidhje edhe fjala “emanetun”- amanet, që ka kuptimin e mbrojtjes, ruajtjes dhe besueshmërisë dhe është e kundërta e tradhtisë.

Me të ka lidhje edhe fjala “iman”- besim, e cila ka kuptimin e nënshtimit dhe bindjes ndaj Allahut të Madhërishëm dhe respektimit të ligjeve dhe urdhrave të Tij.

Çështjet e sigurisë dhe ngjarjet që kanë të bëjnë me sigurinë e njerëzve dhe frikën e tyre tashmë në gjuhën e përditshme të njerëzve quhen rëndom si çështje të sigurisë. Kjo është e njohur që në kohët e hershme dhe për këtë qëllim janë ngritur struktura dhe aparatura shtetërore të specializuara në këtë fushë. Siguria e njerëzve për jetën e tyre, nderin, pasurinë dhe gjërat e tjera të rëndësishme për ta kanë zënë vend të rëndësishëm në jetën e profetëve të Allahut që nga Ademi [alejhi selam] e deri tek Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ajetet kur’anore dhe hadithet e shumta profetike kanë regjistruar çështje të ndryshme që mund të konsiderohen si çështje që kanë lidhje me sigurinë në jetën e tyre, sipas koncepteve të saj të shumta në jetën e njerëzve përgjatë shekujve të historisë njerëzore.

Siguria në jetën e Ademit [alejhi selam]

Çështja e parë e sigurisë që hasim gjatë leximit të historisë së profetëve është ajo që na tregon Kur'ani Famëllartë për Ademin [alejhi selam]. Engjëjt kishin frikë se mos ndoshta Ademi [alejhi selam] dhe pasardhësit e tij do të shkaktonin korrupsion dhe gjakderdhje në tokë, por Allahu i Madhërishëm, i Cili e dinte atë që nuk e dinin engjëjt, i njofton duke thënë: *“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë”, ata thanë: “A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini”.*” (El-Bekare: 30)¹

Ademi [alejhi selam] jetonte në Xhenet në siguri të plotë dhe pa asnjë frikë për pakësimin ose mungesën e gjërave që i nevojiteshin.²

Me gjithë këtë siguri që gëzonte, ai rrezikonte të humbiste atë në rast se kundërshtonte urdhrin e

¹ Shiko librin e Er-Raxhihit me titull “Ademi ashtu siç na ka treguar Kur’ani”, f. 4.

² Shiko temën që flet për jetën e Ademit [alejhi selam] në Xhenet tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 56, librin “El-Kamil” të Ibnul Ethirit, v. I, f. 22, librin e Ibnul Kethirit “Historitë e profetëve”, v. I, f. 77, si dhe librin e El-Fekij “Historitë e profetëve”, f. 22.

Zotit dhe ndiqte joshjen e shejtanit të mallkuar, duke shkaktuar zemërimin e Allahut të Madhëri-
shëm që sjell si pasojë përjetimin e frikës dhe të
poshtërimit. Hollësitë e këtyre ngjarjeve na i treg-
on vetë Allahu i Madhëri-
shëm në Kur'anin
Famëlartë: *“Pastaj thamë: “O Adem, me të vërtetë
që ky është armiku yt dhe i gruas sate, prandaj
mos e lini t’ju nxjerrë kurrsesi nga Xheneti, se
pastaj do të vuani në mjerim! Këtu nuk do të mbe-
tesh kurrë as i uritur e as i zhveshur, dhe nuk do të
kesh as etje, as vapë.” Por djalli e cyti: “O Adem,
a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një
mbretërimi që nuk zhduket?” Kështu, ata të dy,
(Ademi dhe Havaja), hëngrën nga ajo pemë e u ndër-
gjegjësuuan për lakuriqësinë e tyre, prandaj nisën të
mbulohen me gjethet e Xhenetit. Ademi nuk e
zbatoi urdhrin e Zotit të vet, kështu që devijoi (nga
rruga e drejtë). Pastaj, Zoti i tij e zgjodhi atë, ia
pranoi pendimin, e udhëzoi.”* (Ta Ha: 118-122)

Pema e Xhenetit ishte bërë e ndaluar për
Ademin [alejhi selam] me urdhrin e Allahut, sep-
se Ai është Krijuesi i Urtë dhe Organizuesi i jetës
së njerëzve dhe fjala e Tij është ligj dhe rregull. Për
këtë shkak, ngrënia nga kjo pemë do të thoshte
shkelje dhe cenim i rregullave dhe kufijve të
caktuar nga Allahu i Madhëri-
shëm.³

³ Shiko librin e Er-Raxhihi me titull “Ademi ashtu siç na ka treguar
Kur’ani”, f. 4.

Për shkak të shkeljes së këtij urdhri, Ademi [alejhi selam] e meritoi ndëshkimin, duke u dëbuar nga Xheneti dhe duke e zbritur në tokë. Allahu i Madhërishëm na ka treguar për këtë në Kur'anin Famëlartë, duke i tërhequr vëmendjen birit të Ademit (njeriut) që të largohet nga rruga e gjynahut dhe kundërshtimit. Allahu i Madhëri-shëm thotë: *“O bijtë e Ademit, le të mos ju mash-trojë kurrsesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t’u dukur vendet e turpshme! Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë.”* (El-A’raf: 27)

Ademi [alejhi selam] u zbrit në tokë dhe frika filloi të bëhet pjesë e jetës së tij. Ai filloi të frikësohej nga shejtani, armiku i tij i parë. Ai kish-te frikë edhe për fëmijët e tij nga përfshirja në krime ose frika se mos i bënë keq njëri-tjetrit për shkak të ekzistencës së shtysave të ndryshme drejt kimit dhe ishte pikërisht kjo ajo që ndodhi. Ndodhi krimi i parë i vrasjes së njeriut në sipër-faqen e tokës, Kabili vrau Habilin.⁴

Shtysa për të kryer vrasjen e parë në sipër-faqen e tokës ishte konkurrenca për një femër. Ibn

⁴ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 68-69, dhe librin “Historitë e profetëve” të autorit Eth-Thalebi (Arais el-mexhalis), f. 31, si dhe kapitullin e pestë të kësaj historie tek Ibnu Kethiji në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 92.

Kethiri na jep edhe disa hollësi rreth kësaj ngjarjeje, duke transmetuar nga Ibn Abasi [radijallahu anhu] se ka thënë: “Ademi [alejhi selam] vendosi t’i martonte fëmijët e tij (ata kishin lindur binjakë, një djalë dhe një vajzë), duke e martuar njërin djalë me një vajzë që nuk ishte binjake e tij. Kështu Habili donte të martohej me motrën binjake të Kabilit, i cili ishte më i madh se Habili. Por motra e Kabilit ishte më e bukur dhe dëshironte të martohej vetë me të. Ademi [alejhi selam] e urdhëroi atë që ta lejonte Habilin të martohej me të, por ai kundërshtoi. Pas kësaj, Ademi [alejhi selam] i urdhëroi që secili prej tyre të bënte një kurban (të sakrifikonte) për hir të Allahut të Madhërishëm dhe vetë vendosi të shkonte në Mekë për të kryer Haxhin. Ai i kërkoi qiejve që t’i merrnin në kujdestari fëmijët e tij, por ata nuk pranuan. Atëherë i kërkoi tokës që t’i merrnin në kujdestari fëmijët e tij, por edhe ajo nuk pranoi. Ishte Kabili ai që mori përsipër ruajtjen e këtij amaneti. Habili merrej me rritjen e bagëtive dhe dhuroi për kurban një deve katërvjeçare të shëndetshme. Kurse Kabili merrej me bujqësi dhe dhuroi për kurban një tufë me drithëra dhe prodhime nga të mbjellat e tij më të këqija. Pas kësaj u shfaq një zjarr që erdhi dhe e përpiu kurbanin e Habilit dhe nuk e preku fare atë që dhuroi Kabili (nuk u pranua dhurata e tij). Kabili u zemërua dhe vendosi që ta vriste Habilin për të mos e lejuar që të martohej

me motrën e tij, edhe pse Habili i tha se Allahu e pranon vetëm nga të devotshmit.⁵

Mes rreshtave të kësaj ngjarjeje dhe në sfondin e saj mund të vërejmë dallimin mes njerëzve. Aty vërejmë se Habili ishte kundër sulmit ndaj vëllait të tij sido që të ishin rrethanat, madje edhe nëse vëllai i tij do të ngrinte dorë kundër tij: *“Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë.”* (El-Maide: 28)

Kjo fjalë me të cilën iu drejtua Habili Kabilit, tregon moralin e lartë të Habilit dhe drojën që kishte ai nga Allahu i Madhërishëm, prandaj nuk donte t’ia kthente vëllait të tij të keqen me të keqe.⁶

Po ashtu, me anë të ngjarjeve që e shoqërojnë këtë krim, mund të kuptojmë disa gjëra që kanë lidhje me krimet në jetën e njerëzve, duke njohur shtysat që të çojnë drejt krimit, siç është konkurrenca për femrat. Sa e sa krime origjinën e tyre e kanë pikërisht në këtë shtysë.

⁵ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 9.

⁶ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 93, dhe librin “Historitë e profetëve” të autorit Eth-Thalebi (Arais el-mexhalis), f. 42, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 93, si dhe në librin “Me profetët” të autorit Afif Tabare, f. 54, si dhe në librin e autorit Hasen Duh, “Sprovat e së keqes dhe së mirës në jetën e profetëve”, f. 17.

Shkak për të shtyrë drejt krimit është edhe smira dhe zilia e verbër. Kabili nuk kishte një shkak të justifikueshëm për t'i bërë keq vëllait të tij, sepse Habili ishte paqësor dhe i largohej konfliktit. Shto këtu edhe faktin se martesë mes Habilit dhe motrës binjake të Kabilit ishte në përputhje me ligjin dhe rregullin e caktuar nga Zoti në kohën e Ademit [alejhi selam]. Megjithatë, Kabili u bë xheloz për vëllain e tij, Habilin, dhe pati smirë ndaj tij për një të drejtë që i takonte Habilit në mënyrë të natyrshme.⁷

Jo vetëm kaq, por Kabili e kishte menduar dhe planifikuar vrasjen e vëllait dhe ishte i vendosur ta bënte këtë gjë. Ibn Sad thotë: "Kur ata arritën moshën madhore, Allahu i Madhërishtëm e urdhëroi Ademin që ta martojë djalin e barkut të parë me vajzën e barkut të dytë dhe djalin e barkut të dytë me vajzën e barkut të parë. Por motra e Kabilit ishte më e bukur se motra e Habilit. Ademi i tregoi Havasë urdhrin që i kishte ardhur nga Zoti dhe ajo ua tregoi këtë djemve të saj. Habili pranoi, kurse Kabili refuzoi, duke pretenduar se ky nuk ishte urdhër i Zotit, por urdhër i vetë Ademit [alejhi selam]. Atëherë Ademi [alejhi selam] u kërkoi që secili prej tyre të paraqiste një dhuratë si kurban për hir të Allahut të Madhërishtëm dhe do të shfaqej një zjarr nga qielli që do ta

⁷ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 70.

përpinte dhuratën e atij që do t'i pranohej dhe ai do të martohej me të. Ata pranuan të dy. Habili merrej me rritjen e bagëtive dhe ofroi si dhuratë për kurban nga pjesa më e mirë e asaj që kishte. Kurse Kabili merrej me bujqësi dhe ofroi si dhuratë për kurban nga pjesa më e keqe e asaj që kishte. Ata, bashkë me dhuratat e tyre u ngjitën në mal bashkë me Ademin [alejhi selam]. Ata i vendosën dhuratat e tyre dhe Ademi [alejhi selam] iu lut Zotit. Në këtë moment, Kabili brenda vetes tha: "Nuk ka rëndësi nëse më pranohet ose jo dhurata ime. Habili nuk do të martohet kurrë me motrën time." Pas kësaj u shfaq një zjarr që erdhi dhe e përpiu kurbanin e Habilit dhe nuk e preku fare atë që dhuroi Kabili, sepse ai nuk e kishte dhuruar atë me sinqeritet. Habili u largua, por Kabili shkoi tek ai, ndërsa po qëndronte me bagëtitë, dhe i tha: "Do të të vras."⁸

Një nga shtysat drejt krimit që mësojmë nga kjo histori është edhe ndjenja e dështimit. Allahu i Madhërishëm e pranoi kurbanin e Habilit dhe nuk e pranoi kurbanin e Kabilit dhe, për këtë shkak, atë e goditi ndjenja e gabimit dhe iu shtua këmbëngulja për ta kryer krimin. Mendoj se kjo ka nevojë për më shumë studim dhe vëmendje.⁹

⁸ Shiko tek Ibnu Sadi në librin "Et-tabekat el-kubra", v. I, f. 36.

⁹ Shiko tek Afif Tabare "Me profetët", f. 53.

Krimi i Kabilit nuk qëndroi vetëm tek vrasja e vëllait të tij, por shkoi edhe më tej duke u përpjekur ta cenojë edhe motrën e tij binjake. Ky është një sulm tjetër dhe një cenim tjetër i sigurisë. Ky cenim i sigurisë nga ana e Kabilit bëri që jeta e tij të mbushet me frikë dhe pasiguri. Ibn Abasi [radijallahu anhu] ka thënë: “Kur Kabili e vrau vëllain e tij, Habilin, e kapi motrën e tij për dore dhe zbriti bashkë me të nga mali drejt zonave të ulëta. Atëherë Ademi [alejhi selam] i tha: “Ik, gjithmonë do të jesh i frikësuar dhe do të kesh frikë nga cilido që shikon.”¹⁰

Krimi i parë i vrasjes mes njerëzve ishte vrasja e Habilit. Me shtimin e pasardhësve të Ademit [alejhi selam], të fëmijëve dhe nipërve, u shtuan fiset dhe popujt, duke u shtrirë në të gjithë tokën, po kështu u shtuan edhe krimet dhe sulmet ndaj të tjerëve. Për këtë arsye, erdhën shpalljet dhe ligjet hyjnore për të vënë drejtësi mes njerëzve, duke u kujtuar atyre ndëshkimin që mori ai që kreu krimin e parë dhe duke i kërcënuar ata që do ta kryejnë një krim të tillë me ndëshkimin hyjnor në dynja dhe në ahiret. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është*

¹⁰ Shiko tek Ibnu Sad në librin “Et-tabekat el-kubra”, v. I, f. 37, si dhe tek Rushdi El-Bedravi “Historitë e profetëve në histori”, f. 28.

sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve. Të dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në Tokë.” (El-Maide: 32)

Menjëherë pas këtyre ajeteve, Allahu i Madhërishëm e bën të ditur ndëshkimin për ata që bëjnë krime dhe përhapin frikën, duke thënë: *“Pa dyshim se ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe që bëjnë shkatërrime në Tokë, është të vriten ose të gozhdohen, ose t’u këputen duart dhe këmbët tërthorazi, ose të dëbohen nga vendi. Ky ndëshkim është poshtërim për ata në këtë jetë, ndërsa në jetën tjetër, për ata do të ketë dënim shumë të madh.” (El-Maide: 33)*

Allahu i Madhërishëm e ka lënë të hapur derën e pendimit dhe përmirësimit për ata që kthehen në rrugën e drejtë, duke thënë: *“Përrjash-tim bëjnë ata që pendohen pa i zënë ju. Ta dini se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” (El-Maide: 34)*

Këto gjykime të Sheriatit që kanë të bëjnë me sigurinë e njerëzve për jetën e tyre, vijnë në vazhdim të historisë së krimit të parë njerëzor dhe vrasjen e parë që na tregon Kur’ani Famëlartë.

I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sellem] na ka treguar për përgjegjësinë e njeriut në

përhapjen e ngjarjeve të vrasjes në tokë, sepse njeriu ishte i pari që e bëri një krim të tillë. Transmetohet tek Buhariu nga Ibn Mesudi [radijallahu anhu] se Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Sa herë që dikush vritet padrejtësisht, i biri i parë i Ademit [alejhi selam] ka një pjesë të përgjegjësisë në këtë krim, sepse ai ishte i pari që e shkaktoi vrasjen.”*¹¹

¹¹ Shiko tek Sahih El-Buhari, kapitulli “Krijimi i Ademit dhe pasardhësit e tij”, v. IV, f. 104.

Hudi [alejhi selam]

Allahu i Madhërishëm e dërgoi Hudin [alejhi selam] tek populli i tij, Adi. Ata ishin arabë të kohëve të largëta.¹² Ata banonin në El-Ahkaf, në jug të shkretëtirës Er rub' el ha'i në drejtim të Omanit dhe Hadrameutit.¹³

Emrin e vendbanimit të tyre e ka njëra nga suret e Kur'anit Famëlartë, surja *El-Ahkaf*.

Ata kishin një qytet madhështor që quhej Irem që përmendet edhe në ajetin kur'anor, ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad, banorë të Iremit me pallate shumështyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?!”* (El-Fexhr: 6-8)¹⁴

Populli i Adit kanë jetuar rreth tre mijë e pesëqind vite para hixhretit, e disa të tjerë thonë edhe më shumë ose më pak.¹⁵

¹² Shiko tek Hadun El-Atas “U kthye në histori”, f. 15, dhe tek Xhevad Ali “El-mefsal fi tarih el-arab”, v. I, f. 299-310.

¹³ Shiko tek Jakut El-Hamevij “Mu’xhem el buldan”, v. I, fq. 115, El Bekri “Mu’xhem ma istaxhem”, v. I, f. 119, Ebul Fida “El-muhtesar fi ahbar el-besher”, v. I, f. 26, El-Jakubi “Et-tarih”, v. I, f. 22, Abdul Vehab En Nexhar “Kisas el-enbija”, f. 71, Xhevad Ali “El-mefsal”, v. I f. 311, El-Bedravi “Kisas el-enbija ve et-tarih”, f. 148.

¹⁴ Shiko tek Jakut El-Hamevij “Mu’xhem el-buldan”, v. I, f. 155.

¹⁵ Shiko tek Hadun El-Atas “U kthye në histori”, f. 77, si dhe dr. Muhamed Bejumi Mehran “Dirasat tarihije minel-Kur’an fi bilad

Kur'ani Famëlartë e konfirmon faktin se ata janë populli më i afërt me periudhën e Nuhut [alejhi selam], sepse Allahu i Madhërishëm thotë: *“A po çuditeni që këshilla e Zotit tuaj t’ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen? Kujtoni që Ai ju bëri zëvendës pas popullit të Nuhut dhe ju dha trup e fuqi të madhe. Kujtoni dhuntitë e Allahut, në mënyrë që të keni sukses!”* (El-A’raf: 69)

Populli i Adit ishin njerëz me një qytetërim material të dalluar.¹⁶

Ata ishin të fortë fizikisht dhe ishin të bashkuar, gjë që i bënte një forcë goditëse dhe dominuese. Allahu i Madhërishëm u kishte dhënë atyre edhe begati të tjera në vendbanimin e tyre, duke u dhënë aftësi ndërtuese të spikatura.¹⁷

Këtë na e vërteton Kur'ani Famëlartë, ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“Fisi Ad i quante gënjeshtarë të dërguarit. Kujto kur vëllai i tyre - Hudi, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut? Pa dyshim, unë jam i dërguar i besuar për ju, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Për këtë, unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë*

el-arab”, f. 260, i cili i rendit ata direkt pas popullit të Salihut dhe menjëherë para Ibrahimit [alejhi selam].

¹⁶ Shiko tek Hadun El-Atas “U kthye në histori”, f. 69, si dhe dr. Muhamed Bejumi Mehran “Dirasat tarihije minel-Kur’an fi bilad el-arab”, f. 242.

¹⁷ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 110.

shpërblimi, mua do të më shpërblejë vetëm Zoti i botëve. A mos vallë në çdo kodrinë po ngrini përmendore, për t'u tallur, dhe ngrini pallate, sikur do të jetoni gjithmonë? Edhe kur përdorni forcën, e shfrytëzoni atë si tiranë. Andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Frikësojuni Atij, i Cili ju ka dhuruar ato që i dini: ju dhuroi juve bagëti dhe fëmijë, edhe kopshtije, edhe burime. Unë, me të vërtetë, i trembem për ju dënimit të një Dite të madhe." Ata thanë: "Për ne është njëlloj: na këshillove ose nuk na këshillove ti. Këto janë vetëm doket e popujve të lashtë e ne nuk do të jemi të dënuar." (Esh-Shuara: 123-138)

Forca dhe fuqia e tyre fizike dhe ekonomike i shtyu ata që t'u bëjnë padrejtësi popujve të tjerë dhe të shkaktojnë shkatërrim në tokë.¹⁸

Këtë e vërteton Kur'ani Famëlartë, ku Allahu i Madhërishëm thotë:

"Sa i përket fisit Ad, ata u treguan arrogantë në Tokë dhe, pa kurrfarë të drejte, thoshin: "Kush është më i fortë se ne?" Vallë, a nuk e dinin ata se Allahu që i kishte krijuar, është më i fuqishëm se ata?! Kështu, ata i mohuan shpalljet Tona." (Fussilet: 15)

¹⁸ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 110, dhe librin "Historitë e profetëve" të autorit Eth-Thalebi, f. 60, si dhe tek Ibnul Ethiri në librin "El-kamil", v. I, f. 86, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. I, f. 121, si dhe tek El-Bedravi "Kisas el-enbija, f. 48.

Populli i Adit e mohuan Zotin dhe nuk e besuan profetin e tyre. Disa nga paria e tyre ishin promotorë dhe nxitës të krimit, mohimit të Zotit, padrejtësisë dhe korrupsionit në tokë. Këtë e vërteton Kur'ani Famëlartë, ku Allahu i Madhëri-shëm thotë: *“Por paria e popullit të tij, e cila nuk besonte dhe e mohonte takimin në botën tjetër dhe, së cilës, i kishim dhënë të mira në këtë botë, tha: “Ky është vetëm njeri si ju, ha nga ato që hani edhe ju dhe pi nga ato që pini edhe ju! Nëse ju i bindeni një njeriu si ju, me siguri, do të jeni të humbur! A ju premtan ai që, kur të vdisni e të bëheni pluhur dhe eshtra, do të ringjallen vërtet?! Sa premtim qesharak që është! Nuk ka jetë tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më. Ai është vetëm një njeri që trillon gënjeshtër për Allahun, prandaj nuk i besojmë atij.”* (I dërguari) *tha: “O Zoti im, më ndihmo, sepse ata më akuzojnë se gënjej!”* (Allahu) *tha: “Së shpejti do të pendohen!”* E, me të drejtë i kaploi ata një zë i tmerrshëm dhe Ne i bëmë si gjethë të fishkura. *Larg qoftë* (nga mëshira e Allahut) *populli keqbërës!”* (El-Mu'minun: 33-41)

Ky ishte përfundimi i këtyre mohuesve kokëfortë që shkaktonin shkatërrime në tokë dhe u bënë padrejtësi të tjerëve. Për këtë arsye, padrejtësia ndaj njerëzve dhe dëmtimi i tyre konsiderohen nga sjelljet e mohuesve të Zotit që tregohen mendjemëdhenj që nuk e besojnë dënimin e Zotit në dynja dhe në ahiret.

Salihu [alejhi selam]

Allahu i Madhërishëm e dërgoi Salihun tek populli i tij, Themudi, që banonin në Gadishullin Arabik.¹⁹

Sipas mendimeve më të sakta, populli i Salihut kanë jetuar afërsisht një mijë e pesëqind vjet para Krishtit.²⁰

Ata banonin në zonën e quajtur Hixhr, emër të cilin e ka edhe një sure në Kur'anin Famëllartë. Populli i Salihut jetonin në këtë vend duke gëzuar siguri dhe mirëqenie të lartë. Në këtë kohë ky vend quhet "Medainu Salih". Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka kaluar pranë këtij vendi kur po shkonte në betejën e Tebukut.²¹

¹⁹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 116, dhe tek Ibnul Ethiri në librin "El-kamil", v. I, f. 89, si dhe tek El-Mesudi në librin "Murevixh edh-dheheb", v. II, f. 14, si dhe tek Xhevad Ali "El-mufessal", v. I, f. 310.

²⁰ Shiko tek Abdul Vehab En-Nexhar "Kisas el enbija", f. 79 si dhe dr. Muhamed Bejumi Mehran "Dirasat tarihije minel-Kur'an fi bilad el-arab", f. 280, i cili, edhe pse është i mendimit se ata kanë jetuar pas Ibrahimit [alejhi selam], duket se ata që kanë jetuar në kohën e Ibrahimit [alejhi selam] dhe kanë jetuar edhe disa shekuj pas tij, janë ata që kanë shpëtuar bashkë me Salihun [alejhi selam].

²¹ Shiko Buhariun, v. V, f. 135, Ibnu Hisham "Es-sijre en-nebevije", f. 521, Ahmed ibn Hanbel në "El-Musned", v. II, f. 66, Es-Salihi Esh-Shami "Subul el-huda ve er-reshad", v. V, f. 644 dhe tek Es-

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kujto kur vëllai i tyre - Salihu, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut? Pa dyshim, unë jam një i dërguar i besuar për ju, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Për këtë, unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi, mua do të më shpërblejë vetëm Zoti i botëve. Vallë, a mendoni ju, se do të mbeteni këtu të sigurt, në kopshtije e pranë buri-meve, në ara me të lashta dhe palma hurmash me fruta të shijshme? Ju i gdhendni shtëpitë në male me mjeshtri të rrallë, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua, dhe mos dëgjoni urdhrat e atyre që e teprojnë në të keqe e të cilët bëjnë nga-tërresa në Tokë e nuk sjellin përmirësim.”* (Esh-Shuara: 142-152)

Allahu i Madhërishëm i dha popullit të Salihut një jetë të begatë. Ai u dha atyre një vendbanim të mirë plot bollëk aq sa jeta e tyre ishte e sigurt dhe e qëndrueshme. Siguria që gëzonte shoqëria e Themudit ishte tipari më dallues i tyre përkrah mirësive të tjera të shumta që i gëzonin.²²

Pikërisht me këtë mirësi që gëzonin ata filloi edhe përkujtimi që Salihu u bëri atyre për të mos e humbur këtë për shkak të mohimit të Zotit dhe padrejtësive që ata i bënin vetes së tyre. Kjo duket

Senedij “Et-tebrul mesbuk fi mervijat gazveti tebuk”, f. 430, si dhe tek El-Bedravi “Kisas el-enbija ve et-tarih”, f. 37.

²² Shiko tek El-Bedravi “Kisas el-enbija ve et-tarih”, f. 37.

qartë në ajetin kur'anor, ku thuhet: *“Vallë, a mendoni ju, se do të mbeteni këtu të sigurt?!” Ai i paralajmëroi ata për pasojat e mohimit të Zotit dhe kundërshtimit të urdhrave të Allahut duke i shkelur ato, sepse në këtë mënyrë ata do ta humbisnin dynjanë dhe ahiretin bashkë. Por populli i Themudit e sulmoi dhe e vrau devenë që profeti i tyre i kishte paralajmëruar që të mos e dëmtonin: “Ndërsa fisit Themud Ne i dërguam vëllain e tyre, Salihun. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Në të vërtetë, juve ju është dhënë një shenjë e qartë nga Zoti juaj: kjo deve e Allahut për ju është një mrekulli. Lëreni të kullojë në tokën e Allahut dhe mos i bëni ndonjë të keqe, se ju pret ndëshkimi i ashpër!” (El-A'raf: 73) Ata i bënë padrejtësi vetes së tyre, e kundërshtuan urdhrin e Zotit dhe e therën atë.*

Për një çast mund të mendojmë se ai që e theri devenë ishte një person i vetëm, por e vërteta është se i gjithë populli u bënë bashkëpunëtorë në krim, ose duke e miratuar veprimin e tij dhe duke e ndihmuar atë, ose me heshtjen dhe indiferentizmin e tyre ndaj krimit, duke e parë atë ta kryente krimin dhe duke mos bërë asgjë për ta penguar atë që të mos e kryente atë krim. Në këtë mënyrë, ata të gjithë e merituan ndëshkimin e Allahut të Madhërishëm, i Cili thotë: *“Fisi i Themudit, nga shfrenimi i vet - përgënjeshtroi; kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë). I Dërguari*

i Allahut (Salihu), u tha atyre: “Kjo është deveja e Allahut! Lëreni atë të pijë pjesën e vet!” Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit, pa pasur frikë prej pasojave të kësaj.” (Esh-Shems: 11-15)

Nga historia e popullit të Salihut na bëhet e qartë se ekziston një grup njerëzish arrogantë dhe mendjemdhenj që ngrenë krye kundër urdhrave të Allahut të Madhërishëm dhe marrin guximin t’u bëjnë padrejtësi njerëzve për shkak të mendjemadhësisë dhe kokëfortësisë së tyre. Ishin pikërisht këta që morën guximin për ta bërë këtë krim.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Por paria arrogante e popullit të tij u tha të shtypurve në radhët e atyre që kishin besuar: “A e pranoni që Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?” Ata thanë: “Sigurisht që ne besojmë në gjithçka që i është shpallur atij”. Ata që ishin kryelartë, thanë: “Ne nuk besojmë në atë që besoni ju”. Kështu, ata e therën devenë pa e përfillur urdhrin e Zotit të tyre dhe thanë: “O Salih, sillna atë që na ke premtuar, nëse je vërtet i dërguar!” (El-A’raf: 75-77)*

Po ashtu, me gjithë ekzistencën e këtij grupi të kriminelëve, pa dyshim që dikush prej tyre ishte më i guximshëm se të tjerët për ta kryer krimin dhe i udhëheq edhe të tjerët drejt këtij krimi. Kjo është cilësia kryesore që i dallon grupet

kriminale, të cilat kanë gjithmonë një lider që ka guxim më shumë se të tjerët për të kryer krime. Në mesin e këtij grupi tek populli i Salihut ishte një person i tillë që quhej Kidar ibn Salif dhe ishte pikërisht ai që e theri devenë.²³

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Fisi i Themudit, nga shfrenimi i vet - përgënjeshtroi; kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë). I Dërguari i Allahut (Salihu), u tha atyre: “Kjo është deveja e Allahut! Lëreni atë të pijë pjesën e vet!” Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit, pa pasur frikë prej pasojave të kësaj.”* (Esh-Shems: 11-15)

Ajo që ia shton kriminelit guximin për ta kryer krimin është kryerja e përsëritur e krimit dhe fakti që ai është njeri i prishur. Kjo ia shton atij edhe më shumë guximin dhe iniciativën për ta bërë herë pas here të njëjtin krim. Ishte pikërisht kjo ajo që kishte ndodhur me personin që theri devenë, sepse konteksti i ajetit kur’anor lë të kuptojmë se ata e përzgjodhën atë dhe i kërkuan pikërisht atij që ta kryente këtë krim: *“Por ata thirrën shokun e tyre, i cili e mori dhe e theri.”* (El-Kamer: 29)

²³ Shiko tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 22, Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 117, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 68, tek El-Kadai në “El-inbau bienbail-enbija”, f. 58, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 135.

Me anë të kërkimeve dhe studimeve gjejmë se shumë prej krimeve që kryhen shoqërohen edhe me përdorimin e lëndëve narkotike ose pijeve dehëse.

Nga historia e Salihut me popullin e Themudit mësojmë, gjithashtu, në një pjesë tjetër se ekzistonte një grup kriminelësh të organizuar që kishin thurur një plan për ta vrarë edhe Salihun [alejhi selam] në fshehtësi që të mos kapeshin më pas. Ata ishin përgatitur deri në hollësi për këtë qëllim, por Allahu i Madhërishëm e bëri të dështojë planin e tyre dhe e mbrojti të dërguarin e Tij nga këta kriminelë dhe i shkatërroi ata.²⁴

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Në qytet kishin qenë nëntë vetë që bënë ngatërresa e nuk vinin rregull. Ata i thanë (njëri-tjetrit): “Betohuni në Allahun se natën do ta vrasim atë me gjithë familjen e tij. Pastaj do t’u themi të afërmeve të tij se ne nuk kemi qenë të pranishëm në zhdukjen e familjes së tij dhe se po themi të vërtetën.” Dhe kurdisën një kurth, por Ne u ngritëm një grackë, pa e ndier ata. Tani shiko se si ka qenë fundi i ngatërresave të tyre. Ne i shkatërruam ata të gjithë dhe popullin e tyre. Ja shtëpitë e tyre të rrënuara, për shkak të këqijave që bënë.*

²⁴ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 117, tek El Kadai në “El-inbau bienbail-enbija”, f. 58, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 19, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 135, tek El-Bedravi “Kisas el-enbija ve et-tarih”, f. 165.

Sigurisht që këtu ka këshillë për njerëzit që dinë. Ndërsa, ata që kishin besuar dhe (i) frikësoheshin (Allahut), Ne i shpëtuan.” (En-Neml: 48-53)

Allahu i Madhërishëm i shkatërroi zullum-qarët dhe kriminelët e popullit Themud dhe e shpëtoi Salihun dhe besimtarët që ishin bashkë me të.²⁵

²⁵ Shiko detajet e shkatërrimit të tyre tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 118, si dhe tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 92.

Ibrahimi [alejhi selam]

Babai i Ibrahimit [alejhi selam] quhej Azer. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Përkujto (o i dërguar) kur Ibrahimi i tha babait të vet, Azerit: “A statuja (idhuj) adhuron për zota? Unë po të shoh ty dhe popullin tënd në një humbje të sigurt.”* (El-En’am: 74)

Origjina e Ibrahimit [alejhi selam] është nga Sami, djali i Nuhut [alejhi selam], Ibrahimi [alejhi selam], lindi në tokën e Keldanit në Eur, Babil, pëafërsisht një mijë e nëntëqind vjet para Krishtit.²⁶

Ai u rrit në një shoqëri idhujtare ku ishte përhapur adhurimi i idhujve dhe planeve. Allahu i Madhërishëm e mbrojti atë nga shirkut (shokvënia ndaj Allahut) dhe ai qëndroi në besimin e pastër të njësimt të Zotit, duke refuzuar të gjitha format e padrejtësisë, duke filluar me padrejtësinë e shirkut që është edhe më e madhja. Populli i tij u përpoqën që ta largojnë atë nga feja e vërtetë dhe njësimi i Zotit, madje e kërcënuan që

²⁶ Shiko tek Ibn Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 141, si dhe tek Abdul-Ganij Abud “Enbijaullah vel-hajatul muasire”, f. 46, tek Ebul Fida “El-muhtesar”, v. I, f. 16, tek Mehrani “Dirasat tarihiye minel Kur’an”, f. 126, si dhe tek Keneth Kanterz dhe të tjerë “Et-tefsir et tatbijki lilkitab el-mukades”, f. 5.

të mos e kundërshtonte besimin e tyre të kotë, duke i thënë se zotat e tyre do t'i bënin keq atij nëse vazhdonte në këtë mënyrë dhe nuk do të ishte më i sigurt në atë vend. Mes Ibrahimit [alejhi selam] dhe popullit të tij u zhvillua një dialog ku ai ua bëri të qartë fenë e vërtetë që ai ndiqte dhe se kush e meritonte më shumë të ishte i sigurt. Këtë dialog na e tregon vetë Kur'ani Famëlartë, ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”* Dhe, kur populli i tij polemizoi me të, ai tha: *“Doni të polemizoni me mua për Allahun, ndërkohë që Ai më ka udhëzuar në rrugën e drejtë?! Unë nuk i kam frikë idhujt tuaj, sepse vetëm po të dojë Zoti im, ato mund të më lëndojnë. Zoti im, me dijeninë e vet ka përfshirë çdo gjë. A nuk po mendoni? E si të frikësohem nga zotat tuaj të rremë, ndërkohë që ju nuk keni frikë t'i shoqëroni Allahut idhuj, për të cilët Ai nuk ju ka zbritur kurrfarë argumenti?! Cili nga ne e meriton të jetë i sigurt? Më thoni, nëse njihni të vërtetën! Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.”* Ky është argumenti Ynë, të cilin Ne ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë kë të duam në shkallë të lartë. Vërtet, Zoti yt është i Urtë e i Gjithëdijshëm.” (El-En'am: 79-83)

Siguria e vërtetë ishte ajo që gëzonte Ibrahimimi [alejhi selam], të cilin nuk e dëmtuan as idhujt e tyre që nuk i bënë dobi dhe as nuk i mbronin dot as vetet e tyre kur Ibrahimimi [alejhi selam] i goditi dhe i rrëzoi.

Ibrahimimi [alejhi selam] ishte i mëshirshëm dhe paqësor me gjithë kërcënimet që i bëheshin. Ai e ftoi babanë e tij drejt besimit të vërtetë dhe shpëtimit në të dy botët, por përgjigja i erdhi e mbushur më kërcënime për ta goditur me gurë, madje edhe për ta vvarë.²⁷

Allahu i Madhërishtëm thotë: *“O babai im, unë kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi e kështu të bëhesh i afërm i djallit!” Ai u përgjigj: “O Ibrahim! Si guxon t’i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!” Ibrahimimi tha: “Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t’i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua.”* (Merjem: 45-47)

Kur Ibrahimimi i theu idhujt e tyre, idhujtarët e ndjenë dështimin, sepse idhujt nuk patën mundësi që t’i mbronin vetet e tyre. Për këtë arsye, ata organizuan një gjyq publik për Ibrahimimin [alejhi selam]. Ata ftuan njerëzit të merrnin pjesë për t’i

²⁷ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f.118, si dhe tek Ebul Fida “El-muhtesar”, v. I, f. 27, si dhe tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 96.

hedhur poshtë argumentet e Ibrahimit [alejhi selam], por ndodhi e kundërta dhe doli në pah se ishin vetë ata që kishin gabuar, duke i adhuruar këta idhuj që nuk mundën dot të mbronin as vetet e tyre. Ky gjyq ishte i padrejtë ndaj Ibrahimit [alejhi selam] dhe argumenteve të tij të qarta, prandaj edhe vendimi ishte i padrejtë.²⁸

Ata vendosën ta djegin atë të gjallë, por Allahu i Madhërishëm e shpëtoi nga duart e tyre me anë të një mrekullie. Ai e urdhëroi zjarrin të mos e digjte, duke bërë që të ndryshojnë edhe ligjet e natyrës për ta shpëtuar robin e Tij nga padrejtësia e këtyre tiranëve. Gjykimi që iu bë Ibrahimit [alejhi selam] ishte publik dhe njerëzit kishin ardhur ngado për ta ndjekur atë dhe e panë se e vërteta ishte në anën e tij, megjithatë ata këmbëngulën në inatin dhe kokëfortësinë e tyre dhe vazhduan të ndjekin rrugën e gabuar.

Allahu i Madhërishëm na e tregon këtë histori me hollësi, duke thënë: *“Në të vërtetë, Ne e udhëzuam Ibrahimin në rrugë të drejtë qysh më parë dhe e njihnim atë (se ishte i aftë për këtë gjë). Kur ai i tha të atit dhe popullit të tij: “Ç’janë këta idhuj, që ju po i adhuronit kaq shumë?” Ata thanë: “Baballarët tanë i adhuronin këta.” (Ibrahimi) tha: “Me të vërtetë, ju dhe baballarët tuaj keni qenë në humbje*

²⁸ Shiko tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 76, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 98, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 145.

të qartë." Ata thanë: "A po na sjell të Vërtetën apo je nga ata që tallen?" Ai tha: "Jo, por Zoti juaj është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Është Ai që i ka krijuar ato, ndërsa unë jam njëri prej atyre që e dëshmojnë këtë. (Betohem) për Allahun, se do t'i flak idhujt tuaj, posa të largoheni ju!" Dhe i bëri ata copacopa, përveç idhullit të tyre më të madh, kështu që ata t'i drejtoheshin atij. Disa thanë: "Kush i bëri kështu zotat tanë? Me të vërtetë, ai është keqbërës!" Të tjerët u përgjigjën: "Dëgjuam një djalosh që i përgojonte, quhej Ibrahim." "Atëherë silleni atë para syve të botës, që ata të dëshmojnë." - thanë ata. Ata e pyetën: "Ti i bërë kështu zotat tanë, o Ibrahim?" Ai tha: "Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre. Pyesni ata, nëse flasin!" Atëherë ata i thirrën mendjes dhe i thanë njëri-tjetrit: "Me të vërtetë, ju vetë jeni keqbërësit." Pastaj ulën kokat dhe i thanë: "Sigurisht që ti e di, se këta nuk flasin!" Ai u tha: "Mos vallë, ju adhuron në vend të Allahut gjëra që nuk mund t'ju sjellin kurrfarë dobie e as dëmi?! Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuron në vend të Allahut! A nuk arsyetoni?!" Ata thirrën: "Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni të bëni ndonjë vepër!" Ne thamë: "O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!" Ata deshën ta lëndonin, por Ne i bëmë të dështonin." (El-Enbija: 51-70)

Ibrahimi [alejhi selam] u largua nga Iraku dhe u vendos për të jetuar në Sham.²⁹

²⁹ Shiko tek El-Jakubi në "Et-tarih", v. I f. 24, Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 125, tek Eth-Thalebi në librin "Kisas el-enbija", f. 79.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Luti i besoi atij dhe tha: “Unë do të mërgoj te Zoti im; me të vërtetë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”* (El-Ankebut: 26); *“Ne e shpëtuan atë dhe Lutin (dhe i çuam) në tokën, të cilën e kemi bekuar për njerëzit.”* (El-Enbija: 71)

Ibrahimi [alejhi selam] ishte shumë bujar. Ai ftonte shumë miq dhe i gostiste e më pas i këshillonte dhe i ftonte në besimin e vërtetë. Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e ka përshkruar atë në një hadith që transmetohet tek Buhariu, i cili transmeton se Ibn Omeri [radijallahu anhu] transmeton se Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Bujar, bir bujari, bir bujari, bir bujari, Jusufi i biri i Jakubit, i biri i Is’hakut, i biri i Ibrahimit, paqja e Zotit qoftë mbi ta.”*³⁰

Ibrahimit [alejhi selam] mund t’i vinte rreziku nga ndonjë i ftuar që vinte në shtëpinë e tij si mik, megjithatë ai nuk hoqi dorë nga mikpritja dhe bujaria e tij. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Të dërguarit Tanë, i sollën Ibrahimit lajmin e mirë dhe i thanë: “Paqe mbi ty!” Ai u përgjigj: “Paqja qoftë mbi ju!” Dhe me të shpejtë u solli atyre një viç të pjekur. Kur pa se ata nuk po i zgjasnin duart tek mishi, nuk i pëlqeu dhe ndjeu frikë prej atyre. (Engjëjt) thanë: “Mos u frikëso, Ne jemi dërguar te populli i Lutit!”* (Hud: 69-70)

³⁰ Transmetohet tek Buhariu, v. IV, f. 121.

Ibrahimi u tremb për shkak se ata nuk hëngrën nga ushqimi që u ofroi me gjithë bujarinë e treguar nga ana e tij.

Në disa transmetime tregohet se Ibrahimi [alejhi selam] dhe bashkëshortja e tij, Sara, u përballën me padrejtësinë e njërit nga mbretërit tiranë të asaj kohe, i cili tentoi të vinte dorën mbi Sarën dhe Ibrahimi [alejhi selam] u detyrua nga frika të thoshte se ajo ishte motra e tij për të shpëtuar nga mbreti. Më në fund Allahu i Madhërishëm e shpëtoi Sarën nga duart e atij tirani.³¹

Ibrahimi [alejhi selam] jetoi gjatë dhe gjatë gjithë jetës së tij u përpoq t'i zbatonte urdhrat e Allahut të Madhërishëm, ta përhapte fenë dhe t'i edukonte fëmijët e tij me mirësi dhe besim që edhe ata t'i ftonin njerëzit drejt së mirës, t'i ndihmonin ata dhe shumë e shumë gjëra të tjera për të cilat ata janë shquar më pas, derisa më në fund ia dorëzoi shpirtin Allahut të Madhërishëm në Palestinë dhe po aty u varros.³²

³¹ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. I, f. 151.

³² Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 161, tek Eth-Thalebi në librin "Kisas el-enbija", f. 98, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. I, f. 173.

Luti [alejhi selam]

Luti [alejhi selam] ishte djali i vëllait të Ibrahimit [alejhi selam] dhe i kishte besuar atij.³³

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Luti i besoi atij dhe tha: “Unë do të mërgoj te Zoti im; me të vërtetë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”* (El Ankebut: 26)

Luti [alejhi selam] emigroi bashkë me Ibrahimin [alejhi selam] drejt tokave të Shamit dhe u vendos në fshatin e quajtur Sedum, që ishte një vendbanim afër Kudsit në atë kohë.³⁴

Allahu i Madhërishëm e ngarkoi Lutin [alejhi selam] me detyrën e profetit që t’ua tërhiqte vëmendjen banorëve të këtij vendi, të cilët kryenin krime fetare, morale dhe financiare. Ata praktikonin homoseksualitetin deri në atë masë sa

³³ Shiko tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 24, Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 125, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 149

³⁴ Shumica e historianëve janë të mendimit se fshati Sedum (Sodoma) gjendet në fund të Detit të Vdekur. Për më shumë shiko tek El-Bekri “Mu’xhemu ma ista’xhem”, v. II, f. 729, si dhe tek Jakut El-Hamevij “Mu’xhem el-buldan”, v. III, f. 201.

ishte kthyer në pjesë të përditshmërisë së tyre dhe e praktikonin atë haptazi kudo.³⁵

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kujtoni fjalët e Lutit, i cili i tha popullit të vet: “Përse bëni paturpësi të tilla që askush nuk i ka bërë në botë?” Ju u qaseni meshkujve me epsh - në vend të femrave. Me të vërtetë, ju jeni popull që e teproni me të këqija!”* (El-A’raf: 80-81)

Po ashtu, thotë: *“Kur Luti i tha popullit të vet: “Përse bëni vepra të mbrapshta e të turpshme, madje në sytë e njëri-tjetrit? Vallë, a mos ju u qaseni me epsh meshkujve, në vend të femrave? Në të vërtetë, ju jeni popull i paditur.”* (En-Neml: 54-55)

Gjithashtu, thotë: *“Populli i Lutit i quante gënjeshtarë të dërguarit. Kujto kur vëllai i tyre - Luti, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut? Pa dyshim, unë jam i dërguar i besuar për ju, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Për këtë, unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërbli mi, mua do të më shpërblejë vetëm Zoti i botëve. Vallë, ju, nga e gjitha bota, iu qaseni meshkujve e i lini mënjane gratë tuaja, të cilat Zoti juaj i ka*

³⁵ Shiko tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 25, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 118, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 180, tek Dhiata e Vjetër “Zanafilla”, f. 19, si dhe tek Keneth Kanterz dhe të tjerë “Et-tefsir et-tatbijki lilkitab el-mukaddes”, f. 52, si dhe tek Abdul Ganij Abud “Enbijaullah vel hajatul muasire”, f. 49.

krijuar bashkëshorte për ju?! Njëmend, ju jeni popull që kaloni çdo kufi të së keqes.” (Esh-Shuara: 160-166)

Ata e kryenin këtë gjynah edhe në mjedise publike, madje në mes të ditës, në sy të të gjithëve pa ndierë aspak turp. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur Luti i tha popullit të vet: “Vërtet, ju bëni të tilla lapërdhi, që askush para jush nuk i ka bërë në botë: bëni marrëdhënie me meshkuj, u zini pusi atyre dhe në tubimet tuaja bëni punët më të ndyrra”, populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveç se tha: “Na e sill dënimin e Allahut, nëse thua të vërtetën!” Ai tha: “O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën mbrapshti!””* (El-Ankebut: 28-30)

Ata nuk mjaftoheshin vetëm me kryerjen e kësaj të keqe mes tyre, por u bënë keq edhe atyre që i qortonin dhe i këshillonin të largoheshin nga ky gjynah, duke i detyruar edhe ata ta kryenin të njëjtën gjë. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Përgjigjja e popullit të tij ishte: “Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të dëlirë.”* (El-A’raf: 82)

“Ata thanë: “Nëse nuk tërhiqesh nga këto, o Lut, me siguri do të jesh i dëbuar.” (Esh-Shuara: 167)

“... Përgjigjja e vetme e popullit të tij ishte: “Dëbojeni familjen e Lutit prej qytetit tuaj, sepse ata janë njerëz të dëlirë!” Dhe Ne i shpëtuan atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij, së cilës i

caktuam që të mbetej me të dënuarit.” (En-Neml: 56-57)

“Ata thanë: “Nëse nuk tërhiqesh nga këto, o Lut, me siguri do të jesh i dëbuar.” Ai tha: “Unë kam vërtet neveri për atë që bëni ju! O Zoti im, më shpëto mua dhe familjen time nga ajo që bëjnë ata!” Dhe Ne e shpëtuan atë dhe familjen e tij - të gjithë, përveç një plake (gruas së Lutit), e cila mbeti me të tjerët. Pastaj, të tjerët i shkatërruam.” (Esh-Shuara: 167-172)

Ata sulmonin karvanët dhe kalimtarët e rastit për t'i plaçkitur dhe për t'ua cenuar nderin.³⁶

Luti [alejhi selam] i ndalonte ta bënë këtë dhe qortonte duke u thënë: *“Ju bëni marrëdhënie me meshkuj, u zini pusi atyre dhe në tubimet tuaja bëni punët më të ndyra.”* (El-Ankebut: 29)

Allahu i Madhërishëm, gjithashtu, thotë: *“Luti u tha: “Këta janë mysafirët e mi, andaj mos më turpëroni! Kijeni frikë Allahun e mos më poshtëroni!” Ata thanë: “A nuk ta kemi ndaluar ne që të presësh mysafirë?”* (El-Hixhr: 68-70)

Ata vazhdimisht i sulmonin seksualisht të gjithë ata që vinin në qytetin e tyre dhe u

³⁶ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 153, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 105, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 180.

përpoqën të bënin të njëjtën gjë edhe me miqtë që kishin ardhur tek Luti [alejhi selam], por ata ishin engjëj dhe Allahu i Madhërishëm i mbrojti, kurse këta njerëz të shthurur i dënoi.³⁷

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe, kur të dërguarit erdhën te Luti, ai tha: “Unë nuk ju njoh ju!” Ata thanë: “Jo, ne të kemi sjellë atë, në të cilën ata dyshojnë, të kemi sjellë të vërtetën, prandaj të jesh i sigurt se ajo që të themi, do të bëhet. Nisu me familjen tënde në një kohë të natës, shko pas tyre e askush prej jush të mos shikojë prapa, por vazhdoni në drejtimin e urdhëruar!” Dhe Ne ia shpallëm atij atë që do të ngjajë: që i gjithë populli i tij, deri në të mbramin, do të zhdukej në agim. Banorët e qytetit erdhën tek ai gjithë gëzim. Luti u tha: “Këta janë mysafirët e mi, andaj mos më turpëroni! Kijeni frikë Allahun e mos më poshtëroni!”. Ata thanë: “A nuk ta kemi ndaluar ne që të presësh mysafirë?” (El-Hixhr: 61-70)*

Ata i kryenin të gjitha këto gjynahe dhe nuk njihnin asnjë cak në epsheet e tyre, madje i synonin qëllimisht ata që e kundërshtonin një gjë të tillë dhe ua merrnin nderin e tyre forcërisht.³⁸

³⁷ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 151, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 180-181.

³⁸ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 156, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 180.

Allahu i Madhërishëm i përshkruan këto ngjarje me këto fjalë: *“Kur i erdhën të dërguarit Tanë Lutit, Ai u hidhërua, ndjeu një shtrëngim në shpirtin e tij dhe tha: “Kjo është ditë e rëndë!” Populli i tij, që më parë pat punuar vepra të këqija, u vërsul drejt atij. (Luti) tha: “O populli im, këto janë bijat e mia. Ato për ju janë më të pastra, e frikësojuni Allahut dhe mos më turpëroni para mysafirëve të mi. A nuk ka midis jush një njeri me mend?” Ata thanë: “Ti e di se ne nuk kemi të drejtë për bijat e tua. Në të vërtetë, ti e di se ç’duam ne.” Ai tha: “Sikur unë të kisha fuqi (që t’ju dëboj) ose të mbështetesh në ndonjë krah të fuqishëm!” Thanë (mysafirët): “O Lut! Ne jemi të dërguarit e Zotit tënd. Ata nuk mund të të bëjnë ty asgjë e pra, nisu ti me familjen tënde në orët e vona të natës dhe askush prej jush të mos këqyrë prapa, përveç gruas sate. Atë do ta godasë ajo që do t’i gjejë edhe ata. Afati i tyre është agimi i ditës. Vallë, a nuk është afër agimi i ditës?!” Kur erdhi urdhri Ynë, Ne e përmbysëm çdo gjë, - ato që ishin lart, i kthyem poshtë dhe mbi ata lëshuam gurë nga balta e pjekur, duke rënë vazhdimisht, si shiu.” (Hud: 77-82)*

Gjynahu i homoseksualitetit dhe imoralitetit nuk ishin gjynahet e vetme të popullit të Lutit [alejhi selam]. Ata i sulmonin karvanët dhe kalimtarët për t’i plaçkitur dhe i terrorizonin njerëzit, duke u rrezikuar jetën dhe pasurinë e tyre. Këto

dhe shumë gjynahe të tjera, që kanë të bëjnë me argëtimin, ishin shumë të përhapura ndër banorët e Sedumit (Sodomës).³⁹

Luti [alejhi selam] i kishte ndaluar ata që t'i bënin këto gjynahe, ua kishte tërhequr vëmendjen ndaj ndëshkimit të Zotit dhe i kishte ftuar ata drejt besimit të drejtë, por ata këmbëngulnin në krimet dhe gjynahet e tyre aq sa luteshin që t'u vinte dënimi. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ju bëni marrëdhënie me meshkuj, u zini pusi atyre dhe në tubimet tuaja bëni punët më të ndyra.”* *Populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveç se tha: “Na e sill dënimin e Allahut, nëse thua të vërtetën!”* (El-Ankebut: 29)

Këta njerëz të shthurur e merituan plotësisht ndëshkimin që u dërgoi Allahu i Madhërishëm. Pjesë e atyre që u ndëshkuan ishte edhe bashkëshortja e Lutit [alejhi selam], sepse zemra e saj ishte me popullin e saj. Dijetarët kanë shpjeguar se ishte pikërisht ajo që i njoftoi ata për miqtë që kishin ardhur tek Luti [alejhi selam].⁴⁰

³⁹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 151, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 104, tek Sheukani në “Fet’hul kadir”, v. IV, f. 201, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje” në komentin e sures Hud.

⁴⁰ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 154, si dhe tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 180.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur erdhi urdhëri Ynë, Ne e përmbysëm çdo gjë, - ato që ishin lart, i kthyem poshtë dhe mbi ata lëshuam gurë nga balta e pjekur, duke rënë vazhdimisht, si shiu. (Ato ishin gurë) të shënuar (për dënim) te Zoti yt. Dënimi nuk është larg nga keqbërësit.”* (Hud: 82-83)

Ky krim moral që e kryente populli i Lutit është një nga krimet dhe gjynahet më të rënda që shkaktojnë zemërimin e Allahut të Madhërishëm, prandaj ata e merituan ndëshkimin e rëndë që ra mbi ta. Për këtë arsye, Allahu i Madhërishëm e ka përforcuar ndalimin e vënë për një gjynah të tillë, sepse Ai është Krijuesi dhe është më i dituri për gjërat që i bëjnë dëm ose dobi krijesave të Tij. Është për të ardhur keq se shumë prej shoqërive bashkëkohore të ditëve tona që bazohen në ligje laike dhe ateiste, në Evropë dhe në Amerikë, dhe ata që ndjekin shembullin e tyre në ligjëvënie, nuk shikojnë gjë të keqe tek krimet dhe gjynahet që kryente populli i Lutit. Madje, ata u kanë dhënë leje zyrtare klubeve ku anëtarësohen ata që kanë prirje të tilla seksuale, duke shpresuar, madje, të fitojnë edhe votat e tyre në fushatat zgjedhore, megjithëse kërkimet shkencore e vërtetojnë qartësisht se prirje të tilla seksuale janë shkaku kryesor i përhapjes së sëmundjes së Sidës që merr jetën e miliona njerëzve nëpër botë. Ku janë këta ligjëvënës përballë këtyre fakteve? Ku janë ata që shqetësohen dhe kujdesen për sigurinë shoqërore dhe

shëndetësore në këto shtete moderne që pretendojnë qytetërimin dhe lidershipin e botës, përballë këtyre fakteve? Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë të vërtetën kur tha: *“Sa herë që përhapet imoraliteti në një popull dhe e bëjnë atë haptazi, tek ata përhapen murtaja dhe sëmundje që nuk kanë ekzistuar tek popujt para tyre.”*⁴¹

Për këtë arsye, edhe sanksionet dhe vendimet e ligjeve të Zotit në fenë islame vijnë për t'i ndëshkuar ata që kryejnë imoralitet, në përgjithësi, dhe ata që kryejnë gjynahun e popullit të Lutit (homoseksualizmin), në veçanti, shërbejnë si ndëshkues dhe parandalues për ata që shkaktojnë dhe përhapin në shoqërinë njerëzore sëmundje të rrezikshme fizike dhe sociale. Gazetat dhe revistat me famë botërore informojnë rreth sëmundjes së Sidës dhe lidhjet që ka ajo me problemet familjare, bashkëshortore, prindërore, madje edhe disa krime të vrasjeve në disa raste kryhen nga persona që janë prekur nga kjo sëmundje, pasi janë infektuar nga njerëz të tjerë dhe ata hakmerren ndaj atyre që janë bërë shkak për t'u prekur nga Sida. I Madhëruar qoftë Allahu që e krijoi njeriun dhe vendosi për të rregulla dhe ligje që i bëjnë dobi në jetën e kësaj bote dhe në jetën e botës tjetër.

⁴¹ Transmetohet tek Ibnu Maxhe në “Es-Sunen”, kapitulli i ndëshkimeve, v. IX, f. 400.

Shuajbi [alejhi selam]

Allahu i Madhërishëm e dërgoi Shuajbin [alejhi selam] si profet tek populli i tij në Medjen, i cili është një vend në veriperëndim të Gadi-shullit Arabik. Në ditët e sotme kjo zonë njihet me emrin El-Bida', rreth 120 km në veriperëndim të Tebukut.⁴²

“Banorët e Medjenit ishin arabë që banonin në vendin e quajtur Medjen, që ishte një vendbanim në tokën e Meanit, në kufijtë e Shamit, në drejtim të Hixhazit, afër liqenit të popullit të Lutit dhe kanë jetuar vetëm pak pas tyre. Medjeni ishte një fis emrin e të cilit e mori edhe zona ku jetonin.”⁴³

Ngjarjet e popullit të Shuajbit në Medjen kanë ndodhur në kohën pas Ibrahimit [alejhi selam] dhe para Musait [alejhi selam] që do të thotë afërsisht një mijë e katërqind vjet para Krishtit.⁴⁴

⁴² Shiko tek El-Bekri “Mu’xhem ma istaxhem”, v. II, f. 1201, Jakut El-Hamevij “Mu’xhem el-buldan”, v. V, f. 78, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 184, tek Muhamed El-Xhasir “El-mu’xhem el-xhugrafi fil bilad es-Suudije, v. III, f. 1207, tek Atik Gajth El-Biladi “Mu’xhem el emakin el varide fi es-sireti en-nebevije”, f. 284.

⁴³ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 184.

⁴⁴ Shiko tek Abdul Vehab En-Nexhar “Kisas el-enbija”, f. 185, tek Muhamed Bejumi Mehran “Dirasat tarihije minel-Kur’an fi bilad el arab”, f. 301.

Nga argumentet që e konfirmojnë këtë fakt është edhe ajeti kur'anor, ku Allahu i Madhëri-shëm thotë: *“O populli im, kundërshtimi ndaj meje le të mos ju çojë kurrsesi që t’ju ndodhë ajo, që i ndodhi popullit të Nuhut ose popullit të Hudit apo popullit të Salihut; mos harroni se edhe populli i Lutit nuk është larg prej jush.”* (Hud: 89)

Ky popull ishin idhujtarë që adhuronin idhujt në vend të Allahut të Madhëri-shëm. Ata kishin edhe një pemë që e adhuronin dhe, për shkak të kësaj, u quajtën edhe me emrin “të zotët e Ejkës”.⁴⁵

Përveç idhujtarisë ata kishin edhe gjynahe të tjera për të cilat Shuajbi [alejhi selam] ishte përpjekur t’i ndalonte duke i këshilluar. Ata u bënë padrejtësi të ndryshme njerëzve duke përhapur shkatërrime në tokë. Ata ua merrnin pasuritë njerëzve me anë të mashtrimit, vjedhjes, plaçkitjes së tregtarëve dhe karvanëve në mënyra të ndryshme. Vendi ku banonin ata ishte një pikë kyçe nga ku kalonin tregtarët për të shkuar në drejtime në ndryshme.⁴⁶

⁴⁵ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 168, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 187, si dhe tek Esh-Sheukani në “Fet’hul kadir”, v. II, f. 520.

⁴⁶ Shiko tek El-Halisi në “El-menhexh el islami fil mekajil vel mevazin li nebijilah Shuajb”, f. 23.

Për këtë arsye, profeti i tyre u përpoq shumë për t'i rregulluar ata dhe për t'i larguar nga këto krime dhe gjynahe, duke filluar nga padrejtësia më e madhe, ajo e idhujtarisë, e më pas padrejtësitë që u bënin njerëzve në pasuritë dhe jetët e tyre. Shuajbi [alejhi selam] ishte shumë serioz në përpjekjet e tij për përmirësimin e tyre. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kujto kur Shuajbi u tha atyre: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut? Pa dyshim, unë jam një i dërguar i besuar për ju, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Për këtë, unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërbli-mi, mua do të më shpërblejë vetëm Zoti i botëve. Bëjeni drejt matjen dhe mos u bëni nga ata që hanë (në matje). Peshoni drejtësisht me peshore të saktë, mos ua pakësoni njerëzve gjërat e tyre, mos bëni ngatërresa në Tokë dhe frikësojuni Atij, që ju ka krijuar ju dhe brezat e mëparshëm!”* (Esh-Shuara: 177-184)

Por ata në vend që t'i dëgjonin këto këshilla dhe t'i bindeshin Shuajbit [alejhi selam], e kërcënuan atë personalisht si dhe ata që i besonin atij se do t'i dëbonin nga qyteti dhe do ua konfiskonin shtëpitë dhe pasurinë, madje e kërcënuan se do ta vrisnin duke e goditur me gurë.⁴⁷

Ata e kërcënuan Shuajbin me vdekje për shkak se ai i ftonte vazhdimisht për respektimin

⁴⁷ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 184.

e të drejtave të Zotit dhe të drejtave të njerëzve, si dhe ua kishte pohuar se ai do të ishte i pari që do t'i zbatonte ato rregulla në të cilat i ftonte edhe ata t'i zbatonin. Allahu i Madhërisëm na e tregon në Kur'anin Famëlartë debatin dhe diskutimet mes Shuaibit dhe popullit të tij, duke thënë: *“Popullit të Medjenit Ne i dërguam vëllain e tyre, Shuaibin, i cili u tha: “O populli im! Adhuroni Allahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Me të vërtetë, ju ka ardhur provë e qartë nga Zoti juaj, prandaj matni dhe peshoni saktë, mos u hani hakun njerëzve dhe mos bëni ngatërresa në tokë, pasi të jetë vënë rregulli në të. Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë! Mos zini pusi në çdo rrugë, duke frikësuar dhe penguar nga rruga e Allahut ata që besojnë tek Ai dhe duke kërkuar shtrembërimin e saj! Kujtoni atëherë kur ishit të paktë në numër e Ai ju shumoi. Shikoni si përfundojnë ngatërrestarët! Nëse një grup mes jush beson në mesazhin me të cilin jam dërguar, ndërsa grupi tjetër nuk beson, duroi derisa Allahu të gjykojë midis nesh! Ai është gjykatësi më i mirë!” Paria arrogante e popullit të tij tha: “O Shuaib! Kthehuni në fenë tonë ose do t'ju dëbojmë nga qyteti ynë ty me gjithë ndjekësit e tu.” Shuaibi tha: “Edhe pse e urrejmë atë?! Nëse do të ktheheshim në fenë tuaj, pasi Allahu na shpëtoi nga ajo, atëherë do të shpifnim gënjeshtër kundër Allahut. Ne nuk mund të kthehemi në të, përveçse po të dojë Allahu, Zoti ynë. Ai përfshin çdo gjë me dijeninë*

e Vet dhe tek Ai ne mbështetemi. O Zoti ynë, gjyko drejt midis nesh dhe popullit tonë! Ti je Gjykatësi më i mirë!" Por paria e pafe i tha popullit të tij: "Nëse shkoni pas Shuajbit, atëherë, me siguri, do të jeni të humbur." E kështu, ata i goditi një tërmet i rëndë dhe u gdhinë të shtrirë përmbys në shtëpitë e tyre. Ata që e quajtën Shuajbin gënjeshtar, sikur nuk kishin banuar kurrë në atë vend; ata që e quajtën Shuajbin gënjeshtar, qenë të humbur. Shuajbi u largua prej tyre dhe tha: "O populli im, unë ju solla shpalljet e Zotit tim e ju këshillova, prandaj pse të hidhërohëm për popullin e pafe?!" (El-A'raf: 85-93)

Jusufi [alejhi selam]

Historia e Jusufit [alejhi selam] konsiderohet si një nga historitë më të çuditshme dhe historia me më shumë hollësi në Kur'anin Famëlartë. Po ashtu, edhe fazat e zhvillimit të saj janë shumë të qarta dhe gjenden në të njëjtën sure, surja *Jusuf*.⁴⁸

Ai është Jusufi, i biri i Jakubit, i biri i Is'hakut, i biri i Ibrahimit [alejhi selam].

Jakubi [alejhi selam] kishte dymbëdhjetë djem dhe Jusufi ishte djali i tij i njëmbëdhjetë, dhe ishte më i dashuri për të, për shkak të sjelljes dhe moralit të mirë dhe të bindjes që tregonte ndaj tij, shtu këtu edhe bukurinë, hijeshinë, drojën dhe devotshmërinë me të cilën ishte pajisur që në moshë të vogël.⁴⁹

⁴⁸ Shiko tek Abdurahman es Sa'di "Kisas el-enbija", f. 179, tek Sejid Kutub "Fi dhilal el-Kur'an", v. IV, f. 1950, tek Eth- Thalebi në librin "Kisas el-enbija", f. 111, tek Mehrani "Dirasat tarihiye minel-Kur'an", f. 71. Historia e Jusufit [alejhi selam] është treguar edhe në Dhiatën e Vjetër, por, për shkak të ndryshimeve që u janë bërë, ajo vjen në variante të ndryshme nga ajo që na tregon Kur'ani Famëlartë.

⁴⁹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 169 dhe 180, tek Ibnu Kethiri në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. I, f. 197, tek Ibnul Ethiri në librin "El-kamil", v. I, f. 96, tek Hamza Da'bes "Ekremun nas".

Jakubi [alejhi selam] e kishte të pamundur t'i fshihte ndjenjat e tij ndaj Jusufit [alejhi selam] dhe kjo e bëri atë të frikësohej nga xhelozia e djemve të tjerë ndaj Jusufit [alejhi selam].

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur Jusufi i tha babait të vet: “O babai im! Unë pashë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, Diellin dhe Hënë! I pashë të më përuleshin në sexhde.”, ai i tha: “O biri im! Mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu, që të mos kurdisin ndonjë gjë kundër teje, sepse, vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.”* (Jusuf: 4-5)

Vëllezërit e tij ishin xhelozë për të dhe filluan ta kenë zili, megjithëse ishin besimtarë. Xhelozia dhe zilia u bënë shkak që tek ata të lindte shtysa drejt krimit dhe sulmit ndaj Jusufit [alejhi selam]. Këtu vërejmë se zilia, edhe pse është cilësi e qortueshme, mund të shfaqet jo vetëm tek njerëzit e këqij, por edhe tek zemra e njerëzve të mirë, sado të mirë që të jenë. Këtë e vërejmë në historinë e Jusufit dhe vëllezërve të tij se si zilia i shtyu ata drejt krimit, edhe pse ata ishin njerëz të mirë dhe për faktin se ata kishin vendosur të pendohen pas kryerjes së krimit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Për të gjithë ata që pyesin, në historinë e Jusufit dhe të vëllezërve të tij, ka shumë mësim. Vëllezërit e tij thanë: “Jusufi dhe vëllai i tij, janë më të dashur se*

ne për babanë tonë, ndërkohë që ne jemi një grup i tërë. Babai ynë, me të vërtetë, po gabon. Vriteni Jusufin ose braktiseni në ndonjë vend të largët, se pastaj babai juaj do të kthehet nga ju dhe, pas kësaj, do të bëheni njerëz të mirë.” (Jusuf: 7-9)

Vëllezërit e Jusufit komplotuan ndaj tij dhe organizuan një takim të veçantë mes tyre për të bërë një plan se si të shpëtonin prej tij, por njëri nga ata, që ishte më pak i prirë drejt krimit dhe më i mëshirshëm ndaj Jusufit se të tjerët, u propozoi këtë: *“Njëri prej tyre tha: “Mos e vrisni Jusufin, por hidheni në fund të ndonjë pusi; do ta marrë ndonjë karvan; nëse përnjëmend doni të bëni diçka me atë.” (Jusuf: 10)*

Ata filluan të përgatiten për rrethanat para-prake të krimit, sepse Jakubi [alejhi selam] kujdesej shumë për sigurinë e Jusufit dhe nuk e lejonte atë të largohej me vëllezërit e tij, për shkak të xhelozisë së tyre ndaj tij dhe mundësisë për t’i bërë atij ndonjë të keqe.⁵⁰

Ata filluan përpjekjen për ta bindur babanë e tyre që ta lejonte Jusufin të shkonte bashkë me ta. Planin e tyre për ta bindur babanë e filluan me një sulm moral ndaj tij, duke i thënë: *“Ata thanë: “O babai ynë! Përse për Jusufin nuk ke besim te ne?! Në të vërtetë, Ne i dëshirojmë çdo të mirë atij.*

⁵⁰ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 171.

Dërgoje nesër me ne që të argëtohet dhe të luajë. Të sigurojmë se do ta ruajmë.” (Jusuf: 11-12)

Jakubi [alejhi selam] nuk dëshironte ta shfaqte frikën që kishte prej tyre për Jusufin, por e justifikoi atë me frikën që kishte për të nga ujku. Në këtë mënyrë ai u dha atyre një justifikim që as atyre ndoshta nuk u kishte shkuar në mendje, dhe për këtë shkak e përdorën atë në fund, ujkun, që do të thotë se ishte nga diçka jashtë vullnetit të tyre. Nga ana tjetër, Jakubi [alejhi selam] u përpoq që të dukej se ai kishte besim tek ata. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Babai tha: “Unë brengosem po ta merrni dhe kam frikë se mos do ta hajë ujku, ndërkohë që ju s’do ta keni mendjen tek ai.” Ata thanë: “Si do ta hajë ujku, kur ne jemi një grup i fortë! Atëherë, me të vërtetë që ne do të ishim të humbur.”* (Jusuf: 13-14)

Vëllezërit e Jusufit, tashmë, ishin vetëm me viktimën dhe ishin plotësuar të gjitha kushtet për ta kryer krimin, por Allahu i Madhërishëm e qetësoi atë dhe e bëri të qëndrueshëm në këtë pozicion të vështirë ku u përball me lëndimin dhe fyerjet, para se ta hidhnin në pus.⁵¹

⁵¹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 171, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 117, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 139, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 200-201.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Pasi e morën, vendosën që ta hidhnin në fund të një pusi dhe Ne i shpallëm Jusufit: “Ti do t’i lajmërosh ata për këtë vepër, pa e vënë re ata (që ti je Jusufi).” (Jusuf: 15)*

Ata e kryen krimin dhe gjynahun e tyre dhe, tashmë, filluan përpjekjen për shfajësimin e veteve të tyre, duke u shfaqur si të pafajshëm dhe duke sajuar argumente false për t’iu shmangur përgjegjësisë dhe hedhjen e fajit mbi ujkun që babai të mos e kërkonte më fajin tek ata.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe në mbrëmje ata shkuan te babai i tyre, duke qarë. Thanë: “O babai ynë, ne shkuam të vrapojmë e Jusufin e lamë te rrobat tona, andaj e hëngri ujku. Por ti nuk na beson, edhe pse themi të vërtetën.” Dhe sollën këmishën e tij të përgjakur, me gjak të rremë. Ai tha: “Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka (tjetër nga sa thoni). Por, durim! Allahut i kërkoj ndihmë kundër asaj që po tregoni ju.” (Jusuf: 16-18).*

Jusufin e nxori nga pusi dhe e mori me vete një karvan dhe ia shitën si skllav kryeministrit të Egjiptit.⁵²

⁵² Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 173, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 119, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 141, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 202, tek Mehran “Dirasat tarihiye minel-Kur’an”, f. 73.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Ndërkohë në pus) erdhi një karvan. Ata dërguan ujëmbartësin e vet dhe ai lëshoi kovën e tij dhe thirri: “O sa gëzim! Qenka një djalë!” Ata e fshehën atë si plaçkë tregtie, por Allahu e dinte mirë çfarë bënin ata. Ata e shitën Jusufin me një çmim të ulët, veç disa grosh, pa pasur fare lakmi (për para). Një njeri nga Egjipti që e bleu, i tha gruas së vet: “Bëja të këndshëm qëndrimin këtu. Ndoshta do të na shërbejë ose do ta birësojmë!” Dhe kështu, Ne e vendosëm Jusufin në atë tokë të bukur dhe i mësuam shpjegimin e ëndrrave. Allahu ka kontroll dhe fuqi të plotë mbi çështjet e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”* (Jusuf: 19-21)

Jusufi [alejhi selam] jetoi brenda në shtëpinë e Kryeministrit. Ai ishte njeri i dashur, i sjellshëm, i moralshëm dhe me pamje të këndshme dhe hyn-te shpejt në zemrën e cilitdo që e shikonte në shtëpinë e Kryeministrit. Por ai u sprovua me pëlqimin e tepruar të bashkëshortes së Kryeministrit, e cila ra në dashuri dhe donte ta bënte për vete.⁵³

Në këtë mënyrë, Jusufi u bë edhe një herë subjekt i një krimi tjetër që, në thelb, kishte një shtysë ndryshe nga ajo e krimit të parë që ishte urrejtja. Në këtë rast, shtysa ishte dashuria e fortë që arriti deri në gradën e fiksimit dhe marrosjes

⁵³ Shiko tek Hasen Duh në “Ibtilaat esh-sherr vel-hajr fi hajat el-enbija”, f. 44.

pas tij. Kjo e shtyu atë deri tek përpjekja e joshjes së tij drejt zinasë (imoralitetit) që e çonte atë drejt tradhtisë ndaj Allahut të Madhërishëm dhe tradhtisë së nderit të pronarit të shtëpisë që i kishte dhënë atij besimin brenda në familjen e tij. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur Jusufi arriti moshën e pjekurisë, Ne i dhamë aftësinë e të gjykuarit dhe dituri. Kështu i shpërblejmë Ne punëmirët. Por ajo në shtëpinë e së cilës gjendej ai, nisi ta joshë në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert dhe i tha: “Jam e gatshme për ty!” Kurse ai tha: “Allahu më ruajttë! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe, pa dyshim, keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë.” Ajo e dëshiroi atë; por edhe Jusufi do ta kishte dëshiruar atë, sikur të mos kishte parë provën e Zotit të vet. Kështu e larguam nga e keqja dhe vepra e shëmtuar, sepse ai, në të vërtetë, ishte nga robërit Tanë të sinqertë.”* (Jusuf: 22-24)

Jusufi [alejhi selam] iku prej saj duke refuzuar imoralitetin, me gjithë tundimet. Ajo ishte grua e bukur që e kishte shfaqur ndaj gjithë bukurinë e saj joshëse dhe ishte vetmuar me të pas dyerve të mbyllura për të mos i lënë atij mundësi dhe shpresë të largohej, megjithatë besimi dhe devotshmëria e tij e shtynë të largohej prej saj. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Që të dy vrapuan nga dera dhe ajo ia shqeu këmishën atij nga mbrapa. Te dera, ata hasën burrin e saj. Ajo tha:*

“Çfarë dënimi meriton ai që kërkon t’i bëjë të keqe gruas sate, përveç burgosjes apo dënimit të dhembshëm?” (Jusuf: 25)

Ajo që nuk pritej ishte se i zoti i shtëpisë ishte tek ferra dhe e pa me sytë e tij ndjekjen dhe nxitimin drejt derës, por skena nuk ishte e plotë dhe pamja e qartë për të, prandaj ajo nxitoi që ta shfrytëzonte këtë mundësi duke ia hedhur fajin atij dhe duke e shfajësuar veten. Por Jusufi [alejhi selam] e mbrojti veten e tij, duke thënë: *“(Jusufi) tha: “Ajo provoi të më joshte.”* (Jusuf: 26)

Në këtë moment vjen dëshmia e dëshmitarit që i kujton të zotit të shtëpisë, që në këtë rast është gjykatës, argumentet dhe faktet e ngjarjes që po hetohet: *“Një i afërt i saj (që u gjend aty), pohoi: “Nëse këmisha e tij është shqyer përpara, atëherë ajo thotë të vërtetën, kurse ai gënjen. Por, nëse këmisha e tij është shqyer prapa, atëherë ajo gënjen, ndërsa ai thotë të vërtetën.”* (Jusuf: 26-27)

Gjykimi u mor kundër asaj që e bëri krimin, pas dëshmisë së qartë dhe verifikimit të këmishës, ku dukej qartë se gruaja ishte ajo që e kishte sulmuar Jusufin dhe se ai ishte i pafajshëm ndaj akuzave, edhe pse gruaja u hoq si viktimë e këtij sulmi. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur burri i saj pa se këmisha e Jusufit ishte shqyer nga mbropa, tha: “Patjetër që kjo është një nga dredhitë*

tuaja (të femrave). Në të vërtetë, dredhitë tuaja janë të mëdha!" (Jusuf: 28)

Nga ky rast mësojmë se faktet ndihmëse duhet të merren në konsideratë në rastet kur jemi në mëdyshje në gjykim.⁵⁴

Kryeministri i kërkoi Jusufit që të mos fliste për këtë ngjarje dhe ta linte atë mënjane, kurse bashkëshortes i kërkoi ta ndjente gjynahun e bërë, ta kuptonte gabimin dhe të kërkonte falje. Allahu i Madhërishëm thotë: *"Ti, o Jusuf, largohu nga kjo! Kurse ti (gruaja ime), kërko falje për këtë gjynah, sepse, në të vërtetë, ti je fajtorë."* (Jusuf: 29)

Jusufi [alejhi selam] doli i pafajshëm dhe çështja u sqarua, por gruaja e Kryeministrit ishte akoma nën ndikimin e ndjenjave të forta të dashurisë që ndiente për Jusufin [alejhi selam]. Ajo dëgjoi që gratë e pallatit po e përgojonin dhe duke ditur bukurinë e pashoqe të Jusufit [alejhi selam] vendosi që ta nxirrte atë përpara tyre që të ndienin të njëjtën gjë që ndiente ajo ndaj tij dhe për t'u justifikuar para tyre për të gjitha veprimet që kishte bërë për ta joshur atë. Me këtë veprim, ajo ia arriti qëllimit. Tashmë Jusufi [alejhi selam] nuk ishte më objektiv i joshjeve të një gruaje të vetme,

⁵⁴ Shiko tek Abdurahman es-Sa'di "Kisas el-enbija", f. 187.

por ishte nën presionin e një grupi të tërë grash dhe mund të bëhej viktimë e tyre.⁵⁵

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Disa gra (të parisë) në qytet po thoshin: “Gruaja e Azizit (ministrit) deshi ta joshte shërbëtorin e vet. Asaj i ka rënë vërtet në kokë dashuria për të. Ne besojmë se ajo e ka humbur fare.” Kur dëgjoi për thasethemet e tyre, ajo i thirri ato në gosti, çdonjërës i dha nga një thikë dhe (i) tha (Jusufit): “Dil para tyre!” Kur e panë, gratë u mahnitën nga bukuria e tij, prenë duart dhe thanë: “O Zot, o Zot! Ky nuk është njeri, por qenka një engjell fisnik!” Ajo tha: “Jo, ky është ai për të cilin ju më qortuat. Jam përpjekur ta josh, por ai është ruajtur nga gjynahu. Por, nëse ai nuk bën atë që e urdhëroj unë, me siguri që do të burgoset dhe do të poshtërohet.”* (Jusuf: 30-32)

Ajo po e kërcënonte Jusufin [alejhi selam] dhe ai, tashmë, gjendej para dy të këqijave: ose do të binte në gjynahun dhe krimin e zinasë (imoralitetit), ose do të hynte në burg padrejtësisht. Por ai zgjodhi më mirë burgun se sa të binte në gjynahun dhe krimin e zinasë (imoralitetit) në mesin e një shoqërie ku kishte si kundërshtarë një grup

⁵⁵ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 175, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 143, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 205.

grash që e ftonin dhe e joshnin drejt veprës së shëmtuar.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ai tha: “O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).” Dhe Zoti e plotësoi lutjen e tij dhe e shmangu nga dredhitë e tyre. Me të vërtetë, Ai dëgjon dhe di çdo gjë.”* (Jusuf: 33-34)

Pafajësia e Jusufit [alejhi selam] doli në pah, sepse Kryeministri dhe të tjerët i panë faktet dhe argumentet që e vërtetonin se ai ishte viktimë, megjithatë ata e dënuan atë padrejtësisht.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Pastaj u ra ndër mend atyre, pasi i panë shenjat (e pafajësisë së Jusufit) që ta burgosin për një kohë (në mënyrë që ngjarja të mos përhapej në popull).”* (Jusuf: 35)

Jeta e Jusufit [alejhi selam] në burg ishte e mbushur plot me ngjarje që kanë lidhje me çështje të sigurisë. Mes të burgosurve që ishin në burg kishte kriminelë, por edhe persona që nuk ishin gjykuar akoma dhe secili prej tyre priste për t’u dënuar ose për të fituar lirinë. Mes tyre ishin edhe

dy persona të akuzuar që kishin qenë pjesë e shoqëruesve të mbretit të Egjiptit në atë kohë.⁵⁶

Të dy ata ishin të shqetësuar për vendimin që do të merrej për ta dhe për të ardhmen që i priste. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Bashkë me Jusufin hynë në burg edhe dy djelmosha. Njëri prej tyre tha: “Unë kam parë (në ëndërr) veten, se si shtrydhja verë.” Tjetri tha: “Unë kam parë në ëndërr, se si mbaja në kokë bukë, të cilën e hanin shpendët. Shpjegona kuptimin e ëndrrave. Ne, me të vërtetë, shohim se ti je njeri i mirë.” Jusufi tha: “Sa herë që t’ju vijë ndonjë ushqim (në ëndërr) si risk për ju, unë do t’ju lajmëroj se çfarë kuptimi ka, para se të bëhet realitet. Kjo është prej diturive që m’i ka mësuar Zoti im. Unë e kam flakur fenë e njerëzve që nuk besojnë Allahun e që mohojnë jetën tjetër. Unë besoj fenë e të parëve të mi - Ibrahimit, Is’hakut dhe Jakubit. Ne, kurrë nuk mund t’i shoqërojmë Allahut ndonjë gjë (në adhurim). Kjo është dhuntia e Allahut ndaj nesh dhe njerëzve të tjerë, ndonëse shumica e njerëzve nuk janë mirënjohës. O shokët e mi të burgut! A janë më mirë një mori zotash të ndryshëm apo Allahu, i Vetmi, Ngadhënjimtari? Ata që ju i adhuronin në vend të Allahut, janë vetëm emra, të cilët i keni*

⁵⁶ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 176, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 126, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 144, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 206, tek Hasen Duh në “Ibtılaat esh-sherr vel hajr fi hajat el-enbija”, f. 46.

vënë ju dhe të parët tuaj, pa pasur prej Tij asnjë argument. Vendimi i përket vetëm Allahut: Ai ka urdhëruar që të adhuroni vetëm Atë. Kjo është e vetmja fe e vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e dinë. O shokët e mi të burgut! Njëri prej jush do t'i shërbejë verë pronarit të vet, kurse tjetri do të kryqëzohet, e shpendët do të hanë prej kokës së tij. Kështu është caktuar kjo gjë për të cilën pyetët ju!" (Jusuf: 36-41)

Jusufi [alejhi selam] e ndiente se i ishte bërë padrejtësi dhe se ishte futur në burg padrejtësisht, edhe pse pafajësia e tij ishte vërtetuar, për këtë arsye ai u përpoq ta përdorte si ndërmjetësues atë që mendonte se do të fitonte pafajësinë dhe do të kthehej në vendin e punës që kishte pasur më parë në shërbim të mbretit që t'i fliste mbretit për ankesën e Jusufit [alejhi selam], ndoshta e rishikonte çështjen e tij dhe e lironte nga burgu pasi ta shikonte se është i pafajshëm.⁵⁷

Allahu i Madhërishëm thotë: *"Jusufi i tha njërit prej këtyre të dyve, për të cilin e dinte se do të shpëtonte: "Përmendëm mua te pronari yt!" Por djalli bëri që ai të harronte ta përmendte te pronari i vet dhe kështu, Jusufi mbeti edhe disa vjet në burg."* (Jusuf: 42)

⁵⁷ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 207, tek Ibnul Ethiri në librin "El-kamil", v. I, f. 145, tek Ibnu Kethiri në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. I, f. 207.

Burgu ishte i vështirë për Jusufin [alejhi selam] dhe, për këtë arsye, Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka folur për këtë vështirësi, duke thënë: *“Bujari, biri i bujarit, biri i bujarit, biri i bujarit, Jusufi, i biri i Jakubit, i biri i Is’hakut, i biri i Ibrahimit, paqja e Zotit qoftë mbi ta.”* Pastaj tha: *“Nëse do të qëndroja në burg aq sa qëndroi Jusufi dhe të më vinte i dërguari i mbretit, do të ikja me të.”* - dhe lexoi fjalët e Allahut: *“Kur (Jusufit) i erdhi i dërguari, ai i tha: “Kthehu te mbreti yt e pyete: ç’patën ato gra që prenë duart e veta?” Me të vërtetë, Zoti im i di dredhitë e tyre!”*⁵⁸

Ndodhi një ngjarje tjetër që ia kujtoi shërbëtorit historinë e tij kur ishte në burg me Jusufin [alejhi selam]. Mbreti kishte parë një ëndërr dhe ata kishin nevojë për dikë që ta komentonte ëndërrën e tij pasi askush nga paria nuk kishte mundur që ta shpjegonte atë.⁵⁹

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe tha mbreti: “Kam parë në ëndërr shtatë lopë të majme, të cilat po i hanin shtatë lopë të dobëta dhe kam parë shtatë kallinj të gjelbër e shtatë të tjerë të tharë. O paria ime, më shpjegoni ëndërrën time, nëse dini t’i interpretoni ëndërrat!” Ata thanë:*

⁵⁸ Transmetohet tek Tirmidhiu në “Es sunen” në komentin e sures *Jusuf*.

⁵⁹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 176, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 145, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 208

“Këto janë ëndrra të ngatërruara e ne nuk dimë t’i shpjegojmë.” Njërit nga ata dy që shpëtoi (nga burgu), iu kujtua pas një kohe e tha: “Unë do t’ju njoftoj për shpjegimin e kësaj (ëndrre), vetëm më dërgoni (te Jusufi)!” (Shërbëtori) I tha: “O Jusuf, o njeri i drejtë! Na shpjego (ëndrën) për shtatë lopë të majme, të cilat hahen prej shtatë lopëve të dobëta dhe për shtatë kallinj të gjelbër e shtatë tjerë të tharë, që të kthehem te njerëzit e ta dinë edhe ata.” (Jusuf: 43-46)

Megjithëse Jusufi [alejhi selam] ishte burgosur padrejtësisht, ishte keqtrajtuar dhe ishte akuzuar duke shpifur ndaj tij, ai ishte i gatshëm të kontribuonte dhe të jepte këshillat e tij. Ai u shpjegoi kuptimin e ëndrrës që kishte të bënte me të ardhmen dhe në të njëjtën kohë u dha atyre këshilla dhe udhëzime për menaxhimin e problemeve që mund të lindnin.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Jusufi) tha: “Do të mbillni shtatë vjet rresht. Prodhimin që do të korrni lëreni në kallinj, përveç një pakice që do t’ju shërbejë për të ngrënë, sepse pastaj do të vijnë shtatë vite të thata, të cilat do t’i harxhojnë ato që i keni ruajtur ju, përveç një pakice që mund të kurseni. Pastaj, pas këtyre do të vijë një vit plot shi për njerëzit, vit në të cilin ata do të shtrydhnin (rrush etj.).” (Jusuf: 47-49)*

Mbreti e ndjeu se shpjegimi që i bëri Jusufi [alejhi selam] ishte i sinqertë dhe, megjithëse ishte burgosur padrejtësisht, ai nxitoi që t'i ndihmonte me këshillat e tij pavarësisht të gjitha gjërave që i kishin ndodhur. Kjo gjë ngjalli simpatinë dhe pëlqimin e mbretit për të, akoma pa e parë me sy. Ai urdhëroi që ta nxirrnin nga burgu duke e amnistuar, por Jusufi [alejhi selam] këmbënguli që të dilte në pah pafajësia e tij dhe t'i kthehej nderi që i ishte cenuar, duke nxjerrë në pah akuzat e pavërteta të grave që e kishin akuzuar.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Mbreti tha: “Sillmani atë!” Kur (Jusufit) i erdhi i dërguari, ai i tha: “Kthehu te mbreti yt e pyete: ç’patën ato gra që prenë duart e veta?” Me të vërtetë, Zoti im i di dredhitë e tyre!”* (Jusuf: 50)

Ky qëndrim i Jusufit [alejhi selam] ia shtoi mbretit edhe më shumë simpatinë për të. Ai urdhëroi që gratë që kishin pasur lidhje me çështjen e Jusufit [alejhi selam] të paraqiteshin tek ai dhe e rishikoi atë personalisht. Ai i pyeti ato dhe pa se të gjitha përgjigjet ishin në favor të Jusufit [alejhi selam]. Më në fund, pas kaq shumë vitesh, e vërteta doli në pah me pohimet e grave dhe dëshminë e vetë gruas së Kryeministrit, e cila e pranoi fajin dhe pohoi se Jusufi ishte i pafajshëm.⁶⁰

⁶⁰ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 178, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 146, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 209

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Mbreti u tha (grave): “Si qe puna juaj kur deshët ta joshnit Jusufin?” Ato thanë: “Allahu na ruajt! Ne nuk dimë asgjë të keqe për atë.” Gruaja e Azizit (ministrit) tha: “Tani do të dalë në shesh e vërteta! Unë u përpoqa që ta joshja atë; ai është vërtet njeri i drejtë.” (Jusufi) tha: “(E kërkova këtë hetim) që ta dijë ai, se unë nuk e kam tradhtuar gjatë kohës së mungesës së tij. Vërtet, Allahu nuk u jep fund të mirë dredhive të tradhtarëve. Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirë-plotë.” (Jusuf: 51-53)*

Pafajësia e Jusufit [alejhi selam] u bë e qartë para vetë mbretit dhe bashkëpunëtorëve të tij dhe të gjithë njerëzit e mësuan se ai është i pafajshëm, madje, tashmë, kishte fituar pëlqimin dhe simpatinë e mbretit. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhërishëm i dha mundësi atij që të bëhet njëri nga nëpunësit më të rëndësishëm të shtetit që kanë dhe detyrën e mbajtjes së drejtësisë në atë vend.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Mbreti tha: “Ma sillni atë, do ta marr pranë vetes.” Pasi bisedoi me të, i tha: “Qysh sot, ti ke pozitë të lartë dhe je i besuar.” (Jusufi) i tha: “Më cakto përgjegjës të depove të vendit, sepse unë jam ruajtës dhe njohës (i mirë i këtyre punëve).” (Jusuf: 54-55)*

Ja, kështu Allahu i Madhërishëm bëri të mundur që Jusufin, që i kishin bërë padrejtësi, ta bënte të pushtetshëm në shtetin e Egjiptit ku e kishin sjellë si skllav, e kishin shitur dhe e kishin burgosur.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe kështu, Ne i dhamë Jusufit pozitë në atë vend dhe ai kishte çfarë të dëshironte. Ne e shpërblejmë me mëshirën Tonë, kë të duam dhe, punëmirëve nuk ua humbim shpërblimin. Ndërsa shpërblimi i jetës tjetër është më i mirë për ata që besojnë dhe e kanë frikë Allahun.”* (Jusuf: 56-57)

Thatësira që ai kishte parashikuar ndodhi dhe zia e bukës u përhap në Egjipt dhe në vendet përreth tij. Pasojat e saj u shtrinë edhe në zonat e beduinëve pranë tyre, veçanërisht në zonën e beduinëve të Palestinës, në pjesën perëndimore të shkretëtirës së Nakabit që ishte më afër Egjiptit, vendi ku jetonte Jakubi [alejhi selam] dhe fëmijët e tij.⁶¹

Ata e kishin të domosdoshme lidhjen me fshatrat dhe tokat ku mbilleshin drithërat, sepse ata jetonin si nomadë. Ishte vullneti i Allahut që

⁶¹ Për përcaktimin e këtyre zonave shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 179, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 155, tek Mehrani “Dirasat tarihije minel-Kur’an, bilad el-arab”, f. 80, tek Keneth Kanterz dhe të “Et-tefsir et-tatbiki lilkitab el-mukaddes”, f. 95

vëllezërit e Jusufit, që më parë e kishin sulmuar dhe i kishin bërë keq, tashmë, të kishin nevojë për të, sepse ai ishte bërë shumë i pushtetshëm në Egjipt dhe kishte në dorë shpërndarjen e furnizimeve dhe ushqimeve ose shitjen e tyre. Jusufi [alejhi selam] e kishte bërë zakon që ta mbulonte fytyrën, për shkak të bukurisë së tij, prandaj shumë nga njerëzit që e shihnin nuk e njihnin dot. Pikërisht kjo gjë ndodhi edhe me vëllezërit e tij kur e takuan atë në Egjipt.

Allahu i Madhërishtëm thotë: *“Dhe erdhën vëllezërit e Jusufit e hynë tek ai. Ai i njohu, por ata nuk e njohën.”* (Jusuf: 58)

Duket se ushqimi shpërndahej sipas numrit të personave, prandaj vëllezërit e tij i treguan edhe vëllain e vogël, Beniaminin, që kishte qëndruar me babanë e tyre. Ai e shfrytëzoi këtë mundësi dhe u kërkoi atyre që herën tjetër ta merrnin me vete edhe vëllain e vogël për të cilin i treguan. Nëse ata nuk do t'i kishin treguar për Beniaminin dhe nuk do t'i kishin folur për të, ai nuk do ta kishte kërkuar një gjë të tillë.⁶²

Prandaj është shumë e rëndësishme që t'i dëgjosh të tjerët duke i lënë të flasin kur dëshiron të marrësh informacione të tjera, ose duke ua

⁶² Shiko tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 148, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f.211.

ngarkuar këtë detyrë disa personave të tjerë që mund të ndihmojnë për të marrë sa më shumë informacione të dobishme.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur i furnizoi ata me ushqim të nevojshëm, u tha: “Më sillni vëllain tuaj prej babait! A nuk e shihni se unë jua jap masën të plotë dhe jam më i miri mikpritës? Nëse nuk ma sillni atë, nuk do të ketë më ushqim për ju dhe mos ejani tek unë!” Ata thanë: “Ne do të përpiqemi disi, që ta sjellim nga babai i tij dhe do ta bëjmë këtë.”* (Jusuf: 59-61)

Jusufi [alejhi selam] u përpoq t’u jepte vëllazërve të tij një farë sigurie dhe mirëbesimi për t’i nxitur të ktheheshin prapë dhe ta sillnin edhe vëllain e tyre me vete që të mësonte edhe më shumë informacione rreth babait dhe familjes së tij. Për këtë arsye, ai ua ktheu përsëri paratë që kishin sjellë për të blerë furnizimet.⁶³

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Jusufi u tha shërbëtorëve të vet: “Ngarkoni barrët në kafshët e tyre e ua fusni brenda paratë! Ata do t’i gjejnë ato, kur të shkojnë te familja e vet, kështu që do të kthehen përsëri te ne.”* (Jusuf: 62)

⁶³ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 179.

Përpjekja e Jusufit për t'i bindur vëllezërit e tij të kthehen përsëri në Egjipt bashkë me vëllain e vogël doli me sukses.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur u kthyen te babai i tyre, ata thanë: “O ati ynë! Nuk do të na japin më ushqim. Prandaj dërgoje me ne vëllain tonë, që të mund të marrim ushqim; të sigurojmë se ne do ta ruajmë atë!”* (Jusuf: 63)

Jakubit [alejhi selam] nuk i ndahej frika për humbjen e djalit të vogël.⁶⁴

Kur ata i kërkuan që ta merrnin me vete në Egjipt edhe vëllain e vogël, atij iu kujtua Jusufi dhe roli që kishin pasur vëllezërit e tij në humbjen e tij, prandaj nuk kishte besim ta linte atë të shkonte me ta.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ai u tha: “A mos vallë t’jua besoj juve, ashtu siç jua pata besuar më parë vëllain e tij? Allahu është Ruajtësi më i mirë dhe Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!” Kur i çelën barrët e tyre dhe gjetën të hollat e tyre, që ua kishin kthyer, ata thanë: “O ati ynë! Ç’duam më tepër? Këto janë gjërat tona; na janë kthyer. Ne do ta furnizojmë familjen tonë, do ta ruajmë vëllain tonë dhe do ta shtojmë një barrë deveje (ushqim), e kjo është barrë e lehtë.”* (Jusuf: 64-65)

⁶⁴ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 213.

Jakubi [alejhi selam] u përpoq që t'i pengonte fëmijët e tij për t'i bërë ndonjë të keqe djalit të tij të vogël, prandaj ai u mori atyre besën dhe premtimin se ata do ta kthenin atë të sigurt në shtëpi.⁶⁵

Këtë gjë ai e bëri për të zgjuar në ndërgjegjen e tyre ndjenjën fetare që të mos i lejonte të bënin ndonjë krim, sepse kjo ndjenjë është një nga pengesat më të fuqishme ndaj krimit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ai tha: “Unë kurrsesi nuk do ta dërgoj me ju, derisa të betoheni në Allahun, se do të ma ktheni, me përjashtim të rastit kur ju rrezikon ndonjë e keqe e madhe (të gjithëve).” Kur ata u betuan, ai u tha: “Allahu është dorëzënës për atë që flasim ne.”* (Jusuf: 66)

Ishte shumë e qartë se Jakubi [alejhi selam] ishte i interesuar për sigurinë e të gjithë fëmijëve të tij, prandaj ai u përpoq që t'i këshillonte ata për atë që ai mendonte se do t'u bënte dobi atyre. Në këtë mënyrë ai ua rikujtoi atyre dashurinë që ai si baba kishte për ta, edhe pse në pamje të parë dukej sikur ai po interesohej vetëm për sigurinë e djalit më të vogël. Ai frikësohej nga zilia e njerëzve të tjerë ndaj tyre, ashtu siç kishte frikë se i merrnin ushtarë ose i kthenin në skllëvër me

⁶⁵ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 180, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 180, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 212.

forcë. Në këtë mënyrë ai i zgjoi tek ata ndjenja të ndryshme që do t'i ndihmonin të mos binin në ndonjë krim ndaj vëllait të tyre që ai i druhej.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“O djemtë e mi, mos hyni nga e njëjta portë (e qytetit), por nga porta të ndryshme. Unë nuk mund të largoj prej jush asgjë nga (ajo që ju ka caktuar) Allahu! Se pushteti i përket vetëm Allahut. Tek Ai mbështetem unë dhe tek Ai le të mbështeten ata që dëshirojnë të jenë të mbështetur (tek Allahu)!” Kur ata hynë (në qytet), ashtu siç i urdhëroi babai i tyre, dëshira e Jakubit u përmbush, por kjo nuk i ndihmoi aspak para caktimit të Allahut. Ai (Jakubi), në të vërtetë, ka qenë dijetar i madh, sepse Ne e kemi mësuar, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”* (Jusuf: 67-68)

Vëllai i vogël i Jusufit ishte i pafajshëm, prandaj ai u përpoq ta takonte atë vetëm për vetëm, që ta ndihmonte dhe t'i tregonte më shumë rreth familjes, si dhe për të qenë më i sigurt nga ndonjë e keqe që mund t'i ndodhte nga të tjerët.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur dolën para Jusufit, ky e afroi vëllain e vet (Beniaminin) dhe i tha: “Unë në fakt jam vëllai yt dhe mos u hidhëro për atë që më bënë vëllezërit tanë!””* (Jusuf: 69)

Që në momentin që u takua vetëm për vetëm me vëllain e tij, që të dy filluan të planifikojnë

se si do ta mbante aty vëllain e tij në një mënyrë që do t'i bindte vëllezërit e tjerë pa e dëmtuar atë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Pasi i furnizoi me ushqimin e nevojshëm, (Jusufi) futi një gotë (të çmueshme) në ngarkesën e vëllait të vet e pastaj një lajmëtar thirri: “O karvan, ju jeni vjedhës të vërtetë!” Ata u kthyen drejt tyre (e thanë): “Ç’ju ka humbur?” Thanë: “Po kërkojmë gotën e mbretit. Kush e sjell atë, ka shpërblim një barrë deveje ushqim. Unë për këtë jam dorëzënës.” (Vëllezërit e Jusufit) thanë: “Betohemi për Allahun, ju e dini se ne nuk kemi ardhur të bëjmë turbullira në këtë vend dhe nuk jemi vjedhës.” (Jusuf: 70-73)*

Në atë vend ekzistonte një ligj që e përcaktonte qartë ndëshkimin e përgjegjësit për vjedhje për disa mjete të veçanta në atë shtet. Këtë e tregon ajeti, kur thanë: *“Po kërkojmë gotën e mbretit...”* Të akuzuarit ishin vëllezërit e Jusufit, prandaj punonjësit e shtetit ua konfirmuan edhe një herë dënimin që do të merrte fajtori nëse do të ishte njëri prej tyre dhe ata e pranuan se, nëse hajduti është në mesin e tyre, atëherë ai e meriton dënimin.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ata pyetën: “E cili do të jetë dënimi, nëse ju gënjeni?” (Vëllezërit) thanë: “Dënimi për atë, në barrën e të cilit gjendet gota, është që të mbahet peng ai vetë. Kështu i dënojmë ne keqbërësit.” (Jusuf: 74-75)*

Inspektorët ishin në dijeni se kupa gjendej në ngarkesën e vëllait të vogël, dhe vetë ai e dinte këtë gjë, por ata dëshironin që kontrolli të dukej sa më i natyrshëm që ata të mos e kuptonin, prandaj ata filluan me kontrollin e ngarkesave të tjera.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe nisi të kontrollojë barrët e tyre para barrës së vëllait të Jusufit. Pastaj nxori gotën nga barra e vëllait të tij. Kështu, Ne e mësuam Jusufin, që ta bënte këtë dredhi. Ai, sipas ligjit të mbretit nuk mund ta merrte (për skllav) vëllain e vet, përveç se me vullnetin e Allahut. Ne e ngremë lart atë që duam, e mbi çdo të ditur është një i Gjithëdijshëm.”* (Jusuf: 76)

Vëllezërit nxituan ta akuzojnë vëllain e tyre megjithëse ai ishte i pafajshëm dhe megjithëse këtë lëvizje po e bënte Jusufi [alejhi selam] me dijeninë e vëllait të tij të vogël, Beniaminit. Nga kjo mësojmë se disa nxitojnë t'i akuzojnë të tjerët kur ndodh ndonjë gabim. Në këtë rast ata jo vetëm që e miratuan akuzën, por shkuan edhe më tej, duke e përfshirë edhe Jusufin [alejhi selam], megjithëse edhe ai kishte vuajtur personalisht nga padrejtësia e tyre dhe ata ishin të vetëdijshëm për këtë. Kur Jusufi i dëgjoi këto akuza që e cenonin edhe atë personalisht, megjithëse tashmë kishte pushtetin dhe fuqinë në dorë, e përmbajti zemërimin dhe nuk e zbuloi veten përpara tyre.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Bijtë e Jakubit) thanë: “Nëse ka vjedhur, më parë ka vjedhur edhe vëllai i tij!” Jusufi heshti për këtë dhe nuk shpalli gjë, por mendoi në vetvete: “Ju jeni në pozitë më të keqe. Allahu është më i dijshtëm për ato që thoni ju.” (Jusuf: 77)*

Vëllezërit e Jusufit u përpoqën që në burg të futej ndonjëri prej tyre dhe dënimi të binte mbi të në vend të vëllait të vogël, sepse i kishin dhënë besën babait të tyre se do ta sillnin vëllain e tyre shëndoshë e mirë në shtëpi. Një gjë e tillë ishte e papranueshme në asnjë sistem penal gjatë gjithë historisë, sepse i akuzuari ose fajtori duhet ta mbajë vetë përgjegjësinë dhe askush tjetër në vend të tij.⁶⁶

Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Bijtë e Jakubit) thanë: “O ministër, ai e ka babanë shumë plak, andaj merr ndonjërin prej nesh në vend të tij! Ne po shohim se ti je bamirës.” (Jusuf: 78)*

Jusufi [alejhi selam] ishte shumë i përpiktë në përgjigjen që u dha atyre duke mos e konfirmuar vjedhjen nga ana e vëllait të tij, por vetëm

⁶⁶ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 183, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 151, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 214.

sa e përmendi atë në fjalët e tij, duke i bindur vëllezërit e tij, por pa gënjyer.⁶⁷

Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Jusufi) tha: “Allahu na ruajttë, si të marrim atë tjetrin në vend të atij te i cili e kemi gjetur sendin tonë! Atëherë, ne, me të vërtetë, do të ishim të padrejtë!”* (Jusuf: 79)

Në shpirtin e më të madhit nga vëllezërit lëvizi instinkti i së mirës dhe iu kujtua premtimi dhe besa që i kishte dhënë babait.⁶⁸

Ai filloi t’ua kujtonte vëllezërve të tjerë edhe atë që i kishin bërë më parë Jusufit dhe i urdhëroi ata që të tregohen të përpiktë në dëshminë e tyre kundër vëllait të tyre të vogël, sepse ata nuk e kishin parë atë duke vjedhur, por këtë e mësuan nga ngjarjet që ndodhën dhe se ai mund të ishte edhe i pafajshëm. Ai ua bëri me dije se në rastin e parë me Jusufin nuk kishin asnjë justifikim, kurse në këtë rast mund të ishin të justifikuar, edhe pse do të ishte e vështirë t’u besohej, sepse më parë kishin gënjyer. Për këtë shkak u tha atyre t’i kërkonin babait t’i pyeste edhe të tjerët.

⁶⁷ Shiko tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 133, dhe tek Abdurahman es-Sa’di “Kisas el-enbija”, f. 193.

⁶⁸ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 182, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 151, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 214.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Meqë e humbën shpresën në të (Jusufin), u shpërndanë dhe u këshilluan fshehurazi. Më i madhi nga ata tha: “A nuk e dini që babai juaj ka marrë prej jush betimin në Allahun. Ju edhe më parë e keni shkelur betimin që bëtë për Jusufin. Nuk do të ndahem prej këtij vendi, derisa të më lejojë babai im ose të më gjykojë Allahu, sepse Ai është Gjykatësi më i mirë. Kthehuni te babai juaj dhe thoni: “O babai ynë, djali yt ka vjedhur. Ne dëshmojmë vetëm për atë që dimë. Ne nuk mund ta parashikonim të panjohurën. Pyet banorët e qytetit në të cilin kemi qenë dhe karvanin me të cilin kemi udhëtuar dhe ki besim se ne jemi të drejtë!”* (Jusuf: 80-82)

Kjo që ndodhi ishte shumë e rëndë për Jakubin [alejhi selam], sepse më parë kishte humbur Jusufin, kurse tani humbi edhe djalin tjetër, Beniaminin.⁶⁹

Për këtë arsye ai i akuzoi djemtë e tij, edhe pse në këtë rast ata ishin të pafajshëm.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Jakubi tha: “Nuk është kështu, por ju keni kurdisur diçka. Unë do të kem durim. Shpresoj se Allahu do të m’i kthejë të gjitha, sepse Ai, në të vërtetë, është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.” U largua prej tyre dhe*

⁶⁹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 183, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 152, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 214.

tha: "O i mjeri unë për Jusufin!" Sytë i ishin zbardhur prej pikëllimit dhe ishte plot zemërim. Ata thanë: "Për Allahun, ti po e përmend Jusufin pa pushim, saqë do të sëmuresh rëndë ose do të vdesësh!" (Jakubi) tha: "Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut e nga Allahu di atë që nuk e dini ju." (Jusuf: 83-86)

Më pas Jakubi i urdhëroi djemtë e tij që të interesoheshin për çështjen e vëllait të tyre, Beniaminit.⁷⁰

Allahu i Madhërishëm thotë: *"O bijtë e mi, shkoni e kërkoni lajme për Jusufin dhe vëllain e tij dhe mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush, përveç jobesimtarëve." (Jusuf: 87)*

U mundësua edhe një takim tjetër me Jusufin dhe ata akoma nuk e dinin se ai ishte Jusufi, por ai i njihte. Ai që e bën krimin ndoshta mund të harrojë, por ai që i është bërë padrejtësia nuk harron kurrë. Allahu i Madhërishëm i dha fitoren Jusufit ndaj vëllezërve të tij dhe, tashmë, ata kishin ardhur duke ia pasur nevojën atij, kurse ai nuk ua kishte nevojën atyre. Me postin dhe pushtetin që kishte, ai mund të bënte me ta çfarë të donte, por u tregua i mëshirshëm me ta me gjithë

⁷⁰ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 184, tek Ibnul Ethiri në librin "El-kamil", v. I, f. 152, tek Ibnu Kethiri në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. I, f. 215.

ashpërsinë e tyre. Tashmë, ishte momenti dhe kushtet e përshtatshme që t'u tregonte atyre se kush ishte në të vërtetë, që të merrnin një mësim të rëndësishëm, që Allahu i Madhërishëm e ndihmon atë që i bëhet e padrejtë kundër atij që i ka bërë padrejtësi.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur ata dolën para Jusufit, thanë: “O ministër, ne dhe familjen tonë e ka goditur një fatkeqësi e madhe dhe kemi sjellë pak gjëra! Sidoqoftë, na e plotëso masën (për ushqimin) tonë dhe na jep lëmshë, sepse Allahu i shpërblen dhënësit e lëmshës.” Ai tha: “A nuk e mbani mend çfarë keni bërë me Jusufin dhe vëllain e tij, kur ishit të paditur?” Ata thanë: “Vallë, ti je vërtet Jusufi?!” Ai u përgjigj: “Po, unë jam Jusufi e ky është vëllai im. Allahu na mëshiroi. Atë që ruhet (nga gjynahet) dhe bëhet i durueshëm, Allahu e shpërblen, se Ai kurrë nuk ia humb shpërblimin punëmirëve.” (Jusuf: 88-90)*

Në këtë moment vëllezërit e pranuan fajin e tyre dhe e panë me sytë e tyre se si e lartësoi Allahu atë dhe ata i bëri t'ia kenë nevojën atij. Megjithatë, ai i fali dhe u lut për ta.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ata thanë: “Betohemi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne dhe ne paskemi qenë vërtet të gabuar.” Ai u tha: “Sot s'ka qortim për ju; Allahu do t'ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!” (Jusuf: 91-92)*

Pas kësaj Jusufi i dërgoi atë tek babai, duke u dhënë edhe ilaç për sytë e tij dhe u kërkoi që të vinin në Egjipt të gjithë bashkë me gjithë familjen. Me sa duket, në shtetin e Egjiptit, në atë kohë, ekzistonte një sistem për rregullimin e banimit për të huajt dhe Jusufi i përgatiti të gjitha procedurat e duhura për futjen e tyre në Egjipt në mënyrë të sigurt.⁷¹

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Shkoni me këtë këmishë timen dhe vëreni në fytyrën e atit tim e ai do të shohë, dhe m’i sillni tërë familjet tuaja!”* Kur karvani u largua nga vendi (Egjipti), babai i tyre tha: *“Unë, me të vërtetë, po ndiej erën e Jusufit, ndonëse ju mund të më quani matuf .”* Ata thanë: *“Për Allahun, me të vërtetë, ti edhe tani qëndron në gabimin e mëparshëm.”* Kur erdhi sjellësi i lajmit të mirë dhe ia vuri këmishën në fytyrë, atij iu kthye shikimi. Ai tha: *“A nuk ju kam thënë se unë di nga Allahu atë që ju nuk e dini.”* (Jusuf: 93-96)

Vëllezërit e kuptuan gabimin, u penduan tek Zoti dhe i kërkuan babait të tyre që t’i falte dhe e ndjenë nevojën që kishin për lutje dhe kërkim faljeje.⁷²

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ata thanë: “O babai ynë, kërko falje për ne e për gabimet tona!”*

⁷¹ Shiko tek Muhamed Abduselam Muhamed “Benu israil fil-Kur’an”, f. 154.

⁷² Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 186, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 154, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 216.

Ne paskemi qenë vërtet gjynahqarë.” Ai u përgjigj: “Do ta lus Zotin tim që t’ju falë. Pa dyshim që Ai është Falësi dhe Mëshirëploti.” Kur ata hynë te Jusufi, ai i afroi pranë prindërit e vet dhe tha: “Hyni në Egjipt! Me lejen e Allahut, ju do të jeni të sigurt prej çdo të keqeje.” (Jusuf: 97-99)

Dijetari Abdurahman Es-Sa’ di thotë: “Bijtë e Jakubit [alejhi selam] në fillimet e tyre bënë shumë krime të ndryshme, por në fund ata u penduan me një pendim të sinqertë, duke i pranuar fajet e tyre dhe duke marrë amnistinë e plotë ndaj tyre nga Jusufi dhe nga babai i tyre, madje fituan edhe duatë e tyre për falje dhe mëshirë. Nëse robi ta fal hakun e tij, atëherë Allahu i Madhërishëm është më i meritueshëm për ta bërë këtë, sepse Ai është Mëshiruesi dhe Falësi më i mirë. Për këtë arsye, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, Allahu i Madhërishëm i bëri ata profetë, duke ua fshirë të gjitha të metat e kaluara sikur të mos kishin ekzistuar. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Thuaj (o Muhamed): “Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit, Esbatëve (12 bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij (Allahut) i përulemi.”** (Ali Imran: 84)⁷³

⁷³ Abdurahman Es-Sa’ di, “Kisas el-enbija”, f. 184.

Jusufi [alejhi selam] ishte falënderues ndaj Allahut të Madhërishëm kur përmendi mirësinë e Zotit që e bëri të dalë nga sprova në të cilën kishte rënë, por vëmë re se ai e përmendi sprovën vetëm kalimthi gjatë falënderimit të Zotit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ai i ngriti prindërit e vet në fron dhe ata të gjithë iu përulën atij. Ai tha: “O babai im, ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme. Zoti im e përmbushi atë. Mua më bëri mirësi, kur më nxori nga burgu, kurse juve ju solli nga shkretëtira, pasi djalli pati futur ngatërresë midis meje dhe vëllezërve të mi. Vërtet, Zoti im është i Butë me kë të dojë; Ai është i Gjithëdijshmi dhe i Urti!”* (Jusuf: 100)

Jusufi [alejhi selam], tashmë, ishte në pozicionin e zyrtarëve më të lartë tek financat dhe menaxhimi, ndihej i sigurt për veten, megjithatë ai e përmendte Zotin, i druhej dhe shpresonte prej Tij në Ditën e Kijametit.⁷⁴

Ai e kuptonte se jeta e kësaj bote, pozita dhe pasuria e saj është e përkohshme dhe se nuk duhet të lidhesh pas saj në asnjë rrethanë, dhe se sprovat dhe mirësitë kanë nevojë për durim dhe falënderim dhe se ajo që duhet është të hidhet shikimi drejt gradave të Xhenetit që janë të përhershme. Në këtë mënyrë njeriu vepron në dynja,

⁷⁴ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 186, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 217.

duke pasur droje ndaj Allahut të Madhërishëm, duke parë atë që ka përgatitur për llogarinë që do të japë në Ditën e Kiametit. Ky është një mësim për të gjithë ata që kanë arritur poste të larta dhe që Allahu i Madhërishëm u ka dhënë prej mirësive të Tij.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“O Zoti im! Ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar shpjegimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrotësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!”* (Jusuf: 101)

Kjo histori e plotë dhe me detaje ishte shpallje nga Zoti që i erdhi profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Në të ka aq shumë mësim madhështorë në të gjitha fushat e jetës njerëzore sa nuk mund të llogariten. Sado që kanë folur komentuesit e Kur’anit rreth kësaj historie, megjithatë nuk gjen në Kur’anin Famëlartë shpjegim më të hollësishëm dhe më të qartë se në këtë histori. Një nga gjërat më të rëndësishme që trajton ajo është dashakeqësia dhe dinakëria ndaj të tjerëve dhe sulmi ndaj tyre. Po ashtu, del në pah edhe fakti se zilia mund të zërë vend mes zemrave tona, duke i prishur edhe lidhjet mes vëllezërve që janë një nga lidhjet më të forta dhe pikërisht kjo ndodhi mes Jusufit [alejhi selam] dhe vëllezërve të tij.

Ky ishte një mësim për profetin Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe për gjithë Umetin deri në Ditën e Kijametit, si dhe për të gjithë ata që interesohen për çështjet e sigurisë në jetën e njerëzve.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Këto janë disa nga historitë e fshehta, të cilat Ne po t’i shpallim ty (o Muhamed). Ti nuk ke qenë me ata, kur vendosnin për punën e tyre dhe kurdisnin dredhira.”* (Jusuf: 102)

Musai [alejhi salam]

Bijtë e Izraelit jetuan në Egjipt që nga koha kur Jakubi [alejhi salam] emigroi drejt Egjiptit bashkë me fëmijët e tij kur Jusufi [alejhi salam] arriti të ketë një nga pozitat më të larta të pushtetit aty.⁷⁵

Por që nga koha e Faraonit të Egjiptit, Ramsisi i dytë dhe djali i tij, Faraonit të quajtur Munfeta nga familja e nëntëmbëdhjetë, e cila e sundoi Egjiptin mes viteve 1250-1350 para Krishtit, populli i bijve të Izraelit u përballën me keqtrajtime dhe tortura nga faraonët dhe ushtarët e tyre.⁷⁶

Allahu i Madhërishëm e përshkruan gjendjen e tyre në atë kohë me këto fjalë: *“Ne do të të tregojmë ty pjesë nga historia e Musait me Faraonin, ashtu siç ka qenë me të vërtetë, për njerëzit që besojnë. Me të vërtetë që Faraoni madhësh-tohej në Tokë dhe banorët e saj i kishte përçarë në grupe; disa prej tyre i përndiqte, ua vriste fëmijët*

⁷⁵ Shiko tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 33, tek Muhamed Abduselam “Benu israil fil Kur’an”, f. 45.

⁷⁶ Shiko për më shumë hollësi tek Abdul-Vehab En-Nexhar “Kisas el-enbija”, f. 24, si dhe tek Abdul-Ganij Abud “Enbijauallah vel hajatul muasire”, f. 76, si dhe tek Duruze në librin “Tarih beni israil min esfarihim”, f. 65.

meshkuj, ndërsa femrat ua linte gjallë. Ai ka qenë vërtet keqbërës.” (El-Kasas: 3-4)

Ky Faraon tiran kishte marrë vendim për vrasjen e të gjithë fëmijëve izraelitë djem të sapo lindur dhe robërimin e vajzave që do të punonin më pas si shërbëtore për ta.⁷⁷

Është përmendur tek disa komentues të Kur’anit se koptët u ankuan tek Faraoni për numrin e vogël të izraelitëve për shkak të vrasjes së foshnjave meshkuj dhe me kalimin e kohës me vdekjen e të rriturve dhe mungesën e meshkujve do të duhej t’i bënin vetë ato punë që deri tani i bënin izraelitët. Atëherë Faraoni urdhëroi që foshnjat djem që lindnin do të vriteshin një vit po e një vit jo. Tregohet se Haruni lindi në vitin kur fëmijët meshkuj nuk vriteshin, kurse Musai lindi në vitin kur duhet të vriteshin. Nëna e tij u shqetësua që në momentin e parë kur e kuptoi se kishte mbetur shtatzënë, edhe pse nuk i shfaqeshin dukshëm shenjat e shtatzënisë. Në momentin kur lindi, asaj i erdhi frymëzimi që të ndërtonte një shportë që e lidhi me një litar. Shtëpia e saj ishte në buzë të lumit Nil dhe sapo i jepte për të

⁷⁷ Shiko tek Dhiata e Vjetër, tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 33, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija” f.170, tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 199, tek Duruze në librin “Tarih beni israil min esfarihim”, f. 66, tek Abdul-Ganij Abud “Enbijaullah vel hajatul muasire”, f. 68, tek Muhamed Abduselam “Benu israil fil Kur’an el-kerim”, f. 26.

pirë qumësht, e vendoste në shportë dhe e lëshonte në lumë pasi e kishte lidhur me litar, derisa të iknin ushtarët, e më pas e merrte përsëri.⁷⁸

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Por vullneti Ynë ishte që t’u jepnim mirësi atyre që qenë të shtypur në tokë, t’i bënim prijës e trashëgimtarë, t’i forconim ata në Tokë dhe t’u tregonim Faraonit, Hamanit dhe ushtrisë së tyre atë prej së cilës ata frikësoheshin. Kështu, Ne e frymëzuan nënën e Musait: “Jepi gjë atij dhe, kur të trembesh për sigurinë e tij, hidhe në lumë, pa pasur frikë dhe as dëshpërim. Me siguri që Ne do të ta kthejmë ty atë dhe do ta bëjmë të dërguar.”* (El-Kasas: 5-7)

Allahu i Madhërishëm dëshironte të tregonte forcën e Tij dhe dobësinë e planit të Faraonit, sado i hollësishëm të ishte ai, për sa kohë që bazohej mbi padrejtësinë dhe mohimin e Zotit. Ishte vullneti i Allahut që Musai të rritej brenda shtëpisë së Faraonit, me gjithë masat e forta dhe të padrejta të sigurisë që kishte marrë ai nga frika e ardhjes së Musait, por vullneti i Zotit donte që Musai të rritej brenda në shtëpinë e Faraonit në siguri të plotë.

⁷⁸ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 239, tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 33, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 170, tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 199, tek Muhamed Abduselam “Benu israil fil Kur’an el-kerim”, f. 214, tek Hasen Duh në “Ibtilaat esh-sherr vel-hajr fi hayat el-enbija”, f. 56.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Por atë e mori nga lumi familja e Faraonit, me qëllim që një ditë ai të bëhej armik dhe t’u sillte mjerim atyre, sepse Faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre kanë qenë gjynahqarë.”* (El-Kasas: 8)

Allahu i Madhërishëm e kishte vendosur vrazhdësinë dhe ngurtësinë në zemrën e Faraonit, kurse në zemrën e gruas së tij kishte vendosur mëshirë, sepse ajo ishte një besimtare dhe njeri i mirë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Gruaja e Faraonit i tha atij: “Ky (djalë) është gëzim për mua dhe ty, prandaj mos e vrisni, sepse mund të jetë i dobishëm ose mund ta birësojmë.” Por ata nuk e dinin se çfarë po bënin.”* (El-Kasas: 9)

Nëna e Musait gati sa nuk e tregoi sekretin e saj, por Allahu i Madhërishëm ia forcoi zemrën dhe e bëri të qëndrueshme që djali i saj të mos vritej padrejtësisht nga Faraoni.⁷⁹

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ndërkohë, zemra e nënës së Musait u bë si të ishte e zbrazët. Edhe pak dhe çdo gjë do të zbulohej, sikur të mos*

⁷⁹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 201, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 173, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 240, tek Muhamed Abduselam “Benu israïl fil Kur’an el-kerim”, f. 215, tek Keneth Kanterz dhe të tjerë “Et-tefsir et tatbiki lil-kitab el-mukades”, f. 122.

ia kishim forcuar Ne zemrën, që të bëhej besimtare e vërtetë.” (El-Kasas: 10)

Ishte vullneti i Allahut që të ishte pikërisht nëna e Musait ajo që do t'i jepte qumësht atij, kurse vetë Faraoni do ta paguante me paratë e tij gjidhënësen e armikut të tij.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ajo i tha motrës së Musait: “Shko pas tij!” E motra e vrojtonte atë nga larg, pa u parë nga të tjerët. Ne bëmë që ai të mos pranonte asnjë mëndeshë. Kështu, e motra i tha atyre (që kishin birësuar Musain): “A doni t’ju gjej një familje, e cila do të kujdeset për të, duke e edukuar me kujdes?” Kështu, Ne e kthyem atë te nëna e vet, që ajo të gëzohej e të mos pikëlllohej dhe që ta dinte se premtimi i Allahut është i vërtetë; por, shumica e njerëzve nuk e dinë.” (El-Kasas: 11-13)*

Musai u rrit dhe u edukua në shtëpinë e Faraonit, duke mësuar çështjet e dynjasë dhe logjikën e saj, dhe Allahu i Madhërishëm e bëri që ta ruante besimin e tij të pastër të baballarëve të tij, Ibrahimit dhe Jakubit dhe Allahu e pajisi atë me dituri dhe urtësi.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe, kur ai arriti moshën madhore dhe pjekurinë e duhur, Ne i dhamë atij mençuri dhe dituri. Kështu, i shpërblejmë Ne ata, që bëjnë punë të mira.” (El-Kasas: 14)*

Kur Musai [alejhi selam] arriti moshën e rinisë ishte i fortë dhe trim që i druheshin të gjithë të rinjtë dhe kërkonin ndihmën e tij kur ishin në vështirësi. Në këtë kohë ndodhi një vrasje pa dashje nga ana e Musait [alejhi selam] ndaj një egjiptiani. Pas kësaj vrasjeje ai ndihej i penduar dhe i kërkonte falje Allahut për këtë krim që kishte ndodhur gabimisht.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Një herë Musai hyri në qytet, pa u vënë re nga banorët e tij. Atje pa dy njerëz që rriheshin. Njëri ishte nga të vetët, kurse tjetri ishte nga kundërshtarët. Ai i grupit të vet i kërkoi ndihmë kundër atij të popullit armik. Dhe Musai i ra me grusht atij, duke e vrarë. Pastaj tha: “Kjo është punë e djallit! Ai është armik i betuar i njeriut dhe ngatërrestar i hapur! O Zoti im! Njëmend, Unë i kam bërë keq vetes, andaj më fal!” Dhe Ai e fali. Pa dyshim, Ai është Falësi e mëshirëploti.”* (El-Kasas: 15-16)

Urrejtja që Musai [alejhi selam] kishte për vrasjen dhe kriminelët ishte e qartë që në fillim, gjë që e tregon edhe nxitimi i tij për t’u penduar dhe premtimi që bëri për të mos i ndihmuar kurrë të padrejtit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Musai tha: “O Zoti im! Falë të mirave që më ke dhënë, unë nuk do të bëhem ndihmës i të këqijve!”* (El-Kasas: 17)

Pa dyshim që në qytetin e Egjiptit ku Musai kreu vrasjen kishte organe të sigurisë që po e kërkonin vrasësin dhe, po ashtu, të afërmit e të vrarit po e kërkonin vrasësin për ta ndëshkuar. Por, me sa dukej, ngjarjen e kishte parë vetëm personi që i kërkoi ndihmë Musait dhe, për këtë arsye, autoritetet e sigurisë dhe të afërmit e të vrarit nuk kishin rënë në gjurmët e vrasësit. Megjithatë, kërkimi për të vazhdonte akoma dhe kjo e bënte Musanë të jetonte me frikën e arrestimit nga ana e tyre.⁸⁰

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Teksa Musai ecte në mëngjes i frikësuar në qytet, duke pritur se ç’do të ndodhte, kur ai që të djeshmen e kishte thirrir në ndihmë, e thirri sërish në ndihmë. Musai i tha: “Ti qenke tamam një ngatërrestar i hapur!”* (El-Kasas: 18)

Ishte i njëjti person që e nxiti Musai të gabonte herën e kaluar që po vazhdonte në gabimet e tij dhe po e nxiste atë përsëri për të kryer një krim të ri që Musai gati sa nuk e kreu, por viktima iu lut Musait për mëshirë dhe ai hoqi dorë prej tij.

⁸⁰ Shiko tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 34, tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 203, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija” f. 176, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 174, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 242, tek Muhamed Abduselam “Benu israil fil Kur’an el-kerim”, f. 216, tek Hasen Duh në “Ibtilaat esh-sherr vel-hajr fi hajjat el-enbija”, f. 59.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe, kur deshiti të sulmonte atë që ishte armik i të dyve, ai i tha: “O Musa, a do të më vrasësh edhe mua, siç vrave atë tjetrin dje?! Ti dëshiron vetëm që të bëhesh dhunues në tokë e nuk dëshiron të bëhesh nga ata që ndreqin e vendosin drejtësi.”* (El-Kasas: 19)

Kërkimet për vrasjen e parë vazhdonin akoma dhe gishti i akuzës po drejtohej drejt Musait. Pyetjet dhe hetimet filluan të vërtiten rreth Musait [alejhi selam] dhe shokët e tij më të afërm e ndjenë rrezikun, prandaj e paralajmëruan atë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Aty erdhi një njeri, duke nxituar prej skajit të qytetit, e tha: “O Musa, paria është mbledhur e po bisedon për të të vrarë, prandaj ik, sepse po ta jap një këshillë të sinqertë.”* (El-Kasas: 20)

Musai [alejhi selam] u detyrua të arratisesh nga qyteti, madje u përpoq të largohej drejt kufirit më të afërt të shtetit për të dalë plotësisht në një vend tjetër, jashtë autoritetit të shtetit të Egjiptit, ku Faraoni nuk kishte pushtet mbi të. Tokat e Medjenit në veriperëndim të Gadishullit Arabik ishin vendi më i afërt dhe ai shkoi atje, duke kaluar nëpër Gadishullin e Sinait dhe, tashmë, ishte jashtë autoritetit të shtetit të Egjiptit dhe Faraonit.⁸¹

⁸¹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 205, Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v .I, f. 244.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Musai doli prej qytetit i frikësuar, duke pritur se ç’do të ndodhte dhe tha: “O Zoti im, më shpëto prej popullit keqbërës! Teksa drejtohej nga Medjeni, ai tha: “Shpresoj se Zoti im do të më tregojë rrugën e drejtë!”* (El-Kasas: 21-22)

Musai [alejhi selam] ishte i mëshirshëm, e donte mirësinë dhe i pëlqente t’i ndihmonte të tjerët pa asnjë përfitim, por, duke shpresuar të fitojë kënaqësinë e Allahut të Madhërishëm duke i ndihmuar të dobëtit, i ndodhi një ndodhi me disa gra që ishin në nevojë dhe ai nuk nguroi që t’i ndihmonte ato.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur arriti tek pusi i Medjenit, ndeshi rreth tij shumë njerëz që u jepnin ujë kafshëve. Përveç tyre, ai vuri re dy vasha që po mbanin kafshët e veta. Ai tha: “Si e keni hallin ju?” Ato thanë: “Ne nuk u japim ujë, pa u larguar barinjtë. Babai ynë është shumë plak.” Kështu, Musai u dha ujë kafshëve të tyre e pastaj u kthye te një hije dhe tha: “Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!”* (El-Kasas: 23-24)

Musai [alejhi selam] ishte i lidhur fort pas Allahut të Madhërishëm dhe kthehej tek Ai me pendesë me gjithë gabimin që kishte bërë. Ai ishte kujdesur të largohej nga tokat e Faraonit që të ndihej i sigurt nga forca e pushtetit të tij, por edhe

për shkak se largimi nga vendi ku kishte bërë gabimin do ta ndihmonte atë që pendimi të ishte sa më i sigurt. Kur u takua me babanë e dy vajzave, ai e qetësoi atë, duke i thënë se, tashmë, ishte i sigurt dhe se ishte larg pushtetit dhe fuqisë së Faraonit tiran, sepse ishte në një tokë jashtë kufijve të shtetit të tij.⁸²

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Më vonë, njëra nga ato dyja, erdhi me ndrojtje dhe i tha: “Babai im të fton për të të shpërblyer, se i dhe ujtë (tufës sonë).” Kur Musai shkoi tek ai dhe i tregoi çfarë kishte përjetuar, ai tha: “Mos u frikëso, sepse ke shpëtuar prej një populli keqbërës!”* (El Kasas: 25)

Musai u martua me njërën nga vajzat e burrit të moshuar dhe qëndroi në Medjen dhjetë vjet, më pas mori familjen e tij dhe u nis të kthehej në Egjipt. Por, gjatë rrugës, Allahu i Madhërishëm i foli në malin Tur dhe e ngarkoi me misionin e profetit për t’ia përcjellë mesazhin Faraonit dhe ia bashkëngjiti me misionin e profetit edhe vëllain e tij, Harunin.⁸³

⁸² Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 244.

⁸³ Këtë e vërejmë në disa sure të Kur’anit Famëlartë, si *Ta Ha, El-Kasas, Esh-Shuara, En-Neml* etj. Shiko edhe tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 206-209, Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 242-249, dhe tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 177-180.

Kjo është hera e parë që një profet kërkon të ketë bashkë me të edhe një profet tjetër dhe Allahu e pranoi kërkesën e tij. Megjithatë, Musai [alejhi selam] i frikësohej gjynahut që kishte bërë më parë në Egjipt dhe vetë ajetet kur'anore na flasin për këtë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur Allahu e thërriti Musain: “Shko te populli keqbërës, populli i Faraonit! vallë, a nuk po i frikësohen ata Allahut?” Ai u përgjigj: “O Zoti im, unë kam frikë se do të më quajnë gënjeshtar, e zemra do të më ngushtohet, kurse gjuha mund të më lidhet, andaj, dërgoje edhe Harunin (të më ndihmojë). Unë jam edhe përgjegjës ndaj tyre për një krim, andaj kam frikë se do të më vrasin.” Allahu tha: “Kurrsesi! Shkoni që të dy me shenjat Tona. Me të vërtetë, Ne jemi me ju dhe dëgjojmë. Shkoni te Faraoni dhe i thoni: “Ne jemi të dërguarit e Zotit të botëve, që të lejoni bijtë e Izraelit të vijnë me ne!” (Esh-Shuara: 10-17)*

Si dhe kur thotë: *“Musai tha: “O Zoti im, unë kam vrarë një njeri të tyre, prandaj kam frikë se do të më vrasin.” (El-Kasas: 33)*

Pasi Musai arriti në Egjipt dhe hyri në takim me Faraonin pas një pritjeje të gjatë që vazhdoi me muaj.⁸⁴

Gjatë kësaj kohe Faraoni po përgatiste informacionet rreth Musait para se të takohej me të. Padyshim që ai kishte struktura të caktuara që e ndihmonin për ta bërë këtë dhe kjo tregon për kohën aq të hershme që kur kanë ekzistuar strukturat e rendit dhe të sigurisë që janë përgjegjëse për mbledhjen e informacioneve dhe ekzistencën e tyre që në kohën e lashtë të faraonëve. Për këtë arsye, Faraoni i bëri disa pyetje Musait që tregojnë se ai e njohte mirë atë që nga fëmijëria.⁸⁵

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Faraoni tha: “Vallë, a nuk të kemi rritur në gjirin tonë si fëmijë?! A nuk ke qëndruar midis nesh shumë vjet të jetës sate?! E pastaj bërë veprën që ti e di, duke qenë mosmirënjohës?!” Musai tha: “E kam bërë atë, kur nuk kam qenë i udhëzuar. Pastaj ika prej jush, kur u frikësova prej jush dhe Zoti im më dhuroi mençuri dhe më bëri një nga të dërguarit.”* (Esh-Shuara: 18-21)

⁸⁴ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 209, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 181, Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 253, dhe tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 181.

⁸⁵ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 208, Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 250, dhe tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 181.

Pyetja që Faraoni i bëri Musait për ngjarjen e vrasjes që i kishte ndodhur atij, ishte për t'u dukur para popullit të tij se ai ishte i interesuar për këtë çështje. Në të vërtetë atij as që i interesonte kjo, sepse ai vriste aq shumë nga bijtë e Izraelit sa kishte rrezik t'i shuante ata si popull, por ai e bënte këtë vetëm për të debatuar me Musain. Ai qëndroi gjatë tek një vrasje e vetme që kishte ndodhur gabimisht dhe pa dashje, por këtë e bëri që të tregonte aftësinë e strukturave të sigurisë së shtetit të tij për të marrë informacione për Musain dhe jetën e tij dhe për t'i nxjerrë atij përpara gabimet e tij, sipas pretendimeve të Faraonit, me qëllim që ta mohonte Allahun dhe t'i udhëhiqte njerëzit drejt adhurimit të vetes së tij, Allahu na ruajttë!

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Musai tha: “Zoti im e di mirë se kush i sjell udhëzimet prej Tij dhe kush do të ketë mbarimin e mirë në jetën tjetër. Sigurisht, keqbërësit nuk do të shpëtojnë.” Dhe Faraoni tha: “O pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot përveç meje! O Haman, më ndiz një zjarr për të pjekur qerpiçë dhe më ndërto një kullë të lartë që të ngjitem te Zoti i Musait. Jam i bindur se ai (Musai) gënjen!”* (El-Kasas: 37-38)

Po ashtu, Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ata që i kundërshtojnë shpalljet e Allahut, pa pasur asnjë provë, janë të urryer në sytë e Allahut dhe në sytë e atyre që besojnë. Kështu, Allahu ia vulos zemrën çdo mendjemadhi e dhunuesi.”* Dhe

Faraoni tha: "O Haman, ndërtoma një kullë që t'i arrij rrugët, rrugët e qiellit e të shoh Zotin e Musait, sepse jam i bindur se ai (Musai) gënjen." Kështu, Faraonit iu dukën të bukura veprat e tij të shëmtuara dhe u shmang nga rruga e drejtë, por dredhia e tij e çoi vetëm në rrënim." (Gafir: 35-37)

Qëllimi i Faraonit ishte mendjemadhësia dhe pretendimi i hyjnitetit (pretendonte se ishte Zot) si dhe tirania, nënshtrimi dhe poshtërimi i njerëzve. Por, nga ana tjetër, ai e dinte mirë se kushdo tjetër dobësinë e vetes dhe se ai nuk ishte Zot. Këto histori që kanë lidhje me jetën e Musait [alejhi selam] tregojnë se struktura të posaçme sigurie ka pasur që në kohë të lashta, pavarësisht nëse shfrytëzoheshin për të bërë padrejtësi apo për të vendosur drejtësi, por fakti është se ato kanë ekzistuar. Në veçanti ato që kanë të bëjnë me zbulimin e krimeve dhe gjetjen e fajtorëve, si dhe për ruajtjen e informacioneve për t'i përdorur ato kur të jenë të nevojshme. Kjo mund të përfitohet nga detajet e historisë dhe ngjarjet që kanë lidhje me të.

Ajo që vërejmë nga historia e Faraonit me Musain [alejhi selam] është se Faraoni u përpoq të shfaqet përpara popullit të tij sikur po kërkonte ta mbronte vendin e tyre, interesat dhe besimin e tyre, që në këtë rast ishte adhurimi i vetë atij në vend të Allahut dhe se, për hir të këtyre gjërave,

ai ishte i gatshëm ta sulmonte dhe t'i bënte keq Musait dhe atyre që ishin me të.⁸⁶

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Paria e popullit të Faraonit tha: “A mos vallë do ta lësh Musain dhe popullin e tij që të bëjnë ngatërresa në tokë dhe që të braktisin ty dhe zotat e tu?” Faraoni u përgjigj: “Meqenëse jemi sundues mbi ata, Ne do t'i vrasim djemtë e tyre dhe do t'i lëmë gjallë gratë e tyre.”* (El-A'raf: 127)

Me gjithë pretendimin e tij se po vazhdonte hetimin e krimit duke e marrë në pyetje Musain [alejhi selam], Faraoni në të vërtetë ishte kriminel dhe vrasësi më i madh, sepse ai kishte urdhëruar vrasjen e bijve të Izraelit dhe besimtarëve që ishin me Musain nga brenda familjes së Faraonit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe, kur ai u solli atyre të Vërtetën prej Nesh, ata thanë: “Vritini djemtë e atyre që i kanë besuar atij dhe lërinin të gjalla vajzat e tyre!” Por kurthet e mohuesve janë të dënuara të dështojnë. Faraoni tha: “Më lini ta vras Musain e ai le ta thërrasë në ndihmë Zotin e vet. Unë vërtet druham mos ai do t'jua ndryshojë fenë tuaj ose do të shkaktojë trazira në Tokë.” Musai tha: “Unë i lutem Zotit Tim dhe Zotit tuaj për të më mbrojtur prej çdo*

⁸⁶ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 212, Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I f. 255, dhe tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 185.

mendjemadhi, që nuk beson në Ditën e Llogarisë!”
(Gafir: 25-27)

Faraoni shfaqej para popullit të tij sikur kërkonte ta mbronte vendin dhe sigurinë e tyre, por, në të vërtetë, ai po i tërhiqte ata drejt shkatërrimit dhe zhdukjes, vetëm e vetëm që ata ta hyjnizonin atë në vend të Allahut. Ai kishte tubuar para vetes të gjitha forcat dhe energjitë e tij për të pretenduar se është Zot, duke i përdorur të gjitha këto energji drejt shokvënies së Zotit dhe adhurimit të tij në vend të adhurimit të Allahut.⁸⁷ Rezultati i kësaj ishte fatkeqësi për të dhe për popullin e tij që iu bindën.

Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Por ai (Faraoni) e mohoi dhe e kundërshtoi. Pastaj i ktheu shpinën, duke u përpyetur (kundër së vërtetës) dhe tuboi njerëzit e u deklaroi: “Unë jam zoti juaj më i lartë!” Prandaj Allahu e goditi atë me dënim në jetën tjetër dhe në këtë jetë. Kjo është këshillë për ata që i frikësohen Allahut.”*** (En-Naziat: 21-26)

Faraoni ishte kriminel, vrasësi dhe zullumqari më i madh, prandaj Allahu i Madhërishëm e mbyti atë dhe i shpëtoi njerëzit e dobët të bijve të Izraelit.

Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Ne i mbartëm izraelitët përtej detit dhe Faraoni me ushtrinë e***

⁸⁷ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 213.

tij i ndoqi ata nga ligësia dhe armiqësia. Por, kur po mbytej, (Faraoni) tha: "Besoj se s'ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit; dhe unë jam ndër muslimanët." "Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar?! Sot do të shpëtojmë vetëm trupin tënd, që të bëhesh mësim për ata që vijnë pas teje." Por, në të vërtetë, shumica e njerëzve nuk ua vënë veshin shenjave Tona." (Junus: 91-92)

Allahu i Madhërishëm, gjithashtu, thotë: *"Ndërsa popullit të përndjekur Ne i dhamë në zotërim viset lindore dhe perëndimore të tokës që kishim bekuar. Kështu u përmbush premtimi i bukur i Zotit tënd ndaj izraelitëve, për shkak të durimit që treguan. Ndërsa ndërtesat dhe kullat e Faraonit dhe të popullit të tij Ne i shkatërruam." (El-A'raf: 137)*

Marrëdhënia mes Musait dhe Faraonit mund të përmbledhet në kujdesin që Musai tregonte për t'u dhënë lirinë bijve të Izraelit që të largoheshin nga tirania dhe padrejtësia e Faraonit. Kurse Faraoni e vështronte nga një këndvështrim tjetër që e bënte ta justifikonte padrejtësinë e tij ndaj këtyre të dobtëve për t'i mbajtur ata nën kontrollin dhe nën padrejtësinë e tij, duke ditur edhe se ai pretendonte se ishte Zot, kurse ata besonin se ka vetëm një Zot dhe ishin pasues të Musait [alejhi selam].

Në përfundim triumfi ishte në anën e besimtarëve të Allahut nga bijtë e Izraelit që e ndiqnin Musain [alejhi selam], kurse shkatërrimi i erdhi Faraonit dhe atyre që ndoqën rrugën e tij në padrejtësitë që bënte.⁸⁸

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kujto kur Musai i tha kombit të vet: “Allahu ju urdhëron të therni një lopë!” Ata thanë: “A do të talleh me ne?” - “Zoti më ruajt!” - tha Musai - “të bëhem unë nga të paditurit!” Ata thanë: “Lutju Zotit tënd, që të na shpjegojë si duhet të jetë ajo!” Musai tha: “Ajo të jetë një lopë as plakë, as e re, por e mesme; pra, bëni atë që ju është urdhëruar!” Ata thanë: “Lutju Zotit tënd që të na shpjegojë çfarë ngjyre të ketë ajo!” Musai tha: “Ai thotë se ajo duhet të jetë lopë me ngjyrë të verdhë të ndezur, të cilën e pëlqejnë shikuesit.” Ata thanë: “Lutju Zotit tënd, që të na shpjegojë çfarë lloji të jetë, sepse lopët të gjitha na duken njësoj e ne, në dashtë Zoti, do të udhëzohemi në rrugën e drejtë.” Musai tha: “Ai thotë se lopa s’duhet të jetë e lodhur nga lërimi apo nga ujitja e tokës, por të jetë e shëndoshë dhe pa asnjë të metë.” Ata thanë: “Tani na the të vërtetën.” Kështu, ata e therën lopën, por desh e lanë pa flijuar. Dhe, pasi vratë një njeri e u grindët me njëri-tjetrin në lidhje me*

⁸⁸ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 214, tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 36, tek Eth-Thalebi në librin “Kisas el-enbija”, f. 203, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 188, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 268.

të, Allahu e nxori në shesh atë që fshihnit ju. Ne ju thamë: "Prekeni të vrrarin me një copë të lopës së flijuar!" Dhe kështu, Allahu do t'i ngjallë të vdekurit dhe do t'ju tregojë mrekullitë e veta, që ju të kuptoni." (El-Bekare: 67-73)

Në komentin që i bën Et-Taberi këtyre ajeteve tregon disa variante. Në njërin prej tyre thuhet se tek bijtë e Izraelit ishte një burrë steril (që nuk mund të kishte fëmijë). Atë e vrau kujdestari i tij dhe trupin e tij e hodhi tek një fis tjetër larg fisit të tij. Për shkak të kësaj, filloi armiqësia mes tyre derisa kapën armët, por më të diturit e tyre u thanë: "A doni të bëni luftë, ndërkohë që në mesin tuaj keni të dërguarin e Allahut?" Kështu ata shkuan tek profeti i Allahut dhe ai u tha: "Therni një lopë!" Ata thanë: "A do të tallesh me ne?" Ai tha: "Zoti më ruajt të bëhem unë nga të paditurit!" Ata thanë: "Lutju Zotit tënd, që të na shpjegojë si duhet të jetë ajo!" Ai tha: "Ajo të jetë një lopë..." deri tek: "Kështu, ata e therën lopën, por desh e lanë pa flijuar." Pastaj e prekën të vrrarin me një copë të lopës së flijuar dhe ai tregoi se kush ishte vrasësi." Thotë se ata u detyruan ta blejnë lopën me aq peshë florinj sa ishte pesha e lopës. Nëse ata do të kishin gjetur një lopë të çfarëdoshme ajo do ta kishte kryer funksionin njësoj. Pas kësaj asnjë vrasësi nuk iu dha më pjesë nga trashëgimia e të vrrarit."⁸⁹

⁸⁹ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 401-402, tek Ibnul Ethiri në librin "El-kamil", v. I, f. 188, tek Ibnu Kethir tek

Po ashtu, është transmetuar edhe një histori tjetër që ka lidhje me sigurinë në jetën e Musait [alejhi selam]. Karuni ishte nga populli i Musait, por u bë kundërshtar i tij dhe e akuzoi Musain me akuza të pabaza dhe të pavërteta. Ai e akuzoi atë për krimin e zinasë (imoralitetit) në një kohë që Musai i urdhëronte njerëzit të largoheshin nga një veprim i tillë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Me të vërtetë, Karuni ka qenë nga populli i Musait, por i shtypte ata. Ne i patëm dhënë atij aq thesare, saqë çelësat e tyre vështirë se do të mund t’i mbante një grup njerëzish të fuqishëm. Njerëzit e popullit të tij i thanë: “Mos u ngazëlle me pasurinë që ke, sepse Allahu nuk i do ata që ngazëllehen!”* (El-Kasas: 76)

Taberiu transmeton nga Ibn Abasi [radijallahu anhu] se ka thënë: “Kur u bë obligim zekati, Karuni shkoi tek Muasi [alejhi selam] dhe ranë dakord që ai do të jepte zekat vetëm një dinar për çdo një mijë dinarë që kishte dhe nga një pjesë të vetme për çdo një mijë të tilla që kishte, ose tha: ‘Një dele për çdo një mijë të tilla që kishte.’ Ai u kthye në shtëpi, por kur e bëri llogarinë e zekatit që duhet të jepte, iu duk shumë. Ai i tuboi bijtë e Izraelit dhe u tha: “O bijtë e Izraelit! Musai ju urdhëroi për çdo gjë dhe ju e ushqyet atë, kurse

historia e lopës së Beni Israilëve në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 293, tek Esh-Sheukani në “Fet’hul kadir”, v. II, f. 99.

tani ai kërkon që të marrë nga pasuritë tuaja.” Ata i thanë: “Ti je më i madhi dhe i pari jonë, prandaj na urdhëro për çfarë të duash.” Ai u tha: “Unë ju urdhëroj që ta sillni filan gruaje të përdalë (prostitutë), ta paguani atë që ajo ta akuzojë Musain se ka bërë zina me të.” Ata e thirrën atë dhe i dhanë një sasi parash për ta akuzuar Musain se ka bërë zina me të. Më pas erdhi Musai dhe i tha: “Bijtë e Izraelit janë mbledhur që t’ua komunikosh urdhëresat dhe ndalesat e Zotit.” Ai doli para tyre në një vend të hapur dhe u tha: “O bijtë e Izraelit! Atij që vjedh do t’i pritët dora, ai që shpif do të goditet me kamxhik, kush bën zina (imoralitet) dhe është i pamartuar, ai do të goditet me njëqind kamxhikë, e kush bën zina (imoralitet) dhe është i martuar, ai do të goditet me kamxhikë deri në vdekje ose do të goditet me gurë deri në vdekje.” Karuni i tha: “Po nëse je ti?” Ai tha: “Po, edhe nëse jam unë!” Ai i tha: “Bijtë e Izraelit pretendojnë se ti ke bërë zina me filanen!” Ai tha: “Thirreni atë këtu! Nëse ajo e pranon, atëherë është ashtu siç thotë ajo!” Kur erdhi ajo, Musai i tha: “O filane!” Ajo i tha: “Urdhëro!” I tha: “A e kam bërë unë me ty atë që thonë këta?” Ajo tha: “Jo, gënjejnë, sepse ata më dhanë para që të të akuzoj se ke bërë zina me mua.” Në këtë moment Musai [alejhi selam] u ngrit nga vendi dhe ra në sexhde në mesin e tyre. Në këtë moment, Allahu i Madhërisëm i shpalli atij: “Urdhëroje tokën me çfarë të

duash." Ai tha: "O tokë, merri ata!" - dhe ajo i zhyti ata deri tek këmbët. Ai tha: "O tokë, merri ata!" - dhe ajo i zhyti ata deri tek gjunjët. Ai tha: "O tokë, merri ata!" - dhe ajo i zhyti ata deri tek beli. Ai tha: "O tokë, merri ata!" - dhe ajo i zhyti ata deri tek fyti dhe ata filluan t'i thërrasin: "O Musa, o Musa...!" dhe t'i përgjërohen atij. Ai tha: "O tokë, merri ata!" - dhe ajo i zhyti ata plotësisht."⁹⁰

Tek kjo histori shohim se ndëshkimi hyjnor zbrit në këtë botë mbi ata që i akuzojnë padrejtësisht të pafajshmit dhe e nëpërkëmbin nderin e tyre. Megjithëse ky ndëshkim ra mbi Karunin, për shkak se ai tentoi t'i bënte keq Musait që ishte profet i Allahut, duke e akuzuar padrejtësisht, gjejmë shumë dëshmi nga jeta e njerëzve të zakonshëm ku ndëshkimi i shpejt ka zbritur mbi ata që dëshmojnë duke e ditur se është gënjeshtër dhe mbi ata që i akuzojnë padrejtësisht njerëzit e pafajshëm. Histori të tilla janë të shumta dhe i hasim në të gjitha shoqëritë, duke mos përmendur këtu ndëshkimin që do të marrin ata kur të dalin para Allahu të Madhërishëm.

⁹⁰ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 109-110, tek Esh-Sheukani në "Fe't'hul kadir", v. IV, f. 185, tek Ibnu Kethir tek historia e Karunit me Musain në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. I, f. 293.

Davudi [alejhi selam] dhe Sulejmani [alejhi selam]

Davudi [alejhi selam] është një nga mbretërit më të spikatur të bijve të Izraelit në Bejtul Makdis. Ai sundoi atje në vitin 1010 para Krishtit.⁹¹

Ai ishte edhe profet edhe mbret në të njëjtën kohë. Kur'ani Famëlartë na flet për të në gjashtëmbëdhjetë vende.⁹²

Davudi [alejhi selam] filloi të spikaste tek bijtë e Izraelit si ushtar profesionist në ushtrinë e Talutit, historia e të cilit është përmendur në Kur'anin Famëlartë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“A nuk e ke dëgjuar ti (o Muhamed) se çfarë i tha para e bijve të Izraelit, pas Musait, një profeti të tyre? I tha: “Na dërgo një mbret, që të luftojmë në rrugën e Allahut!” - Profeti u tha: “Po sikur të mos luftoni kur të shpallet lufta?” Ata thanë: “E përse të mos luftojmë në rrugën e Allahut, ne që jemi dëbuar nga atdheu ynë dhe jemi ndarë nga fëmijët tanë?!” Mirëpo, kur u urdhëruan të luftojnë, ata nuk luftuan, me përjashtim të një pakice. Allahu i njej*

⁹¹ Shiko tek Keneth Kanterz dhe të tjerë “Et-tefsir et-tatbijki lilkitab el-mukades”, f. 60, si dhe tek Abdul-Ganij Abud “Enbijauallah vel-hajatul-muasire”, f. 57

⁹² Shiko tek Abdul-Vehab En-Nexhar “Kisas el-enbija”, f. 361.

mirë keqbërësit. Profeti i tyre u tha: "Allahu ka dërguar Talutin si mbretin tuaj." Ata thanë: "Si mund të bëhet ai mbreti ynë, kur ne kemi më tepër merita se ai për të sunduar?! Përveç kësaj, ai nuk ka ndonjë pasuri të madhe." Ai u përgjigj: "Allahu e ka zgjedhur atë për mbretin tuaj dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe me fuqi trupore. Allahu ia jep pushtetin e Vet kujt të dojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijsëm." Profeti u tha atyre: "Shenjë e sundimit të tij është ardhja e Arkës. Aty ka qetësi për ju nga Zoti juaj dhe relike të lëna nga familja e Musait dhe Harunit. Atë e bartin engjëjt. Sigurisht që kjo është një shenjë për ju, nëse jeni besimtarë!" Kur Taluti u nis për luftë bashkë me ushtrinë, u tha atyre: "Allahu do t'ju provojë me një lumë. Kush pi ujë në të, nuk është ushtari im. Ndërsa kush nuk pi ujë në të ose kënaqet vetëm me një grusht ujë, është ushtari im." Por të gjithë pinë, përveç një pakice. Pasi ai me ata (ushtarë) që ishin besimtarë kaluan lumin, shumë prej tyre thanë: "Ne sot nuk kemi fuqi të luftojmë me Xhalutin dhe ushtrinë e tij." Por ata që ishin të bindur se do të takoheshin me Allahun, thanë: "Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit." Dhe kur u përballën me Xhalutin dhe ushtrinë e tij, thanë: "Zoti ynë! Na pajis me durim, na forco këmbët tona dhe na ndihmo kundër këtij populli jobesimtar!" Me ndihmën e Allahut, ata i

thyen armiqtë dhe Dauti e vrau Xhalutin. Allahu i dha atij pushtetin dhe Profecinë dhe i mësoi dituritë që deshi. Sikur Allahu të mos i ndihmonte njerëzit e mirë kundër të këqijve, bota do të ishte shkatërruar. Por Allahu është shumë Bujar me krijesat e Veta.” (El-Bekare: 246-251)

Në fillimet e jetës së tij, Davudi [alejhi selam] ishte ushtar dhe mori pjesë në luftërat kundër armiqve të popullit të tij për të jetuar në siguri në vendin e tyre. Më pas i ngjiti gradat derisa populli i Izraelit e zgjodhën atë për mbret, pas vdekjes së Talutit për të cilin, pas disa ngjarjesh të ndara dhe të gjata, nuk gjejmë më tej asgjë për të as në Kur’an dhe as në hadithet profetike dhe as tek historianët muslimanë, përveç disa historish nga ato që tregohen rreth izraelitëve.⁹³

Davudi [alejhi selam] ishte edhe mëkëmbës i Zotit në tokë. Këtë na e tregon Kur’ani Famëlartë dhe misioni i tij ishte vendosja e drejtësisë që njerëzit të ndiheshin të sigurt dhe më e rëndësishme është drejtësia mes njerëzve, sepse me anë të saj sundon siguria dhe vendoset rregulli. Kur’ani Famëlartë na e tregon këtë kur Allahu i

⁹³ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 348, dhe tek tefsiri i tij, v. I, f. 621, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 9, tek Esh-Sheukani në “Fet’hul kadijr”, v. IV, f. 267, Muhamed Izet Duruze në librin “Tarih beni israil min esfarihim”, f. 145, tek Bibla, Samueli i dytë, tek Keneth Kanterz “Et-tefsir et-tatbijki lilkitab el-mukades”, f. 573.

Madhërishëm thotë: *“O Davud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut! Me të vërtetë, për ata që largohen nga rruga e Allahut, ka dënim të ashpër, ngaqë e kanë harruar Ditën e Llogarisë.”* (Sad: 26)

Allahu i Madhërishëm, gjithashtu, thotë: *“Ne ia forcua mbretërinë dhe i dhamë mençuri e dijeni për të gjykuar.”* (Sad: 20)

Komentuesit e Kur’anit përmendin disa shkaqe për pushtetin e tij të fortë. Ndër ta është se Allahu i Madhërishëm e inspiroi atë të gjykonte mes njerëzve për çështje të ndryshme dhe kjo e nxori në pah fuqinë dhe vendosmërinë e tij në ndëshkimin e kriminelëve, prandaj edhe pushteti i tij ishte i fortë dhe me autoritet, duke bërë që siguria të sundonte në mesin e nënshtetasve të tij dhe në të gjitha anët e mbretërisë së tij.⁹⁴

Allahu i Madhërishëm ia inspiroi Davudit [alejhi selam] punimin e veshjeve mbrojtëse të ushtarëve për t’u mbrojtur nga goditjet e armikut, qofshin ato shpata apo edhe shigjeta. Davudi

⁹⁴ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 348, dhe tek tefsiri i tij, v. I, f. 563, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 12, tek Esh-Sheukani në “Fet’hul kadir”, v. I, f. 267.

[alejhi selam] ishte i pari që prodhoi veshje të tilla të formuara nga hallkat e zinxhirëve.⁹⁵

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Me të vërtetë, Ne i dhamë Davudit mirësi prej Nesh (dhe thamë): “O male dhe zogj! Lavdërojeni emrin Tim bashkë me Davudin.” Ne ia zbutëm atij hekurin, (dhe i thamë): “Puno parzmore të gjera! Thuri ato me maja të barazpeshuara dhe bëj vepra të mira! Pa dyshim, Unë shoh çfarë punoni ju.”* (Sebe’: 10-11)

Dhe thotë: *“Ne i mësuam atij (Davudit) punimin e parzmoreve prej hekuri për ju, për t’ju mbrojtur në luftë me armikun, andaj, a jeni mirënjohës?”* (El-Enbija: 80)

Allahu i Madhërishëm e qortoi Davudin [alejhi selam] për shkak të një çështjeje rreth të cilës historianët dhe komentuesit kanë mendime të ndryshme. Hebreujtë gabuan ndaj profetit të tyre, duke pretenduar se ai ka bërë një veprim që as njerëzit e thjeshtë nuk e bëjnë, por vetëm kriminelët e bëjnë atë, e jo më një profet i Zotit. Dijetarët muslimanë e kanë respektuar Davudin [alejhi selam] më shumë se vetë bijtë e Izraelit dhe e kanë nxjerrë në pah pastërtinë e tij.⁹⁶

⁹⁵ Shiko tek Et-Taberi tek tefsiri i tij, v. I, f. 551, tek Esh-Sheukani në “Fe’hul kadir”, v. III, f. 419.

⁹⁶ Shiko në Bibël tek Samueli i dytë, tek Keneth Kanterz dhe të tjerë “Et-tefsir et-tatbijki lilkitab el-mukades”, f. 661, Muhamed Izet Duruze në librin “Tarih beni israil min esfarihim”, f. 149, tek

Ajo që është e sigurt është se e drejta ishte në anën e Davudit [alejhi selam]. Allahu i Madhërishëm dërgoi disa engjëj që dukeshin si disa persona që kishin një mosvarrëveshje mes tyre dhe që kishin ardhur tek ai që të gjykonte mes tyre, por në të vërtetë ata kishin ardhur që t'ia bëjnë të ditur gabimin dhe për ta udhëzuar drejt së drejtës. Pikërisht këtë kuptojmë nga fjalët e Kur'anit Famëlartë, ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“A e ke dëgjuar historinë e dy kundërshtarëve, që hipën mbi murin e faltores së tij? Kur hynë te Davudi, ai u frikësua prej tyre. Ata thanë: “Mos u frikëso! Ne jemi dy kundërshtarë, një nga të cilët i ka bërë padrejtësi tjetrit, prandaj gjyko me drejtësi dhe mos u shmang (prej së vërtetës), por na udhëzo në rrugë të drejtë.”* (Njëri prej tyre tha:) *“Ky është vëllai im. Ai ka nëntëdhjetë e nëntë dele, kurse unë kam vetëm një dele, andaj më tha: “Ma jep mua atë!” - dhe më mundi me fjalë.”* Davudi tha: *“Vërtet, ai të ka bërë padrejtësi që të ka kërkuar delen tënde të vetme, për ta bashkuar me delet e veta. Shumë bashkëpronarë i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira, por ata janë pak.”* Davudi e kuptoi, se në të vërtetë Ne e kishim vënë në provë atë, prandaj kërkoi falje nga Zoti i vet, ra në gjunjë dhe u përul, duke u penduar. Pastaj, Ne ia falëm këtë e ai te Ne do të jetë i afërt dhe do të ketë

Muhamed El-Fekij në librin “Kisas el-enbija”, f. 356, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 13.

strehim të mirë (në jetën tjetër). “O Davud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndër-mjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut! Me të vërtetë, për ata që largohen nga rruga e Allahut, ka dënim të ashpër, ngaqë e kanë harruar Ditën e Llogarisë.” (Sad: 21-26)

Allahu i Madhërishëm i dhuroi Davudit [alejhi selam] një djalë të devotshëm dhe të ditur që më pas u bë dhe profet. Ai iu bë ndihmë babait të tij në vendosjen e drejtësisë mes njerëzve.⁹⁷

Allahu i Madhërishëm i dhuroi atij Sulejmanin [alejhi selam], të cilin e lavdëron me fjalët: *“Ne i falëm Davudit Sulejmanin, një rob të mrekullueshëm. Ai i drejtohej gjithnjë me pendesë Zotit!”* (Sad: 30)

Sulejmani [alejhi selam] e ndihmoi babanë e tij në vendosjen e drejtësisë mes njerëzve. Në kohën e tyre shoqëria përbëhej nga barinj të dhe buqit dhe herë pas herë mes tyre ndodhnin probleme. Disa barinj kishin hyrë me delet e tyre në parcelën me rrush të disa njerëzve, të cilët erdhën të ankohen tek Davudi [alejhi selam] që në atë kohë ishte dhe gjykatësi. Sulejmani [alejhi selam], pasi ishte bërë burrë, merrte pjesë nëpër seancat e

⁹⁷ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të tefsirit, v. I, f. 576, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 1, tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 57.

gjyqeve, madje edhe gjykonte mes njerëzve që secili të merrte atë që i takonte dhe siguria të përhapet ngado. Kur Davudi dhe Sulejmani e dëgjuan çështjen, patën gjykime të ndryshme, por gjykimi më i drejtë ishte ai i Sulejmanit [alejhi selam] me gjithë diturinë, meritat dhe përpjekjet e Davudit [alejhi selam]. Me anë të këtij gjykimi, ai u dha barinjve mësimin që meritonin, kurse bujqve u dha kompensimin që u takonte.⁹⁸

Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Kujtoje) edhe Davudin dhe Sulejmanin, kur gjykuan mbi të lashtat në të cilat kishin kullotur natën bagëtitë e disa njerëzve. Ne ishim dëshmitarë të gjykimit të tyre. Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejtë çështjen dhe, që të dyve u dhamë mençuri e dituri. Ne i nënshtroam malet dhe shpendët që, bashkë me Davudin, të thurnin lavde (për Allahun). Ishim Ne që i bënim këto.”* (El-Enbija: 78-79)

Sulejmani [alejhi selam] ishte nxënës i babait të tij në gjithçka, por ai ishte një nxënës që gati po ia kalonte atij, sidomos në vendimet që merrte kur gjykonte mes njerëzve dhe vendoste drejtësi dhe ky ishte edhe njëri nga shkaqet kryesore të sigurisë në mbretërinë që trashëgoi nga babai i tij.⁹⁹

⁹⁸ Shiko tek Muhamed El-Fekij në librin “Kisas el-enbija”, f. 376.

⁹⁹ Shiko tek Muhamed Abduselam “Benu israil fil Kur’an el-kerim”, f. 50.

Allahu i Madhërishëm u dha mirësi të shumta Davudit dhe Sulejmanit duke u mësuar atyre dituri që shumë njerëz nuk i njihnin. Ata kishin dhuntinë e komunikimit me disa krijesa siç ishin shpendët, insektet etj. Ata e kuptonin gjuhën e tyre dhe përfitonin prej tyre në disa misione të veçanta.¹⁰⁰

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ne i dhamë Davudit dhe Sulejmanit dituri dhe ata thanë: “Qoftë lavdëruar Allahu që na ka ngritur mbi shumicën e robërve të Tij besimtarë! Sulejmani e trashëgoi Davudin (në misionin e tij profetik) dhe tha: “O populli im! Neve na është mësuar gjuha e shpendëve dhe na është dhënë gjithçka. Kjo është vërtet dhunti e madhe.” (En-Neml: 15-16)*

Allahu i Madhërishëm i dha Sulejmanit fuqi të madhe ushtarake dhe aftësi për t’i komanduar ata. Mes tyre kishte njerëz, xhindë dhe zogj, sepse Allahu i Madhërishëm ka fuqi për të bërë gjithçka.¹⁰¹

Në kohët moderne shikojmë se si disa struktura ushtarake ose organe të sigurisë kanë aftësi për përdorimin e zogjve, delfinëve ose qenve për

¹⁰⁰ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 15, 18 dhe 20, dhe tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. IX, f. 502.

¹⁰¹ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 20, tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. IX, f. 503, tek Muhamed El-Fekij në librin “Kisas el-enbija”, f. 377.

disa misione sigurie ose ushtarake si rezultat i kërkimeve dhe trajnimit. Po ashtu, vërejmë se kërkimet kanë vërtetuar se zogjtë dhe kafshët kanë një gjuhë të përbashkët dhe të kuptueshme. Përderisa njerëzit kanë zbuluar me përpjekjet e tyre disa çështje dhe kanë mundur të përfitojnë nga këto krijesa në një formë a në një tjetër, pa dyshim që Allahu është më i Madhërishëm dhe më i Ditur për t'i nënshtruar ato për Sulejmanin [alejhi selam], por edhe për të tjerë. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Para Sulejmanit u tubua ushtria e Tij e përbërë prej xhindeve, njerëzve dhe shpendëve, të gjithë të radhitur në çeta të gatshme.”* (En-Neml: 17)

Kur’ani na flet edhe për një ngjarje që i ka ndodhur Sulejmanit dhe ushtarëve të tij që vuri në dukje falënderimin e Sulejmanit ndaj Allahut të Madhërishëm për nënshtrimin e krijesave nën urdhrat e tij dhe dedikimin e kësaj force dhe fuqie ndaj dhuntisë së Allahut të Madhërishëm.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: “O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!” Ai vuri buzën në gaz, duke qeshur me fjalët e saj dhe tha: “O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me*

mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!” (En-Neml: 18-19)

Ajetet e Kur’anit na tregojnë edhe përfitimin e Sulejmanit nga zogu i pupëzës, që ishte një zog i njohur për të marrë informacione dhe për t’i hetuar krimet, e krimi më i madh tek ai dhe tek gjithë profetët është krimi i shokvënies ndaj Allahut.¹⁰²

Ajetet na tregojnë për rolin që luajti ky zog në përcjelljen e mesazhit të Sulejmanit për tek ata që kishin nevojë për këtë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ai bëri kontrollin e shpendëve e tha: “Pse nuk e shoh pupëzën këtu, a nuk është e pranishme ajo? Nëse nuk do të më sjellë arsyetim bindës, do ta dënoj me dënim të rëndë ose do ta ther!” Nuk vonoi shumë e ajo erdhi dhe tha: “Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur dhe të kam sjellë lajme të vërteta prej (qytetit të) Shebës. Kam parë një grua që sundonte popullin (e atij qyteti). Ajo zotëronte çdo gjë dhe kishte një fron madhështor. Kam parë se ajo dhe populli i saj adhuronin Diellin e jo Allahun. Djalli ua paraqiste të bukura sjelljet e tyre, duke i larguar nga rruga e drejtë, prandaj nuk ishin të udhëzuar. Ata nuk i përuleshin në sexhde Allahut,*

¹⁰² Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 22, tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 354, dhe tek tefsiri i tij, v. IX, f. 506, tek Muhamed El-Fekij në librin “Kisas el-enbija”, f. 366

i Cili nxjerr gjithçka që është e fshehur në qiej dhe në Tokë dhe di çfarë fshihni ju dhe çfarë tregoni haptazi. Allahu është Një, s'ka zot të vërtetë përveç Tij, Zotit të Arshit të madh!" Sulejmani tha: "Do të shohim se a thua të vërtetën apo je gënjeshtar. Shko me këtë letër timen e çojua atyre. Pastaj largohu pak nga ata dhe shiko cila do të jetë përgjigjja e tyre!" Mbretëresha (e Shebës) tha: "O paria ime! Mua më ka ardhur një letër fisnike. Ajo është nga Sulejmani dhe është: "Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Mos u madhështoni para meje dhe ejani të përlulur si besimtarë!" (En-Neml: 20-31)

Kjo grua ishte e mençur në udhëheqjen e saj dhe e kujdesshme për popullin e saj. Për këtë arsye ajo nxitoi të organizonte një mbledhje dhe të këshillohej me ta për të vendosur se si do të vepronin me letrën e Sulejmanit, i cili e kërcënonte seriozisht vendin e tyre.¹⁰³

Kur'ani na tregon se ajo u drejtohet atyre, duke thënë: *"O paria ime, më këshilloni se ç'duhet të bëj në këtë çështje! Unë nuk do të vendos asgjë pa ju!"* (En-Neml: 32)

Përgjigjja e këshilltarëve të saj erdhi menjëherë, duke thënë: *"Ne jemi shumë të fortë dhe*

¹⁰³ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 355, dhe tek tefsiri i tij, v. IX, f. 51, tek Ibnul Ethiri në librin "El-kamil", v. I, f. 33, tek Ibnu Kethiri në librin "El-bidaje ve en-nihaje", v. II, f. 22.

luftëtarë të guximshëm, por urdhri të takon ty, andaj mendo mirë se ç'do të urdhërosh!" (En-Neml: 33)

Ajo e shtroi çështjen e sigurisë së vendit të saj dhe shkatërrimin që mund të vijë si rezultat i kundërshtimit të Sulejmanit, hyrjes së tij forcërisht në tokat e tyre dhe trazirat e përgjithshme që ndodhin në rast pushtimi: *"Ajo tha: "Njëmend, kur mbretërit pushtojnë ndonjë vendbanim, e rrënojnë atë dhe e poshtërojnë parinë e tij. Kështu veprojnë ata."* (En-Neml: 34)

Pastaj u përpoq që ta zbuste qëndrimin e Sulejmanit: *"Tani do t'u dërgoj atyre një dhuratë dhe do të shoh me se do të kthehen të deleguarit."* (En-Neml: 35)

Por Sulejmani [alejhi selam] nuk e kishte qëllim pasurinë.¹⁰⁴

Ai kishte për qëllim ftesën drejt njësimi të Zotit dhe braktisjes së idhujtarisë, prandaj e kundërshtoi dërgimin e pasurisë, duke treguar se ishte i panevojshëm për pasuri dhe se parimi ishte më i rëndësishëm për të, duke thënë: *"Kur erdhën (të deleguarit), Sulejmani tha: "A mos doni të më*

¹⁰⁴ Dhiata e Vjetër flet për historinë e Sulejmanit dhe mbretëreshës së Shebës, por ata e konsideruan pasurinë si qëllimin kryesor të Sulejmanit dhe kjo bie në kundërshtim me atë që na tregon Kur'ani Famëlartë. Shiko tek "Mbretërit". Po ashtu, shiko tek Muhamed Izet Duruze në librin "Tarih beni israil min esfarihim", f. 168.

ndihmoni me pasuri?! Ajo që më ka dhënë Allahu, është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve. Por ju gëzoheni me dhuratën tuaj.” (En-Neml: 36)

Ai e vazhdoi kërcënimin e tij ndaj sigurisë së Belkisës dhe vendit të saj nëse nuk bindeshin dhe nuk dorëzoheshin, duke u kthyer drejt rrugës së Zotit dhe së drejtës.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kthehuni tek ata! Ne do të sjellim ushtri, të cilën nuk do të mund ta përballojnë ata dhe, me siguri, do t’i dëbojmë ata prej Shebës të poshtëruar dhe të përuhur.”* (En-Neml: 37)

Kjo histori dhe këto shkëmbime mesazhesh përfunduan me pranimin nga ana e Belkisës së besimit tek Allahu i Madhërishëm.¹⁰⁵

Allahu i Madhërishëm thotë: *“... Ajo tha: “O Zoti im, me të vërtetë unë e paskam dëmtuar veten dhe tani, bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve!”* (En-Neml: 44)

Sulejmani [alejhi selam] i përgatiste kuajt e posaçëm për luftërat në rrugën e Zotit si dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me forcën dhe misionin e shtetit të tij për ftesën e të tjerëve dhe frikësimin e

¹⁰⁵ Shiko tek Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 357, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 237, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 24, tek Muhamed El-Fekij në librin “Kisas el-enbija”, f. 371

armiqve. Ai merrej vetë personalisht me kontrollin e kuajve dhe shfaqjeve të tyre.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ne i falëm Davudit Sulejmanin, një rob të mrekullueshëm. Ai i drejtohej gjithnjë me pendesë Zotit! Kur një pasdite iu paraqitën kuajt këmbëshpejtë, ai tha: “Unë shfaqja dashuri më të madhe për pasurinë (kuajt), sesa për lutjen ndaj Zotit tim, derisa dielli humbi mbas malit. M’i ktheni ata (kuajt)” - e pastaj nisi t’i presë me shpatë këmbët dhe qafat e tyre.”* (Sad: 30-33)

Komentuesit dhe historianët flasin për një përpjekje për t’ia marrë pushtetin Sulejmanit me forcë, por Allahu i Madhërishëm e ndihmoi atë dhe ia ktheu pushtetin atij pas kësaj sprove.¹⁰⁶

Si argument për këtë periudhë të vështirë në jetën e Sulejmanit dhe sprovës që kaloi, ata përmendin ajetin kur’anor ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ne e vumë në provë Sulejmanin dhe vendosëm në fronin e tij një trup, por ai iu drejtua Zotit dhe tha: “O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet që të mos e ketë askush pas meje! Me të vërtetë, Ti je Dhurues i madh!”* (Sad: 34-35)

¹⁰⁶ Shiko tek Et-Taberi në tefsirin e tij, v. IX, f. 581.

Isai [alejhi selam]

Isai i biri i Merjemes është rob i Allahut dhe i dërguar i Tij, fjala e Tij që hodhi tek Merjemja dhe ishte shpirt prej Tij. Ai është profeti i fundit nga bijtë e Izraelit. Ai lindi pa baba dhe lindja e tij në vetvete është një mrekulli. Kur flasim për jetën e Isait [alejhi selam] në mënyrë të pashmangshme flasim edhe për nënën e tij, Merjemen, duke filluar me gjyshen e tij, gruan e Imranit.¹⁰⁷

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Kujto kur gruaja e Imranit tha: “Zoti im, unë Ty ta kam kushtuar atë që është në barkun tim, që të të shërbejë vetëm Ty; andaj, pranoje prej meje! Se Ti, me të vërtetë, dëgjon dhe di çdo gjë.” E kur ajo lindi, tha: “Zoti im! Unë linda femër, - Allahu e di më mirë se çfarë lindi ajo, - e mashkulli nuk është si femra. Unë ia vura emrin Merjeme dhe i kam lënë atë me pasardhësit e saj nën mbrojtjen Tënde nga djalli i mallkuar.”* (Ali Imran: 35-36)

Merjemja dhe pasardhësit e saj ishin të mbrojtur nga Allahu i Madhërishëm ndaj shejtanit të mallkuar, prandaj ajo u rrit me devotshmëri dhe gjatë jetës kaloi sprova që e vendosën atë dhe nën akuzë

¹⁰⁷ Shiko tek Hasen El-Xhemel “Inne methete Isa indallahi kemetheli Adem”, f. 115.

para shoqërisë së bijve të Izraelit, ku ajo jetonte në Bejtul Makdis (shtëpinë e shenjtë, Kuds).¹⁰⁸

Kjo shoqëri në atë kohë kishte vlerat e saj të veçanta që buronin nga ligjet e Musait [alejhi selam] dhe të profetëve që erdhën pas tij. Për këtë arsye, Merjemja ishte pjesë e kësaj shoqërie dhe dallohej për devotshmërinë e saj. Ajo ishte rritur në një familje që dallohej për dituri dhe devotshmëri dhe ishte një grua e përzgjedhur dhe e dëlirë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!”* (Ali Imran: 42-43)

Allahu i Madhërishëm e sprovoi atë duke bërë që ajo të mbetej shtatzënë pa e prekur asnjë burrë. Në këtë mënyrë ajo u bë objekt i sulmeve nga ana e shoqërisë që e konsideronte zinanë (imoralitetin) si krim madhor. Ajo u tremb nga njerëzit dhe nga akuzat e tyre, edhe pse ishte e pafajshme. Nga ngjarjet e lindjes së Isait [alejhi

¹⁰⁸ Shiko tek El Jakubi në “Et tarijh”, v. I, f. 74, Et-Taberi në librin e tij të historisë, v. I, f. 19, dhe në tefsirin e tij, v. III, f. 269, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 307, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 63, tek Hasen El Xhemel “Inne methale Isa indallahi kemetheli Adem”, f. 115, tek Es-Sabuni “En-nubvetu vel enbija”, f. 193.

selam] del në pah se në atë kohë ekzistonte një kontroll shoqëror mbi krimet, në përgjithësi, dhe mbi imoralitetin, në veçanti, dhe se sytë e shoqërisë nuk mëshironin askënd në këtë pikë.¹⁰⁹

Për këtë arsye, ajo u frikësua për jetën e saj dhe qëndroi larg shoqërisë së saj.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët. Dhem-bjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trun-gu i një hurme. Ajo tha: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!” Një zë e thirri nga poshtë: “Mos u pikëllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje! Shkunde trun-gun e palmës, që të bien mbi ty hurma të fres-këta! Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshir-shmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.”* (Merjem: 22-26)

Pas lindjes, Isai [alejhi selam], tashmë, ishte në duart e nënës së tij të ndershme, Merjemes. Ajo i druhej reagimit të popullit të saj edhe më shumë për faktin se ajo vinte nga një familje e nderuar dhe e respektuar që ishin shembull në ndershmëri dhe në devotshmëri.¹¹⁰

¹⁰⁹ Shiko tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. II, f. 63.

¹¹⁰ Për më shumë hollësi shiko tek Abdul Vehab En-Nexhar “Kisas el-enbija”, f. 409, tek Muhamed El-Fekij në librin “Kisas el-enbija”, f. 435, tek El-Jakubi në “Et-tarih”, v. I, f. 73, Et-Taberi në tefsirin e

Por përballja me shoqërinë ishte e pashmangshme, prandaj Allahu i Madhërishëm e ruajti dhe e mbrojti atë duke i dhënë mrekulli që e pastronin nga të gjitha dyshimet.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë: “O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.”* (Merjem: 27-28)

Merjemja u përball me presion dhe akuza, edhe pse ajo nuk kishte bërë asnjë krim dhe shtat-zënia e saj me Isain [alejhi selam] ishte një mrekulli. Për këtë arsye, Allahu i Madhërishëm e udhëzoi atë dhe i dha mrekulli që e pastronin atë nga të gjitha akuzat.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?” Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes*

tij, v. VIII, f. 335, tek Ibnul Ethiri në librin “El-kamil”, v. I, f. 31, tek Ibnu Kethiri në librin “El-bidaje ve en-nihaje”, v. I, f. 67.

dhe në ditën që do të ringjallet!” Ky është Isai, i biri i Merjemes. Kjo është fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë. Allahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir. Qoftë i lavdëruar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të “Bëhu!” dhe ajo bëhet.” (Merjem: 29-35)

Pas lindjes së Isait [alejhi selam] dhe mrekullive që i ndodhën atij, tashmë, ai ishte në rrezik nga mbreti romak i Palestinës, Herodi.¹¹¹

Herodi u përpoq ta sulmonte Isain dhe nënën e tij, dhe ajo bashkë me familjen e saj u detyrua të emigronte jashtë Palestinës, duke iu drejtuar Egjiptit, ose drejt Damaskut, ose diku tjetër, për të shpëtuar nga ky kriminel që e kërcënonte seriozisht jetën e Mesias dhe të nënës së tij. Pikërisht këtë kuptojnë komentuesit nga ajeti ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ne e bëmë birin e Merjemes dhe nënën e tij mrekulli për njerëzimin dhe i strehuam rrëzë një kodre të qetë me burime uji.”* (El-Mu’minun: 50)

Pasi u rrit, Isait [alejhi selam] i erdhi shpallja dhe iu ngarkua mesazhi i Zotit për tek bijtë e Izraelit. Pjesë e urdhëresave ishin edhe ligjet që organizonin jetën e njerëzve, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe kjo sigurisht që do të sillte siguri

¹¹¹ Për më shumë hollësi shiko tek Abdul-Vehab En-Nexhar “Kisas el-enbija”, f. 461.

dhe paqe mes tyre. Ligjet e tij ishin nga Teurati dhe nga Inxhili.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar veten Allahut, i gjykonin hebrenjtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të Allahut, për të cilin ata dëshmonin. Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje! Dhe mos i ndërroni Fjalët e Mia me ndonjë vlerë të vogël! Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është mohues i vërtetë. Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë (të njëjtë me të). Por kushdo që fal shpagimin si lëmoshë, ka bërë një vepër që është shlyerje për gjynahet e veta. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka zbritur Allahu, ai është shkelës i vërtetë. Pas atyre profetëve, Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratit që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen Allahut. Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit ashtu siç ka shpallur Allahu në të. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është keqbërës i vërtetë.”* (El-Maide: 44-47)

Isai [alejhi selam] u përpoq shumë në jetën e tij që të gjykonte mes njerëzve sipas ligjeve të Zotit dhe t'i nënshtroheshin Teuratit. Për shkak të kësaj, ai u përball me sulme nga bijtë e Izraelit.¹¹²

Gjatë gjithë kohës ai ishte nën kërcënimin e hebrenjve që u përpoqën më shumë se një herë ta eliminonin. Ishin pikërisht ata që e spiunuan tek mbreti romak, duke sajuar një akuzë të pavërtetë dhe duke sjellë dëshmitarë të rremë. Ata bënë thirrje më shumë se një herë që ai të gjykohej derisa arritën ta dënojnë atë me kryqëzim, por Allahu i Madhërishëm e shpëtoi prej tyre me një mrekulli të pashoqe, njësoj siç e shpëtoi dhe Ibrahimin [alejhi selam].

¹¹² Shiko tek Abdul-Vehab En-Nexhar "Kisas el-enbija", f. 468.

Të gjithë profetët në përgjithësi

Allahu i Madhërishëm i ka kërcënuar mohuesit nga mesi i popujve të ndryshëm të profetëve se ata nuk do të jenë të sigurt nga dënimi i Allahut dhe i ka frikësuar ata me humbjen e sigurisë. Allahu i Madhërishëm e bën të qartë se vetëm Ai ka mundësi që ta japë sigurinë, e nëse ata e mohojnë Atë, ata do të jenë gjithmonë të rrezikuar me humbjen e gjësë më të shtrenjtë, kënaqësisë së Allahut të Madhërishëm dhe frikën dhe tmerrin që pason nga humbja e saj. Kur zemërimi i Allahut të Madhërishëm bie mbi një popull, ata nuk do të kenë më as begati dhe as siguri. Ata që e mohojnë Allahun e Madhërishëm dhe profetët e Tij, janë të kërcënuar me uri, frikë, dënim, poshtërim, nënshtrim dhe përhapjen e armiqësisë mes tyre në jetën e kësaj bote, kurse zjarrin e Xhehenemit në botën tjetër.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“A janë të sigurt banorët e këtyre qyteteve se nuk do t’iu vijë dënimi Ynë natën, ndërkohë që flenë?! Mekës dhe rrethinave të saj. A janë të sigurt ata se nuk do t’iu vijë dënimi Ynë ditën, ndërkohë që argëtohen?! A janë të sigurt ata nga të papriturat e Allahut? Vetëm ata që janë të humbur nuk u frikësohen të papriturave të Allahut. A nuk e është e qartë për ata që trashëguan tokën e banorëve të*

mëparshëm të saj, se, nëse Ne dëshirojmë, i dënojmë për gjynahet e tyre dhe ua vulosim zemrat, që të mos dëgjojnë?! Ne të kemi treguar ty disa nga ngjarjet e atyre popujve. Të dërguarit e tyre u erdhën me prova të qarta, por sigurisht që ata nuk do të besonin diçka që edhe më parë e mohonin. Kështu ua vulos Allahu zemrat mohuesve. Ne pamë se shumica e tyre nuk i përmbaheshin besëlidhjes; vërtet, Ne gjetëm se shumica e tyre ishin të pabindur.” (El-A’raf: 97-102)

Shumë nga popujt janë përballur me zemërimin e Allahut të Madhërishëm dhe dënimin e Tij, duke humbur sigurinë dhe krenarinë, madje edhe jetën dhe i ka kërcënuar me dënim të dhembshëm në Ditën e Kijametit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Mjerë ata që jetën e kësaj bote e duan më shumë se atë të botës tjetër, që largojnë njerëzit nga rruga e Allahut dhe dëshirojnë ta shtrembërojnë atë! Ata janë në humbje të madhe. Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t’u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit). Allahu e shpie në humbje kë të dojë dhe e udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti. Ne e dërguam Musain me shenjat Tona (dhe i thamë): “Nxirre popullin tënd nga errësira në dritë dhe përkujtoju atyre ditët e Allahut!” Vërtet, në këtë ka shenja për çdo njeri që është i durueshëm dhe falënderues.” (Ibrahim: 3-5)*

Allahu i Madhërishëm, gjithashtu, thotë: *“Dhe Musai tha: “Nëse mohoni ju dhe të gjithë ata që janë në Tokë, (dijeni se) Allahu është vërtet i Vetëmjaftueshëm dhe plot lavdi.” A nuk ju ka ardhur lajmi për ata që kanë qenë para jush: për popullin e Nuhut, fiset Ad e Themud dhe për ata pas tyre? Vetëm Allahu i di ata! Të dërguarit e tyre u sollën shenja të qarta, por ata vinin duart në gojë (me tallje) dhe thoshin: “Ne nuk besojmë në mesazhin tuaj. Ne kemi dyshim të madh ndaj asaj që na thërrisni ju!” Të dërguarit e tyre u thanë: “Vallë, a mund të dyshohet në Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?! Ai ju thërret juve për t’ju falur disa gjynahe tuajat dhe që t’ju lërë deri në afatin e caktuar.” Ata thanë: “Ju jeni vetëm njerëz si ne. Ju dëshironi të na shmangni nga ajo që kanë adhuruar të parët tanë. Andaj, na sillni prova të dukshme!” Të dërguarit e tyre u thanë: “Ne jemi vetëm njerëz si ju, por Allahu ia dhuron hirin e Tij kujt të dojë prej robërve të Vet, ne nuk mund t’ju sjellim prova pa urdhrin e Allahut. Besimtarët le të mbështeten vetëm tek Allahu. E përse të mos mbështetemi tek Allahu, kur Ai tashmë na ka treguar rrugën e drejtë, në të cilën po ecim? Ne do t’i durojmë përndjekjet tuaja e ata që besojnë, le të shpresojnë vetëm tek Allahu!” Mohuesit u thanë të dërguarve të tyre: “Ne do t’ju dëbojmë nga vendi ynë ose do të ktheheni në fenë tonë!” Atëherë, Zoti u shpalli (të dërguarve të Vet): “Ne do t’i zhdukim keqbërësit.” (Ibrahim: 8-13)*

Allahu i Madhërishëm na tregon se mohuesit e Zotit që i kundërshtonin dhe u bënë in keq profetëve të tyre dhe cenonin sigurinë e jetës së tyre, nëse do të besonin, atyre do t'u vinte siguria, të mirat materiale dhe begatia për shkak të këtij besimi dhe kënaqësisë së Allahut të Madhërishëm.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t'u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë.”* (El-A'raf: 96)

Allahu i Madhërishëm ka dhënë shumë shembuj nga popujt e shthurur dhe zullumqarë që i shkatërruan vetet e tyre.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad, banorët të Iremit me pallate shumëshytyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?! Dhe me fisin Themud, që gdhendi shkëmbinjtë në luginë (për të bërë shtëpi)? Dhe me Faraonin, njeriun e hunjve (ku torturonte njerëzit)? Të gjithë këta shkelën çdo kufi në vendet e tyre, duke shtuar atje shthurjen dhe korrupsionin, prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit. Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!”* (El-Fexhr: 6-14)

Në këto ajete ka shenja të qarta se Allahu i Madhërishëm ishte në pritë ndaj popujve të kaluar, në përgjithësi, disa i shkatërroi e disa i

shpëtoi dhe se Allahu është në pritë në çdo kohë për të gjithë popujt që nga koha e profetit Muhammed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe deri në fund të botës. Ai na e tërheq vëmendjen ndaj zemërimit dhe ndëshkimit të Tij, duke na e kujtuar se kushdo që vepron ndonjë gjë që e zemëron Allahun e Madhërishëm, le ta dijë se Ai ka mundësi të ndëshkojë dhe nuk mund ta pengojë asgjë, dhe ai nuk do të gëzojë as siguri dhe as rehati kudo që të jetë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Allahu e ka bërë shembull qytetin (e Mekës), i cili ishte i sigurt dhe i qetë. Atij i arrinin ushqime të bollshme nga të gjitha anët, por pastaj banorët e tij i mohuan dhuntitë e Allahut dhe Ai i bëri të shijojnë urinë dhe frikën, si ndëshkim për atë që bënë.”* (En-Nahl: 112)

Mbyllje

Nga leximi i historisë së profetëve, rishikimi i jetës, i historisë dhe ngjarjeve që kanë ndodhur në jetët e tyre, vërejmë se vështrimi i tyre ndaj sigurisë është një vështrim i përgjithshëm që ka lidhje me besimin tek Allahu i Madhërishtëm dhe kryerjen e detyrimeve që lindin prej tij, me zbatimin e urdhëresave dhe respektimin e rregullave të tij, duke përfshirë edhe garantimin e të drejtave të të tjerëve dhe moscenimin e tyre. Gjithashtu, profetët në përgjithësi, që nga Ademi e deri tek Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kanë ardhur me parimin e vendosjes së rregullave dhe ligjeve për organizimin e jetës së njerëzve dhe garantimin e jetëve dhe pasurive të tyre duke u bazuar tek ajo që u shpallej nga Allahu i Madhërishtëm.

Po ashtu, vërejmë edhe ekzistencën e një numër ngjarjesh të rënda që kanë lidhje me jetën e profetëve, siç janë vrasjet, vjedhjet, tentativa për cenimin e nderit etj. Nëpërmjet këtyre ngjarjeve, Kur'ani Famëlartë na mëson përdorimin e argumenteve dhe fakteve si dhe hetimin e disa prej këtyre krimeve dhe mbledhjen e të dhënave që kanë lidhje me të për të arritur deri tek e vërteta, si dhe ndëshkimet me të cilat u përballën ata që u bënë keq të tjerëve.

Po ashtu, na tregon se ndryshoi gjendja dhe në fund ata që kishin bërë padrejtësi e kishin ndierë nevojën për ndihmën e atyre që u ishte bërë padrejtësia. Këto histori kanë përfshirë edhe kujdesin e vazhdueshëm të profetëve për pastrimin e shoqërive njerëzore nga krimet e ndryshme që kanë lidhje me nderin, pasurinë dhe jetën si dhe pastrimin e shoqërive nga gjynahu më i madh, shokvënia ndaj Allahut të Madhërishëm.

Ne duhet ta lexojmë patjetër Librin e Allahut që të përfitojmë nga anët e ndryshme që trajton ai, sepse, siç e dimë, pjesa më e madhe e Kur'anit përbëhet nga ajete që flasin për historitë e profetëve dhe se aty gjejmë atë dituri që është aq e nevojshme për të gjithë dhe në të gjitha specialitetet. Këto histori vendosin themelet e parimeve themelore të jetës së njerëzve dhe shoqërive njerëzore që i ka caktuar Allahu i Madhërishëm, i Cili është më i Dijshmi për gjendjen e njerëzve që nga Ademi [alejhi selam] e deri kur të përfundojë kjo botë. Për këtë arsye, aty gjejmë historinë dhe shembujt për të gjithë popujt që në lashtësi e deri në pafundësi.

Unë nuk pretendoj se në këtë trajtim e kam përfshirë plotësisht këtë temë, sepse ajo ka nevojë për më shumë kërkim dhe vëmendje. Unë i ftoj të gjithë kërkuesit t'i studiojnë edhe më tej çështjet e sigurisë në jetën e profetëve. Në të njëjtën kohë e

vë në dukje se jetëshkrimi i Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] konsiderohet si disiplinë më vete që ka burimet dhe referencat e posaçme për të.

Allahut i kërkoj ndihmë dhe falje!

Burimet dhe referencat:

- Kur'ani Famëlartë
- Buhariu: Ebu Abdilah Muhamed Ibn Ismail Ibn Ibrahim 194-256 sipas hixhretit.
 1. "Sahih El-Buhari", El Bedravi, Rushdi
 2. "Kisas El-Enbija ve et tarih", vëllimi i parë, Ademi - Salihu, Kajro 1996, El-Biladi, Atik Gajth
 3. "Mu'xhem el mealim el xhugrafije fi es-sireti en-nebevije", Mekë, shtëpia botuese Daru Mekete lin neshri vet teuzij 1402 h., Et-Tirmidhi, Ebu Isa Muhamed Ibn Isa Ibn Sure, 209-279 h.
 4. "El-Xhamius sahih (Sunen et-Tirmidhi)", i verifikuar nga Ahmed Muhamed Shakir, Bejrut, Liban, shtëpia botuese Dari ihja et-turath el-arabij, Eth-Thalebi, Ahmed Ibn Muhamed Ibn Ibrahim.
 5. "Kisas el-enbija", ose ndryshe "Arais el-mexhalis", Kajro 1994, El-Xhasir, Hamed.
 6. "El-mu'xhem el-xhugrafi fil bilad es-Suudije (shimal el-memleke)", pjesa e tretë, Rijad, Darul jemame lit terxheme ven neshr, El-Xhemel, Hasen Izudin.
 7. "Inne methele Isa indallahi kemetheli Adem", botimi i parë, Bejrut, Darul-kitab elarabi 1404 h., El-Halisi, Nevaf Salih.

8. "El-menhexh el-islami fil mekajil vel mevazin li nebijilah Shuajb", botimi i tretë, Rijad 1404 h., Dr. Abs, El-Hamze.

9. "Ekremun nas, poezi", Kajro, Ibn Hanbel: Imami Ebu Abdilah Ahmed Ibn Muhamed, v.241 h.

10. "El-Musned", Bejrut, El-mekteb el-islami 1398 h., Duruze, Muhamed Izet.

11. "Tarih beni israil min esfarihim", Bejrut, El-mektebetul asrije, 1389 h., Duh, Hasen.

12. "Ibtilaat esh-sherr vel-hajr fi hajat el-enbija", botimi i parë, Kajro, Daru es-sahve, 1415 h., Er-Raxhihi, Abdul-Gani.

13. "Adem kema tehddethe el Kur'anul kerim", Kajro, Ibn Sad: Muhamed Ibn Munij' El Hashimij, meulahum, autori i "El-vakidi" v.230 h.

14. "Tabekat el-kubra", Bejrut, Daru sadir, Es-Sadi, Abdurahman Ibn Nasir.

15. "Kisas el-enbija", botimi i parë, Rijad, Mektebetu usul es-selef, 1416 h., Es-Sindi, Abdul Kadir Habib.

16. "Edh dheheb el mesbuk fi tahkik mervijat gazveti tebuk", Kuvajt, mektebetul mual-la, 1406 h., Esh-Sheukani, Muhamed Ibn Ali Ibn Muhamed.

17. “Fet’hul kadir”, botimi i tretë, Bejrut, Darul fikr, 1393 h., Es-Sabuni, Muhamed Ali.

18. “En-nubuvetu vel-enbija”, botimi i tretë, Meke, 1400 h., Es-Salihi Esh-Shami, Muhamed Ibn Jusuf, v.942 h.

19. “Subulul huda ve er reshad fi hedji hajril ibad”, vëllimi i pestë, verifikim i Fehim Muhamed Sheltut dhe Xheude Abdurahman Hilal, botimi 1, Kajro, El-mexhlis el a’la li esh-shuun el-islamije, 1404 h., Tabare, Afif Abdul-Fetah.

20. “Meal enbija fil Kuranin kerijm”, Bejrut, Darul ilm lil melajin, 1993., Et-Taberi, Ebu Xhafer Muhamed Ibn Xherir, v.310 h.

21. “Tarih el umem vel muluk”, Bejrut, Darul fikr.

22. “Xhamiul bejan fi tefsiril Kur’an (Tefsir Et-Taberi), Bejrut, Darul kutub el-ilmije, 1412 h., Abud, Abdul-Ganij.

23. “Enbijaullah vel hajatul muasire”, Kajro, Darul fikr el-arabij, 1978, Ibn Asakir, Ebul Kasim ali Ibn Husejn, 499-571 h.

24. “Tarihu dimeshk, nushatun musavere minel mahtutat el-aslije”, Medine, Mektebetu ed-dar, 1407 h., El Atas, Hadun.

25. “Ade fi et-tarih”, Kajro, Mektebetu hasan, 1398 h., El-Fakihij, Ebu Abdilah Muhamed Ibn Is’hak, v.279, afërsisht.

26. “Ahbari meke”, studim dhe verifikim i Abdul Melik Ibn Duhejsh, Mektebetu en-nahda el-hadithe, Mekë, Ebul Fida, El Muejed Imad ed Din Ismail Ibn Ali Ibn Mahmud, v.732 h.

27. “El-Muhtesar fi ahbar el-besher”, me koment të Mahmud Dejub, botimi i parë, Bejrut, Darul kutub el-ilmije 1417 h., El Fekij, Muhamed.

28. “Kisas el-enbija, ahdathuha ve iberuha”, Kajro, Mektebetu vehbe, 1410 h., Kutub, Sejid

29. “Fi dhilal el Kuran”, botimi i katërt, Bejrut, Darul shuruk, 1397 h., Ibn Kethir, Imaduddin Ebul Fida Ismail.

30. “El-bidaje ve en-nihaje”, Mektebetul mearif, Bejrut 1978 h., Kanterz, Keneth dhe të tjerë.

31. “Et-tefsir et-tatbiki lilkitab el-mukades” Londër, 1997, En-Nexhar, Abdul-Vehab .

32. “Kisas el-enbija”, Kajro, Daru et turath., Ibn Hisham: Ebu Muhamed Abdul Melik El Meafiri, v. 213 h.

33. “Es-sire en-nebevije”, me komentin e Ta Ha Abdur-Reuf Sad, Mektebetu Shakrun, Kajro,

Ibn Maxhe, El Hafidh Ebu Abdilah Muhamed ibn Jezijd El Kazvijni, 208-275 h.

34. "Sunen Ibn Maxhe", verifikim i Muhammed Fuad Abdul Baki, Kajro,1373 h., Muhamed, Muhamed Abdu-Selam.

35. "Benu israil fil Kur'an el-kerim", botimi i parë, Kuvajt, Mektebetul felah 1400 h., një grup dijetarësh.

36. "El-muxhem el-vesijt", Stamboll, El-Mesudi, Ebul Hasen Ibn Ali El Husejn.

37. "Murevixh edh-dheheb ve meadin el-xheuher", verifikim i Muhji ed-Din Abdul Hamid, Kajro,1373 h. Bejrut, Darul fikr 1393 h., Ibn Mendhur, Muhamed Ibn Mukrem Ibn Ali.

38. "Lisanul arab", Bejrut, Daru sadir, Mehran, Muhamed Bejumi.

39. "Dirasat tarihije minel kur'an, bilad el-arab", Rijad, Universiteti El-Imam 1400 h., Jakut El-Hamevij, Shihabud Din Ebu Abdilah v.626 h.

40. "Mu'xhem el-buldan", Bejrut, Daru ihja et-turath el-arabij, El-Jakubi, Ahmed Ibn Ebi Jakub Ibn Xha'fer Ibn Vehb, v.282.

41. "Tarih El-Jakubi", Bejrut, Daru sadir, 1379.

Autor Prof. dr. Abdulaziz
b.Ibrahim el-Umeri

أ.د. عبد العزيز بن إبراهيم العمري

Titulli ne arabisht

الأمن في حياة الأنبياء (عليهم السلام)

Titulli Siguria ne jeten e
Profeteve (alejhim selam)

Përmbajtja:

Parathënia	5
Hyrja	10
Sigurua në jetën e Ademit [alejhi selam]	12
Hudi [alejhi selam].....	22
Salihu [alejhi selam].....	26
Ibrahimi [alejhi selam].....	33
Luti [alejhi selam]	40
Shuajbi [alejhi selam]	49
Jusufi [alejhi selam]	54
Musai [alejhi selam]	89
Davudi [alejhi selam] dhe	111
Sulejmani [alejhi selam]	111
Isai [alejhi selam]	126
Të gjithë profetët në përgjithësi.....	133
Mbyllje	138
Burimet dhe referencat:.....	141